**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-060/01-0055100/26 dt. 15.09.2026**
**Mitrovicë**

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për të **enjten** më dt. **24.09.2026**:

**T H Ë R R E T**
**Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës**
**(Mbledhja e 11-të)**

Mbledhja do të ketë këtë REND DITE:

1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit z. Egzon Mehmeti
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Draft-Rregullore Nr. _/2026 Për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve
4. Draft-buxheti për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029
   3.1 Qarkorja Buxhetore 2027/02 për komuna
5. Propozim-vendim për caktimin e pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit
6. Propozim-vendim për formimin e Jurisë Profesionale për ndarjen e çmimit "Kadri Kadriu"
7. Propozim-vendim për formimin e Komisionit për ndarjen e çmimit "Lah Nimani"
8. Propozim-vendim për mbështetje financiare për katër familje të rrezikuara nga rrëshqitja e dheut në Lagjen Bair
9. Propozim-vendim për miratim paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71208072-01870-5

10. Propozim-vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71208072-01870-5
11. Propozim-vendim për miratim paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71202012-00009-1
12. Propozim-vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik\juridik të Parcelës Nr. P-71202012-00009-1
13. Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës
14. Kërkesë për transfer të mjeteve financiare në investime kapitale
15. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.1/26 dt. 29.07.2026
16. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.2/26 dt. 29.07.2026
17. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.3/26 dt. 29.07.2026
18. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.4/26 dt. 29.07.2026
19. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.5/26 dt. 29.07.2026
20. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0042000-17.6/26 dt. 29.07.2026
21. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0035074-15/26 dt. 29.06.2026
22. Pyetje dhe përgjigje

**Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.**

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MITROVICËS * MITROVICË-MITROVICA * OPŠTINA MITROVICA * REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centarina Izborna Komisija
Central Election Commission
14-08-2026
Prishtinë / Priština
Nr./Br. 01/1579-2026

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE** , në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), nenin 65 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, më datë 14.08.2026, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

I. **Z.Egzon Mehmeti,** emërohet anëtar i kuvendit komunal në Mitrovicën e Jugut, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal **z. Jeton Zeneli.**

II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Egzon Mehmeti dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 13.08.2026 me numër të protokollit 07/7-1576/2026, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal, i cili ka dhënë dorëheqje për arsye të emërimit në pozitë ekzekutive. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është Egzon Mehmeti. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve lokale të vitit 2025. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 14.08.2026

**Kreshnik RADONIQI**

**Kryesues i KQZ**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – RepublicofKosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
OpštinaJuzna Mitrovica – Municipalityof Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-060/01-0042000-1/26 dt. 29.07.2026**
**Mitrovicë**

# P R O C E S V E R B A L

## Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës

## Seanca e 10-të

**Koha**: 29.07.2026, ora 10:00

**Vendi**: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

**Të pranishëm**: Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahimi, Fisnik Suma, Ferdi Kadriu, Majlinda Kurti, Gëzim Stavileci, Artan Berisha, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Egzon Hamza, Liridona Muharremi, Lavdim Zeneli, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Syla, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Xhyljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

**Mungoi**: Igballe Islami, Nazmije Sejdiu, Rinesa Preteni dhe Oltion Ahmeti

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, anëtarët të Kuvendit, organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, media dhe të pranishmit tjerë. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit theksoi Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, në cilësinë e Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 10-të të rregullt të Kuvendit të Komunës, me rend dite siq është paraparë me thirrje (lexoi rendin e ditës),

Kryesuesi i Kuvendit para se të hapë diskutimin lidhur me rendin e ditës theksoi se propozohet edhe një pikë shtesë e rendit të ditës. Për shkak të vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Financave, është kërkuar harmonizimi i Vendimit nr. 02-060/01-0035074/25/26, që ka të bëjë me bartjen e numrit të stafit nga Komuna në Drejtorinë e Arsimit. Besoj se para jush e keni edhe propozimin e ri, në të cilin është bërë harmonizimi përkatës, si dhe bartja buxhetore nga drejtoritë përkatëse, prej të cilave është bartur stafi në Drejtorinë e Arsimit. Dy numra janë larguar për shkak se janë marrë nga Drejtoria e Shëndetësisë, e cila e ka buxhetin, përkatësisht grantin specifik, dhe nuk lejohet që këta numra të

barten. Ky është rendi i ditës. A ka ndonjë vërejtje apo propozim lidhur me rendin e ditës? Me këtë, e shpall të hapur diskutimin rreth rendit të ditës.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Të nderuar asamblistë, në kuadër të pikave të rendit të ditës, duke shfrytëzuar të drejtën time ligjore si Kryetar i Komunës, propozoj që të përfshihen edhe disa pika shtesë të rendit të ditës: Pika e parë ka të bëjë me mbështetjen financiare për festivalin e përvitshëm „Greenfest“. Pika e dytë është mbështetja financiare për Festivalin Tradicional të Komedisë. Pika e tretë është mbështetja financiare për „Mitrovica International Jazz Festival“. Pika e radhës është mbështetja financiare për Festivalin e Pianos. Po ashtu, propozohet mbështetje financiare për Festivalin e Këngës së Fëmijëve „Cicërima buzë Ibrit“, si dhe për „Mitrovica Art Colony“. Pra, janë gjithsej gjashtë pika të reja të rendit të ditës, të cilat lidhen me vendimet për mbështetje financiare në fushën e kulturës dhe aktiviteteve artistike. Këto propozime janë bërë mbi bazën e mundësive të krijuara nga bartjet e mjeteve financiare. Ju vlerësoni nëse të gjitha këto pika mund të përfshihen në një pikë të vetme dhe të trajtohen si nën-pika, apo nëse duhet të trajtohen veç e veç. Përkatësisht, për „Greenfest“ propozohet shuma prej 5,000 €, për Festivalin Tradicional të Komedisë 5,000 €, për „Mitrovica International Jazz Festival“ 7,000 €, për Festivalin e Pianos 5,000 €, për Festivalin e Këngës së Fëmijëve „Cicërima buzë Ibrit“ 3,000 €, ndërsa për „Mitrovica Art Colony“ 4,000 €. Shumica e këtyre janë aktivitete tradicionale që mbahen në Mitrovicë. Ndërsa „Mitrovica International Jazz Festival“, këtë vit, është një nga ngjarjet e reja. Kjo lidhet edhe me pjesëmarrjen e njërit prej grupeve më të famshme amerikane, i cili është në turne në nivel evropian dhe një nga paraqitjet e fundit të tyre do të jetë në Mitrovicë. Për këtë arsye, është propozuar një shumë pak më e madhe, përkundër faktit se kërkesa e organizatorëve ka qenë më e lartë. Kjo mbështetje është veçuar për shkak të rëndësisë dhe nivelit profesional të grupit në fjalë, i cili, sipas profesionistëve, vlerësohet ndër grupet më profesionale në nivel global.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqenëse propozimet e Kryetarit kanë të bëjnë me mbështetjen financiare për festivale dhe aktivitete kulturore, ato mund të përfshihen në një pikë të vetme dhe të renditen si nën-pika, me qëllim që të nxirret një vendim për mbështetjen financiare të këtyre aktiviteteve. Meqenëse „Mitrovica Art Colony“ është aktivitet shtesë, ndërsa edhe aktivitetet e tjera janë të përcaktuara me emër, propozoj që të përfshihen si një pikë e rendit të ditës me nën-pika, ngjashëm me çështjen e subvencionimit të sportit të trajtuar në seancën e kaluar.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Ju e vlerësoni. Unë i paraqita të gjitha propozimet dhe shumat përkatëse. Votimi mund të bëhet veç e veç për secilën mbështetje financiare.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit, Kryetar. Atëherë vazhdojmë me diskutimet dhe me shefat e grupeve parlamentare. Nga PDK-ja, z. Brahimi.

Valon Brahimi: Përshëndetje Kryetar, Kabinet, kolegë asamblistë. Dëshiroj të ndalem te ky propozim-vendim që na është sjellë sot. Realisht, dokumenti i kthyer nga Ministria na vendos në një situatë jo të favorshme, pasi dokumenti na është dorëzuar në ditën kur po zhvillojmë seancën dhe nuk kemi pasur mundësi të mjaftueshme për t’i konsultuar materialet dhe çështjen e stafit nëpër shkolla. Që para kësaj seance kam theksuar se ekziston një kundërshtim ligjor dhe kam ditur se vendimi do të kthehej nga Ministria. Për këtë arsye, mendoj se është e nevojshme që Zyra Ligjore të konsultohet çdo herë, në mënyrë që të mos vonohemi dhe të mos marrim vendime të kundërligjshme. Vonesat me vendime të tilla krijojnë probleme dhe dëmtojnë funksionalizimin e institucionit. Për mua, ka qenë e mjaftueshme të shoh vetëm dy pjesë të dokumentit, ku thuhet se lënda kthehet në rishqyrtim, si dhe pjesën e interpretimit të Ministrisë së Financave, ku thuhet se akti administrativ i Komunës së Mitrovicës së Jugut është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Prandaj, Kryetar, duke qenë se jeni pjesë e kabinetit ekzekutiv, është e nevojshme që kjo praktikë të ndërpritet. Kur kërkohet

vlerësimi i Zyrës Ligjore, duhet të veprohet në mënyrë që të shmangen gabimet, si nga ana juaj, ashtu edhe nga ana jonë. Gjithashtu, kërkoj që të merren parasysh edhe rekomandimet e opozitës. Edhe pse jemi në opozitë, ne japim kontributin tonë në këtë Kuvend, sepse jemi këtu për të mirën e qytetarëve. Nuk kundërshtojmë çështjet pa arsye, por vetëm atëherë kur i konsiderojmë të arsyeshme dhe të nevojshme. Në këtë rast, jemi vonuar rreth një muaj e gjysmë me këtë çështje. Fatmirësisht, jemi në pushim veror dhe stafi mësimor është në pushim; përndryshe, kjo vonesë do të mund të shkaktonte pasoja edhe për fillimin e procesit mësimor dhe organizimin e orëve mësimore. Ne jemi përsëri pro këtij propozim-vendimi, por është mirë që në të ardhmen këto situata të eliminohen. Kjo nuk është praktikë e mirë. Zyra Ligjore duhet të konsultohet me kohë dhe duhet të merren parasysh edhe rekomandimet e opozitës kur ato janë racionale dhe në interes të institucionit.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne dje e kemi marrë sqarimin nga Ministria e Financave dhe tash jemi të obliguar që brenda 30 ditëve, si Kuvend, ose ta shfuqizojmë vendimin, ose, ashtu siç ka kërkuar Ministria, ta harmonizojmë atë sipas rregullave përkatëse. Prandaj, kemi qenë të detyruar që këtë çështje ta sjellim sot në Kuvend, me qëllim të harmonizimit ose shfuqizimit të vendimit. Dokumenti nga Ministria ka ardhur dje dhe ne e kemi përcjellë tek ju sot.

Erseka Barani: Meqenëse nuk e di arsyen e saktë pse këtë muaj nuk është paraqitur Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2025, kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të na bashkëngjitet Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2025.

Xhyljeta Imeri: Më 10 shkurt, në mbledhjen e katërt të Kuvendit, gjatë zgjedhjes së komisioneve të aksionarëve, nga kjo foltore bëra një thirrje të qartë që bordet e ndërmarrjeve të mos politizohen, por përzgjedhja e anëtarëve të bëhet mbi bazën e meritës dhe profesionalizmit, e jo të përkatësisë partiake. Fatkeqësisht, sot jam këtu për të thënë se kjo thirrje nuk është dëgjuar. Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve është shndërruar në një proces që ngre dyshime të bazuara për ndikim politik në përbërjen e tyre. I nderuar Kryetar, ndërmarrjet publike nuk janë pronë e partive politike. Ato nuk janë shpërblim për militantë dhe as vende për të kënaqur interesa partiake. Ato janë institucione të qytetarëve dhe duhet të udhëhiqen nga njerëz të aftë, profesionistë dhe të përgjegjshëm. Vetëm disa prej të zgjedhurve i plotësojnë këto kritere. Është e papranueshme që në tri borde të zgjedhura, me gjithsej 12 anëtarë, të gjithë anëtarët të jenë të lidhur me partitë politike. Do të duhej që së paku katër apo gjashtë vende t'u liheshin qytetarëve dhe profesionistëve të pavarur. Shpesh flisni për transparencë dhe afërsi me qytetarët, por në këtë rast po dëshmohet e kundërta. Të nderuar kolegë, një shembull i qartë i kësaj qasjeje është edhe shkarkimi i bordit të ndërmarrjes “Omni Sport”, ndonëse anëtarët e tij kishin ende rreth një vit mandat. Kjo ngre dyshime serioze se arsyeja kryesore nuk ishte performanca apo interesi publik.

Kryesuesi i Kuvendit: Xhyljeta po ta kaloj fjalën menjëherë vetëm me qenë se jemi tek rendi i ditës, është mirë që së pari me kërkua nëse dëshiron me e shti si rend dite që mos me e konsumua diskutimin tënd por me e ruajt tek çështja, prandaj duhet të jemi pak ma pragmatik, urdhëro.

Xhyljeta Imeri : Ndonëse anëtarët e tij kishin ende rreth një vit mandat. Kjo ngre dyshime serioze se arsyeja kryesore nuk ishte performanca apo interesi publik  por zëvendësimi i tyre me njerëz të afërt me pushtetin. Edhe ata ishin bashkëqytetarët tanë, qytetarë të Mitrovicës, të cilët meritonin të trajtoheshin me drejtësi dhe respekt, e jo të largoheshin vetëm për t'u zëvendësuar me emra politikë. Unë nuk jam këtu për t'i mbrojtur ata që nuk u zgjodhën, sepse ata nuk janë humbësit në këtë rast. Humbësi më i madh është qytetari. Humbës është shërbimi publik dhe humbëse është edhe vetë Komuna. I nderuar Kryetar, ju keni pasur mundësinë t'u dëshmoni qytetarëve se qeverisni ndryshe. Keni pasur mundësinë të krijoni një standard të ri, ku konkursi fiton mbi telefonatën, profesionalizmi

mbi librezën partiake dhe interesi publik mbi interesin politik. Për fat të keq, perceptimi i krijuar është krejt ndryshe. Nëse vazhdohet me këtë logjikë, po i dërgojmë një mesazh të gabuar rinisë së Mitrovicës: se nuk mjafton të jesh i shkolluar, i ndershëm dhe me përvojë, por mjafton të jesh i afërt me pushtetin. Ky nuk është mesazhi që meriton Mitrovica. Prandaj, sot kërkoj publikisht që kjo qasje të rishqyrtohet. Mitrovica nuk ka nevojë për borde politike; ka nevojë për borde profesionale dhe për njerëz që punojnë për qytetarët, e jo për partitë. Ju bëj thirrje që të reflektoni. Qytetarët nuk ju kanë zgjedhur për të ndarë poste për miq e të afërm, por për të ndërtuar institucione të besueshme, profesionale dhe të pavarura. Si pikë të rendit të ditës, Kryesues, kërkoj një raport lidhur me arsyet e emërimit të bordeve të përkohshme, bazën ligjore të këtij veprimi, si dhe mënyrën e emërimit të ushtruesit të detyrës së kryeshefit në ndërmarrjen e autobusëve.

Kryesuesi i Kuvendit: A mund të bësh edhe një sqarim deri në fund të kësaj çështjeje? Unë besoj se ne, si Kuvend, kemi nxjerrë vendime për themelimin e komisioneve të aksionarëve. Meqenëse ky Kuvend e ka mandatin dhe vendimet janë të Kuvendit, e jo të Kryetarit apo të Ekzekutivit, ne, si anëtarë të Kuvendit, kemi të drejtë të kërkojmë raport të detajuar nga komisionet e aksionarëve. Pra, raporti duhet të kërkohet nga komisionet e aksionarëve dhe jo drejtpërdrejt nga Kryetari, pasi besoj se këtë e dinë edhe komisionerët dhe ata mund ta sjellin raportin. Qëllimi im është vetëm të sqaroj rrugën për kërkimin e përgjegjësisë në Kuvend. Ne kemi të drejtë, në çdo rrethanë, të kërkojmë përgjegjësi nga një komision i aksionarëve, përderisa atë komision e kemi themeluar si Kuvend.

Prandaj, cila është kërkesa juaj konkrete? Kërkoni raport nga zyrtarët të cilët kanë bërë përzgjedhjen? A kërkoni raport për sot apo për seancën e ardhshme?

Xhyljeta Imeri: Besoj se raporti duhet të kërkohet për seancën e ardhshme. Nuk dua të paragjykoj hapat e komisioneve të aksionarëve, por kërkoj që të raportohet për punën e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Në rregull. Mund të vendosim që në rendin e ditës të përfshihet raportimi i komisioneve të aksionarëve për ndërmarrjet përkatëse.

Xhyljeta Imeri: Janë katër ndërmarrje, unë kërkoj raporte për këto tri ndërmarrje për të cilat janë emëruar bordet.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Faleminderit, z. Kryesues, për mundësinë për të dhënë një opinion. Të nderuar asambleistë, pati një shmangie të konsiderueshme nga tema fillestare e diskutimit. Pas intervenimit të Kryesuesi i Kuvendit, me të drejtë u sqarua se janë përzier rolet, pasi Kryetari i Komunës nuk është ai që i emëron drejtpërdrejt bordet; këtë e bën Këshilli i Aksionarëve. Së dyti, do të doja të dija nëse gjatë gjithë mandatit të kaluar keni ngritur ndonjë shqetësim lidhur me ofrimin e shërbimeve nga këto ndërmarrje komunale. Po përmend vetëm një rast që ka qenë ndër situatat më problematike të mënyrës së menaxhimit të ndërmarrjes së autobusëve. Kur disa anëtarë të bordit kanë ardhur në takim dhe kanë folur për gjendjen në stacionin e autobusëve, ndër të tjera është diskutuar edhe për borxhet, përfshirë një borxh prej rreth 600,000 € ndaj Administratës Tatimore. A keni ngritur ndonjëherë si shqetësim faktin se brenda një institucioni komunal, përkatësisht në hapësirat e ndërmarrjes komunale, ka funksionuar një lokal ku pretendohet se është ushtruar veprimtari e prostitucionit dhe ku ndërmarrja komunale kishte edhe një faturë borxhi prej rreth 28,000 €? A e keni ngritur ndonjëherë këtë shqetësim? Po e theksoj këtë vetëm për të treguar se është e lehtë të bëhen akuza, ndërsa është e nevojshme që çështjet të shihen edhe në retrospektivë dhe të vlerësohet se çfarë është bërë gjatë mandatit të kaluar. Anëtarët aktualë të bordeve janë të përkohshëm dhe ende nuk është bërë përzgjedhja përfundimtare e përfaqësuesve apo anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve komunale. Këta anëtarë kanë mandat maksimal prej gjashtë muajsh, me qëllim të përfundimit të një faze tranzitore, vlerësimit të gjendjes dhe përmirësimit të mënyrës së menaxhimit të ndërmarrjeve komunale. Sa i përket mandatit të kaluar, shumë prej këtyre çështjeve nuk janë ngritur nga ju, edhe

pse keni qenë pjesë e Kuvendit. Më habit fakti që në fillim të këtij mandati bëhen vlerësime dhe akuza të tilla, duke folur në emër të drejtës dhe perceptimit të qytetarëve dhe të rinjve të Mitrovicës. Qytetarët e Mitrovicës e dinë se cili ka qenë perceptimi i tyre dhe cili do të jetë ai në fund. Unë, si Kryetar i Komunës, e pranoj gjykimin e qytetarëve në fund të mandatit dhe besoj se e di më mirë se kushdo se cili është perceptimi i tyre.

Xhyljeta Imeri: I nderuar Kryetar, sa i përket përfshirjes së dikujt nga ana ime, dua të theksoj se jam në mandatin tim të tretë dhe gjithmonë kam insistuar të qëndroj larg komisioneve dhe bordeve. Unë kam qenë dhe jam konstruktive dhe nuk flas pa bazë. Diskutimin tim e kam bërë në bazë të dokumenteve dhe materialeve që kam pasur në dispozicion.

Shkëlqim Ibrahimi: Kryetar, vetëm pak, pasi u bë një akuzë e rëndë. A mund të sqaroni se në cilin vit është larguar ai lokal i prostitucionit? Ne atë problem e kemi gjetur dhe e kemi larguar. Madje, edhe gjatë fushatës kemi folur për këtë çështje. Ju lutem, tregoni vitin e saktë kur është larguar, sepse është e lehtë të flitet në përgjithësi. Ju lutem, tregoni vitin në të cilin është larguar lokali dhe vendimin e kujt ka qenë për largimin.

Kryetari i Komunës z . Faton Peci: Unë nuk jam që mbaj databaza, veç e di që ndërmarrja bord i ri kam me u përballë me të duhet me u marrë me pasojë edhe obligimin 8.000€.

Shkëlqim Ibrahimi: Veprimtaria e tillë është evidentuar që nga koha e qeverisjes së Agim BahTirit dhe, me vendim të qeverisjes së Hamza-s, është larguar. Vetëm tregoni vitin kur është larguar dhe kujt i takon vendimi për largimin.

Kryesuesi i Kuvendit propozoj që pikë e rendit të ditës të jetë: Plotësim dhe ndryshimi i Vendimit nr. 02-060/01-0035074/26, për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të organizatës buxhetore. Konstaton se në sall janë të pranishëm 27 anëtarë.

**Rezultati i votimit 16 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Anëtarët e Kuvendit unanimisht votuan që pikë e rendit të ditës të jetë: Plotësim ndryshimi i Vendimit nr. 02-060/01-0035074/26, për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të organizatës buxhetore**.

Kryesuesi i Kuvendit propozoj që pikë e 17 e rendit të ditës të jetë: Mbështetja financiare për festivalet tradicionale: Green Fest 5.000 €, Mitrovica International Jazz Festival Days 7.000 €, Festivali Tradicional i Komedisë 5.000 €, Festivali i Pianos 5.000 €, Festivali i Këngës së Fëmijëve “Cicërimat buzë Ibrit” 3.000 € dhe Mitrovica Art Colony 4.000 € dhe „Art Colony“, e cila propozohet të futet si pikë e rendit të ditës dhe të renditet te subvencionet.

**Rezultati i votimit 26 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

Anëtarët e Kuvendit unanimisht votuan që pikë e 17- e rendit të ditës të jetë: Mbështetja financiare për festivalet tradicionale dhe „Art Colony“.

Kryesuesi i Kuvendit: Po ashtu, kemi edhe pikën tjetër të propozuar nga Xhuljeta: Informatë mbi vendimet e komisioneve të aksionarëve “Stacioni i Autobusëve”, “Tregut” dhe “Omnisportit”. A pajtoheni që edhe kjo pikë të jetë pjesë e rendit të ditës?

**Pas riperseritjes së votimit Rezultati i votimit: 12 për, 14 kundër dhe 0 abstenime.**
**Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nuk miratohet propozimi.**

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim rendin e ditës si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

2. Draft-Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike
3. Propozim-vendim për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë
4. Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të z. Sabri Çabra
5. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “REC” – Mitrovicë
6. Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “OPFAKOS”, Mitrovicë
7. Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “SË BASHKU”, Mitrovicë
8. Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “Zëri i Prindërve”, Mitrovicë
9. Propozim vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € të OJQ “HANDIKOS”, Mitrovicë
10. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën “Minatori ’89”
11. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë
12. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për Shoqatën e të Shurdhërve në Mitrovicë
13. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € në muaj për tetë (8) familje nga Bajri
14. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut
15. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për mbulimin e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Raba Voca” në Mitrovicë
16. Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumën prej 500.00 € për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-s “Doën Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë
17. Propozim vendim për mbështetjen financiare të festivaleve dhe aktiviteteve kulturore:
    - 17.1 Green Fest
    - 17.2 Mitrovica International Jazz Festival Days
    - 17.3 Festivali Tradicional i Komedisë
    - 17.4 Festivali i Pianos 5.000 €
    - 17.5 Festivali i Këngës së Fëmijëve “Cicërimat buzë Ibrit”
    - 17.6 Mitrovica Art Colony
18. Raporti financiar i Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën (janar-qershor 2026)
19. Raport gjashtëmujor i punës së Drejtorisë Për ekonomi, zhvillim, turizëm dhe integrime evropiane (janar-qershor 2026)
20. Pyetje dhe përgjigje.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27 anëtarë) 23 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Rendi i ditës u miratua.**

**Pika 1**

**Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua (25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime)**. **Në sallë janë të pranishëm 27 anëtarë.**

**Pika e 2**

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me Draft-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike, kjo çështje është shqyrtuar edhe në mbledhjen e djeshme të Komitetit për Politikë dhe Financa. Gjatë shqyrtimit janë diskutuar disa çështje dhe janë dhënë vërejtje nga Drejtori i Urbanizmit. Po ashtu, materialit i është bashkëngjitur edhe konkluzioni i Komitetit për Politikë dhe Financa. Fillimisht, e hap diskutimin për këtë çështje. Drejtor, a është bërë ndonjë plotësim apo ndryshim lidhur me këtë Draft-Rregullore, apo të përfundojmë fillimisht diskutimin e anëtarëve të Kuvendit dhe më pas t'ia japim fjalën propozuesit për të dhënë sqarimet përkatëse?

Kushtrim Zeneli: Sugjerimet që i kemi jep në KPF drejtori i ka marrë parasysh dhe i ka koordinuar ato. Për këtë arsye, nuk kemi vërejtje të tjera.

Valon Brahimi: Është mirë që këto hapësira publike, të cilat në raste të caktuara rregullorja i parasheh se mund t'i jepen dikujt për shfrytëzim, të rregullohen më qartë. Do të propozoja që të hiqet mundësia e dhënies në shfrytëzim të hapësirave të gjelbra publike. Hapësirat gjelbëruese nuk duhet t'i jepen askujt për shfrytëzim, sepse edhe një përdorim i shkurtër mund të shkaktojë dëmtimin e sipërfaqeve të gjelbra, për shembull të barit, i cili është mirëmbajtur për një kohë të gjatë. Prandaj, propozoj që kjo pjesë të hiqet nga propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit.

Kryesuesi i Kuvendit: Z. Brahimi të lutem referoju pikës së saktë për të cilën e ke fjalën, në mënyrë që të jetë e qartë edhe për drejtorin.

Valon Brahimi: Bëhet fjalë për nenin 16, ku përmendet se Drejtoria e Urbanizmit ka kompetencë dhe diskrecion që për evente të caktuara të lejojë shfrytëzimin e hapësirave publike gjelbëruese. Propozimi im është që kjo pjesë të riformulohet ose të hiqet mundësia e dhënies së hapësirave gjelbëruese në shfrytëzim, qoftë edhe për një orë apo dy orë, sepse mund të dëmtohen dhe më pas kërkohet kohë dhe mjete për rikthimin e tyre. Në Mitrovicë kemi pasur raste të tilla, prandaj mendoj se duhet të jemi më të kujdesshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Meqenëse jemi duke diskutuar për një Rregullore dhe për pika konkrete të saj, është e nevojshme që propozimi të jetë sa më konkret. Besoj se edhe Sekretaria e ka të vështirë të përcaktojë se cilin formulim konkret po e propozon.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Valon, po ta jap të drejtën e replikës duke ta përmendur emrin, por është mirë të jesh sa më konkret, sepse personalisht nuk po e kuptoj saktësisht se cilës pjesë po i referohesh. Nga ana tjetër, logjika e propozimit tënd është e kuptueshme. Edhe unë jam për marrjen e masave që parandalojnë mundësinë e dëmtimit të hapësirave të gjelbra, Por, për shembull, në rast se kemi një koncert, një aktivitet apo një ngjarje për qytetarët, është e vështirë që përdorimi i hapësirave të gjelbra të ndalohet në tërësi. Duhet të bëjmë dallimin ndërmjet aktiviteteve që mund të zhvillohen në këto hapësira dhe rasteve kur mund të shkaktohet dëmtim. Prandaj, mendoj se kjo pikë mund të riformulohet ose të specifikohen veprimtaritë dhe rastet në të cilat lejohet apo nuk lejohet shfrytëzimi i hapësirave gjelbëruese. Sa i përket qëllimit të përgjithshëm, ne duhet të synojmë mbrojtjen dhe shtimin e hapësirave të gjelbra. Ambicia ime kryesore është: më pak beton dhe më shumë gjelbërim në qytet. Prandaj, Valon, mund të shqyrtohet mundësia që kjo pikë të riformulohet ose të përcaktohen qartë aktivitetet për të cilat mund të shfrytëzohen këto hapësira.

Valon Brahimi: Bëhet fjalë për nenin 16 të Rregullores. Mendoj se aty duhet të jetë e qartë çështja. Nuk është problem vetëm mbajtja e fushatave apo koncerteve. Të gjitha këto mund të organizohen në sheshe apo hapësira të përshtatshme, nëse prioritet i qeverisjes është mbrojtja e mjedisit. Nëse mbështetemi në parimin e mbrojtjes së mjedisit, duhet të kemi kujdes edhe për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra. Prandaj, propozimi ynë është që mundësia e dhënies së hapësirave gjelbëruese në shfrytëzim të hiqet ose të kufizohet qartë.

Kushtrim Zeneli: Fjala është për nenin 16, paragrafi 3, të Rregullores, i cili përcakton se në këto sipërfaqe publike lejohet shfrytëzimi vetëm në rastet e mbajtjes së ndonjë eventi për qytetarë, si koncert apo mbrëmje kulturore në ambient të hapur. Përveç kësaj, në Rregullore është shtuar edhe një paragraf tjetër, i cili përcakton se këto aktivitete mund të mbahen në hapësirat e qytetit dhe në sipërfaqet gjelbëruese vetëm me pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm. Qëllimi nuk është që aktivitetet të kufizohen vetëm në shesh. Për shembull, aktivitetet e diasporës nuk mund të mbahen gjithmonë vetëm në shesh. Ne jemi që hapësirat gjelbëruese të shfrytëzohen sa më shumë që është e mundur, por në mënyrë të kontrolluar dhe me pëlqimin përkatës. Prandaj, unë propozoj që kjo pikë të mbetet ashtu siç është paraparë në Draft-Rregullore.Mendoj se duhet të kemi një plan konkret për mënyrën e mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra. Në parim, sa më shumë duhet t'i shfrytëzojmë, por njëkohësisht duhet të sigurohemi që ato të mirëmbahen dhe të mos dëmtohen. Ky është qëllimi i propozimit tim.

Visar Syla: Kërkoj që në Rregullore të futet ndalimi i përdorimit të veturave, domethënë të lodrave për fëmijë, në sheshet kryesore, Sheshin „Isa Boletini“, „Mehë Uka“ dhe „Adem Jashari“. Besoj që është rrezik edhe për këmbësorët e tjerë, por edhe për vetë fëmijët, sidomos në kohët e verës, kur ka më shumë njerëz. Ato mund të vendosen, për shembull, në Kej ose diku në ndonjë hapësirë ku është më e sigurt edhe për fëmijët. Edhe tjetra është, sigurisht, që i ka ikur komisioni te neni 16, pika 1, të vendoset si titull, ndërsa kjo tjetra të fshihet. Nuk e di a po e sheh pikën 1 te rregullorja, neni 16; është vetëm gabim teknik.

Ardian Kavaja: Sa i përket nenit 16, pika 3, vetëm po e vazhdoj citimin e Kushtrim Zenelit, po ashtu edhe shqetësimin e Valonit, që në këto sipërfaqe publike lejohet shfrytëzimi vetëm në rastet e mbajtjes së ndonjë eventi për qytetarë: koncerte, mbrëmje muzikore në ambiente të hapura, shfaqje teatrale, poezi, aktivitete kulturore, kinema verore dhe shfaqje filmash në park. Këto aktivitete janë shumë të rëndësishme për qytetin e Mitrovicës dhe nuk mendoj që duhet të ndalohen aktivitetet njëditore apo dyditore në ambientet e gjelbra. Ne e kemi festivalin „Grinfest“, që vetë fjala „Grinfest“, besoj që e dini çfarë nënkupton. Ka qenë kërkesë edhe e operatorëve të festivalit që ky ambient të mbahet në ambient të gjelbër. Poashtu edhe festivali „Verë“ e kemi paraparë që të mbahet në ambiente të tilla. Çfarë kam dashur unë të bëj me këtë veprim është që të ndalohen aktivitetet politike ose mbajtja e fushatave, të cilat në të kaluarën janë mbajtur nëpër hapësira të gjelbra. Sa i përket ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores për hapësirat publike, qëllimi i ndryshimit të Rregullores, ashtu siç kemi diskutuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa është menaxhimi sa më i mirë, mbrojtja dhe shfrytëzimi sa më adekuat i hapësirave publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat aktuale të qytetarëve. Me këto ndryshime, ne si Drejtori për Planifikim dhe Urbanizëm, synojmë të qartësojmë procedurat dhe kompetencat për administrimin e këtyre hapësirave publike, të krijojmë rregulla më të qarta për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike, të sigurojmë trajtim sa më të barabartë dhe transparent për të gjithë aplikuesit dhe më e rëndësishmja, të mbrojmë interesin publik, sigurinë, qarkullimin dhe estetikën urbane. Gjithashtu, synojmë të mundësojmë zbatimin më të lehtë të Rregullores nga organet komunale dhe t'i zvogëlojmë paqartësitë e hasura gjatë zbatimit të saj. Ndryshimet bazë, në pika të shkurtra, që ju t'i keni sa më të qarta, janë ndryshimi i tarifave për anekset, vendosjen e tavolinave, kiosqet dhe reklamat. Po ashtu, me aprovimin e kësaj Rregulloreje, që nuk ka qenë e paraparë më herët, do të tarifohen edhe tavolinat që janë të vendosura jashtë anekseve. Këto tavolina dhe karrige të vendosura jashtë anekseve nuk kanë qenë asnjëherë të tarifuara në shesh. Kështu, tash e tutje, me aprovimin e kësaj Rregulloreje, edhe këto do të tarifohen. Plotësimi i Rregullores për vendosjen e reklamave, të cilat nuk kanë qenë asnjëherë të aplikuara, është një tjetër ndryshim. Unë e kam diskutuar dje për ata që nuk kanë qenë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Në Mitrovicë ka reklama që quhen „totem“. Çfarë nënkupton reklama „totem“? Reklamat „totem“

janë ato reklama të cilat janë të vendosura në markete të mëdha, në kompani të naftës, në banka, të cilat asnjëherë Komuna e Mitrovicës nuk i ka tarifuar. Ka një numër të madh të tyre dhe unë i kam vendosur në Rregullore që të gjitha këto reklama „totem“ të tarifohen. Po ashtu, njëjtë vlen edhe për reklamat „trevision“, që nënkuptojnë tri kahje, edhe këso në Mitrovicë ka shumë dhe ne i kemi vendosur në Rregullore që të tarifohen. Ne kemi edhe aktivitete tradicionale që organizohen nga operatorë të ndryshëm, si „Ditët e Diasporës“ dhe aktiviteti „Verë në Dimër“, këta operatorë kanë vendosur të ashtuquajturat „shtëpia të drurit“ në Shesh, që është në rregull, por asnjëherë nuk kanë kontribuar ose Komuna e Mitrovicës nuk i ka tarifuar për vendosjen e shtëpizave të drurit. Po ashtu, me rekomandim të z. Zeneli, është kërkuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm që të ndryshohet neni 6, pika 3.2, dhe të largohet kërkesa për certifikatën e pronësisë. Këto i kemi diskutuar. Të gjitha rekomandimet e inspektoratit i kemi vendosur, ato të cilat janë të nevojshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor, a mbetet certifikata e biznesit apo hiqet?

Ardian Kavaja: Edhe e biznesit edhe e pronës? Edhe njëherë, të përmirësoj për qartësi: certifikata e pronës largohet.

Valon Brahimi: Drejtor, unë e kuptoj qëllimin e mirë, se duhet gjithçka të vendoset rregullt në qytet dhe pa gabime. Po, ne po vlerësojmë që edhe për ato fushata që mund t'i ketë mbajtur dikush në shesh... Nuk po përmend në parqe publike, nuk po them që the ti, por po e them unë vetë. Edhe është mirë që në të ardhmen të mbrohen hapësirat e gjelbra, sepse ne kemi mundësi t'i mbajmë këto lloj koncertesh e festivalesh. Kemi Qendrën e Kulturës, kemi Muzeun dhe e kemi sheshin e qytetit goxha të madh, të mirë dhe të rregulluar. Propozimi im është që hapësirat e gjelbra të mos kenë qasje nga këmbët e njerëzve, në asnjë version, të mirëmbahen dhe të duken bukur për sy. Nuk është lehtë të mbahet një hapësirë publike dhe nëse fillojmë tash edhe i shkelim, atëherë ku po del muhabeti? Te pjesa e nenit 17, te çështja e tavolinave, është mirë të specifikohet sa ka me qenë distanca e lejuar për vendosjen e karrigeve përtej aneksit, kjo ia lehtëson punën shumë edhe inspektoratit, edhe ia lehtëson punën biznesit. Është mirë të specifikohet sa prej aneksit: një rend, dy rende, 2 m apo 1.5 m, sepse nuk lejohet hapësirë për interpretim sipas dëshirës së biznesit dhe pastaj ka telashe. Ai mund të thotë se këtu thuhet „me arsyetimin e biznesit dhe me pëlqimin e “drejtorisë“. Është mirë të ceket dhe të futet si pjesë përbërëse e këtij neni.

Ardian Kavaja: Besoj z. Brahimi, nuk e ke pasur rastin me lexuar. E kemi vendosur. Është vendosur në shesh deri te rukolla.

Valon Brahimi Është mirë me metër, sepse ato janë diku më të gjera, diku më të ngushta dhe u caktuam referohemi, për shembull, te pjesa nga Sheshi „Adem Jashari“. Sheshi është dyfish më i gjerë sesa pjesa në „Agim Hajrizi“. Tash, nëse ne i lejojmë, po supozojmë duke u bazuar në ato rregulla, në Sheshin „Adem Jashari“ ato biznese kanë të drejtë të vendosin tre tavolina, ndërsa biznesi që është në „Agim Hajrizi“ i lejohet vetëm një rresht tavolinash. Këtu kemi pabarazi ndaj bizneseve. Kjo është, domethënë, kjo ia lehtëson punën më së shumti kolegut që ke përpara, sepse pastaj telashi del në fund të nenit.

Ardian Kavaja: Sigurisht. Në shesh, në ato vende ku momentalisht janë të vendosura tavolinat, ne e kemi vendosur me Rregullore deri ku kanë të drejtë. Po ashtu, e kemi vendosur edhe në fund të nenit një paragraf që lejohet me rekomandim të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm. Nuk i lejohet të gjithëve. Drejtoria vendos për cilët operatorë lejohet e për cilët jo. Kështu që ajo e qartëson, besoj, të gjithëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit, drejtor. atëherë ne kemi një kërkesë nga drejtori, e cila është diskutuar edhe dje në Komitetin për Politikë dhe Financa, që neni 6, pika 1.2, certifikata e biznesit dhe pronës, të fshihet dhe e pronës dhe të mbetet certifikata e biznesit. Veç për sqarim, a i kontribuon Rregullores kjo?

Shkëlqmi Ibrahimi: Po, më intereson që me u largu certifikata e pronës, çka i lehtëson bizneset?

Ardian Kavaja: Kemi, për shembull, operatorë që e vendosin reklamën dhe kanë të drejtë të aplikojnë për këtë punë. Kemi operatorë që e vendosin reklamën si biznes, por e vendosin në një objekt që nuk e ka certifikatën e pronësisë.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e hedh në votim, Draft-Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike me vërejtjen e cila u dha te neni 6, pika 1.2.

**Rezultati i votimit 24 për, 1 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit konstatoj se u miratua Draft-Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 01/2023 Për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike me vërejte.**

**Pika e 3**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin.

Kryesuesi i Kuvendit pasi konstatoj se nuk ka të lajmëruar për diskutim e hedh në votim Propozim vendimin për organizimin e konkursit dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë. Në sallë janë të pranishëm 25 anëtarë.

**Rezultati i votimit: 23 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se u miratua unanimisht Vendimi për organizimin e konkursit komunal dhe ndarjen e çmimeve për kopshtin, ballkonin, sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë.**

**Pika e 4**

Kryesuesi i Kuvendit: Meqenëse të gjitha këto pika kanë të bëjnë subvencionim, po e hap diskutimin per te gjitha propozimet dhe në fund i miratojmë veç e veq. A pajtoheni që të vazhdojmë me këtë metodë? Në këtë kuadër, e shpall të hapur diskutimin për pikat nga pika 4 deri në pikën 17, ku përfshihet edhe propozimi i Kryetarit, si pikë 17, për mbështetje financiare për festivalet tradicionale. Hap diskutimin.

Shkëlqim Ibrahimi: Unë e kuptoj që, parimisht, sipas nenit 5 të Rregullores, ju keni të drejtë edhe 5% të shumës së përgjithshme me i dhënë, ose 500 € për subvencionim të OJQ-ve, domethënë si kompetencë direkte jashtë Rregullores. Mirëpo, me u kriju kjo praktikë, domethënë, cila është logjika që po mbetet? Pse me ekzistu rregullorja? Unë po e kuptoj që është e drejtë dhe e keni shumën e përcaktuar e keni respektuar Rregulloren, mirëpo do të ishte më mirë që herëve të ardhshme të bëhet thirrja publike, qysh e parasheh Rregullorja, dhe me konkurrim në mënyrë të barabartë, që të kenë mundësi të paktën me fitu më shumë, qoftë këtu ku ka nevojë. Po një konkurrencë e barabartë do t'u jepte mundësi edhe të tjerëve, sepse, nëse vazhdohet në këtë trend, atëherë realisht, përkundër të drejtës në kuadër të Rregullores, po diktohet subvencionimi, pa vënë në dyshim që kanë nevojë këto organizata që të funksionojnë. Absolutisht e kuptoj rëndësinë edhe e përkrahë. Mirëpo të mos krijohet si praktikë në të ardhmen dhe të respektohet Rregullorja, qysh e parasheh, përmes thirrjes publike, në mënyrë që të përfitojnë edhe më shumë, sepse, sa pashë, buxhet ka. Përndryshe, sa i përket ligjit, është gjithçka në rregull.

Gëzim Stavileci: Desha të bëj një propozim te pika e katërt, për mbështetjen financiare për Z. Sabri Çabra. Drejtori e ka sjell pikën e rendit të ditës në Kuvend po e kisha sygjeruar drejtorin që ta tërheqë pikën edhe ta fusë në Rregulloren për subvencionim individual, për shkak se ne e dimë që periudha një mujore është p[wr shqyrtim tw ligjshmersë së vendimit nga MAPL-ja. Kështu, me

Rregulloren për subvencionim individual, menjëherë kërkesën e shqyrton komisioni dhe mund të subvencionohet personi në fjalë, e dimë ndjeshmërinë e personit, e dimë edhe garën, kështu që e kisha bërë si propozim edhe mundësi ligjore është me shku përmes subvencionimit individual, deri në 1.000 € është mundësia. Ashtu kështu, deri në 500 € e keni paraparë subvencionimin. Edhe pjesa tjetër, e ke buxhetin e Njësise të të Drejtave të Njeriut, 20.000 € të parapara për persona me aftësi të kufizuara dhe çështje gjinore. Te pika e pestë, organizata REC ka kërkuar mbështetje. Drejtor, e kam lexuar kërkesën. Ka kërkuar mbështetje institucionale dhe shfrytëzimin e hapësirave publike. Bashkë me kërkesën nuk kam parë kërkesë për mbështetje financiare. Nuk e di, gjatë diskutimit, a keni diskutuar për mbështetje financiare, por në kërkesë nuk e kanë cekur që kanë nevojë për mbështetje financiare. Parimisht, është në rregull, por ti e di që në kërkesa duhet të jenë të evidentuara. Kërkesat janë shumë të paplotësuara, drejtor. Nuk është paraparë buxheti. Më la përshtypje zëri i prindërve, i cili kishte bërë një përshkrim të buxhetit se ku ka me i shpenzua.

Kështu që, herëve të tjera, të lutem drejtor, edhe organizatat të bëjnë një përshkrim të buxhetit. Ne e dimë që janë shpenzimet e zyrës nga 500 €, por veç le ta bëjnë një përshkrim të buxhetit, që ta dimë për çfarë po votojmë.

Sazan Ramaxhiku: E kam një pyetje për drejtorin e Mirëqenies Sociale. Përse nuk ka pasur shpallje publike për subvencionimin dhe përkrahjen e OJQ-ve lokale gjatë dy viteve të fundit?

Erseka Barani: Atëherë, desha të ndërlidhem, meqenëse është diskutimi në pako e këtyre pikave për mbështetje financiare. Desha të ndërlidhem te pika 14, ku ka të bëjë me propozim vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 250 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut, si dhe propozim-vendimin, apo pika 15, për mbështetje financiare në shumën prej 500 € për mbulimin e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve „Raba Voca“ në Mitrovicë. Desha të përgëzoj drejtorin e Mirëqenies Sociale dhe Kryetarin që kanë aprovuar propozimin tim në seancën e kaluar për mbështetje financiare për viktimat e dhunës në familje. Vlen të theksohet se shumë pak komuna e kanë marrë këtë vendim për përkrahje të viktimave të dhunës në familje. E dimë që kjo shumë është shumë simbolike, mirëpo me të vërtetë e përgëzoj ekzekutivin që ka marrë vendim dhe e ka sjellë këtë propozim vendim dhe kërkoj para jush, asambleistë dhe kolegë të nderuar, që ta votojmë këtë propozim vendim dhe të bëhemi prej komunave të pakta për mbështetjen e kësaj kategorie. Njëkohësisht, përgëzoj edhe drejtorin e Mirëqenies Sociale që e ka gjetur një formë për pagesën e qirasë për Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve „Raba Voca“, për shkak se për katër vite me radhë nuk është paguar qiraja në këtë qendër. Kështu që, ju faleminderit shumë dhe kërkoj mbështetjen edhe të kolegëve të tjerë të asamblesë për votimin e këtyre pikave.

Kushtrim Zeneli: Unë e kam vetëm një pyetje, Përveç ndihmës dhe përkrahjes së këtyre organizatave të dala nga lufta, si po mbeten me projektet kapitale të objektit të moshës së tretë dhe shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve? Sepse besoj që janë shumë të rëndësishme për këto kategori dhe për këta mekanizma që të bëjnë diçka.

Ramadan Beshiri: Po ashtu e kam pyetjen e njëjtë sa i përket shpalljes publike që dy vitet e fundit. Mandati im fillon prej 16 janarit dhe unë nuk kam mundur ta projektoj buxhetin e këtij viti, që nënkupton se për shpallje publike të OJQ-ve kërkohet që financimi të bazohet në planifikim buxhetor. Edhe bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, duhet të ketë paraplanifikim për të mundur të bëhet një planifikim për shpallje publike. Tani, këtë e rregullojnë edhe Rregulloret që i kemi komunale për subvencionimin e OJQ-ve dhe nuk ka pasur mundësi për shpallje publike, sepse nuk ka qenë e planifikuar. Ndërsa, sa i përket buxhetit, buxheti shihet që ka në subvencione, mirëpo një pjesë shumë e madhe e tyre duhet t'i delegohet, apo 158.000 €, mbulimit të varrimeve nga Këshilli i Bashkësisë Islame. Kështu që mbetemi në deficit sa i përket buxhetit, nëse synojmë të bëjmë shpallje publike të caktuar. Sa i përket pyetjes së dytë të z. Stavileci, këtë formë të përkrahjes së z. Sabri Çabra

që është një parasportist që do të marrë pjesë në Kampionatin Botëror në Pilzen Boka, e kam përkrahur sepse drejtoria ime e ka për sipër trajtimin e personave me aftësi të kufizuara. Ndërsa, sa i përket formës, ju shumë mirë e keni thënë. Ne jemi dakorduar me DKRS-në, që do ta përkrahë në formën e vet dhe ne kemi pasur mundësi që me 500 € ta subvencionojmë në këtë formë, siç subvencionohen edhe OJQ-të. Ndërsa mbështetja për REC-in, REC është një organizatë që avokon shumë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe nuk është e domosdoshme ndoshta që të jetë e shkruar aty, se ne kemi pasur takime me të gjitha organizatat që merren me shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuara. Si rezultat i një hulumtimi të REC-it, ne kemi mundësi të dimë sa persona me aftësi të kufizuara janë pjesë e administratës dhe a e kemi arritur 50+1, kjo ka qenë arsyeja që t'i përkrahë me 500 € për disa obligime që janë ndoshta taksa komunale apo komunali, në mënyrë që ata ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre. Znj. Berani, faleminderit shumë për propozimin, po edhe për mbështetjen e menjëhershme nga kryetari. Janë 18 viktima të dhunës deri më tani, 16 gra dhe dy meshkuj. Deri në fund të vitit, sa do të ketë viktima, ne do t'i mbështesim me nga 250 €. Për ta lehtësuar këtë çështje të subvencionimit edhe të OJQ-ve edhe të viktimave të dhunës ne kemi me sjellë së shpejti, këtë vit Planin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, plan i cili ka munguar për një kohë të gjatë. plani nuk ka kaluar në Kuvend edhe pse është obligim ligjor bazuar në Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare. Dhe tani nuk i kemi më këto probleme të subvencionimit të OJQ-ve për nevoja të caktuara të terapive e mekanizmave të viktimave të dhunës, por do ta bëjmë të përhershme, bazuar në Planin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare. Për QMGF “Raba Voca” nuk është e mjaftueshme për qiranë, mirëpo bazuar në Rregulloren e OJQ-ve komunale, kemi të paraparë që limiti apo tavani të jetë 500 €, ne kemi me provua prapë me ndihmu. QMGF „Raba Voca“ së shpejti nuk do ket nevojë më me pagu qira, sepse do ta shfrytëzojë objektin e ri për strehimin e viktimave të dhunës. Edhe investimet kapitale që e përmendi Kushtrim Zeneli, po jemi në fazën e ndarjes së parcelës, procedurat janë duke ecur së bashku me drejtorin Nazmi Kelmendin edhe me drejtorin Ardian Kavaja, i kemi të garantuara investimet kapitale edhe për shtëpinë e moshës së tretë, edhe për shtëpinë e mbrojtjes së fëmijëve. Vetëm po e shikojmë pozicionin më të mirë, sepse bazuar në udhëzimet e reja administrative, duhet një lokacion dhe një vend i cili gjendet në komunitet, e jo të margjinalizohet në periferi të Qytetit.

Valon Brahimi: Rekomandim, meqenëse bëhet fjalë për një kategori shumë të ndjeshme, Pra 250 € nuk janë të mjaftueshme, nuk është se nuk janë kurrgjë sepse vullneti i mirë mjafton. Por, nëse ka mundësi, pse të mos bëhen 350 €? Ky është rekomandimi ynë.

Kryesuesi i Kuvendit atëherë fillojmë me votim të propozim vendimeve veç e veç.

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500€ për z. Sabri Çabra, dhe konstatoj se 27 anëtarë të kuvendit janë të pranishëm në sallë.

**Rezultati i votimit 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për z. Sabri Çabra.**

**Pika e 5**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare të OJQ-së “REC” në Mitrovicë në shumë prej 500 €.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare të OJQ-së “REC” në Mitrovicë në shumë prej 500 €.**

**Pika e 6**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500€ për OJQ-së “OPFAKOS” – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare të OJQ-së “OPFAKOS” në Mitrovicë, në shumë prej 500 €.**

**Pika e 7**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për të OJQ-së “Së Bashku” – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare të OJQ-së “Së Bashku” në Mitrovicë në shumë prej 500 €.**

**Pika e 8**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për „ të OJQ-së “Zëri i Prindërve” – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për mbështetje financiare të OJQ-së “Zëri i Prindërve” – Mitrovicë në shumë prej 500 €.**

**Pika e 9**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare për Shoqatën “Minatori ’89” – Mitrovicë në shumë prej 500 €.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për Shoqatën “Minatori ’89” – Mitrovicë.**

**Pika e 10**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € të OJQ-së “HANDIKOS” – Mitrovicë.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime**.

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare të OJQ-së “HANDIKOS” në Mitrovicë në shumë prej 500 €.**

**Pika 11**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë.

**Rezultati i votimit 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë.**

**Pika e 12**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për Shoqatën e të Shurdhërve në Mitrovicë.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare për Shoqatën e të Shurdhërve në Mitrovicë, në shumë prej 500 €.**

**Pika e 13**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 250 € në muaj për tetë familje nga Bajri.

Valon Brahimi: Unë jam kundër, e pata një vërejtje më herët.

Kryesuesi i Kuvendit: Z. Brahimi ju e patët një vërejtje tjetër besoj që nuk u lidhë me kete, pra edhe një herë Pika 13 Propozim-vendim për mbështetje financiare në shumë prej 250 € në muaj për tetë familje. Domethënë, për çdo muaj.

Valon Brahimi: Unë jam kundër që të paguhen vetëm 8 familje, ndërsa të tjerat të mbesin pa u paguar. Nuk bën të ndahen.

Kryesuesi i Kuvendit: Kemi edhe të tjerë. Z. Brahimi shkojmë me këto. Nëse ka bazë tjetër, në seancën tjetër e bëjmë edhe për pjesën tjetër të familjeve që nuk janë tetë, sepse janë më shumë.

Ramadan Beshiri: Ne i kemi specifikuar tetë familje, sepse në raport me gjendjen emergjente janë 12 familje, ndërsa në përgjithësi janë rreth 30 e më shumë. Mirëpo, problemi është se nuk ka buxhet të mjaftueshëm.

Valon Brahimi: Prandaj, pyetja ime është: a do të ndihmohen edhe familjet e tjera? Sepse, nëse ndahen mjetet vetëm për disa familje dhe të tjerat mbesin pa u përfshirë, atëherë si Kuvend dalim keq. Besoj se po kuptohemi.

Kryesuesi i Kuvendit: Në regull, atëherë po mbetet që në seancën tjetër të na vijë një informatë më e detajuar në raport me këtë çështje. Pra, bëhet fjalë vetëm për familjet që janë detyruar të largohen nga shtëpitë, me qëllim që të mbështeten.

Kryesuesi i Kuvendit atëherë meqenëse nuk ka diskutime të tjera e hedh në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € në muaj për tetë (8) familje nga Bajri.

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 250.00 € në muaj për tetë (8) familje nga Bairi.**

**Pika e 14**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 250 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

**Rezultati i votimit:(të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 250 € për viktimat e dhunës gjatë vitit 2026 në Komunën e Mitrovicës së Jugut**

**Pika e 15**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për mbulimin e qirasë së Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve „Raba Voca“ në Mitrovicë, dhe konstatoj se 27 anëtarë janë të pranishëm në sall.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për mbështetje financiare për mbulimin e qirasë së Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve „Raba Voca“ në Mitrovicë në shumë prej 500 €.**

**Pika 16**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumë prej 500 € për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-së “Doën Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për mbështetje financiare për ofrimin e shërbimeve sociale dhe rehabilituese të OJQ-së “Doën Syndrome Kosova” – Dega në Mitrovicë në shumë prej 500 €.**

**Pika e 17**

Mbështetje financiare në fushën e kulturës dhe aktiviteteve artistike dhe festivalet tradicionale.

**17.1**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim-vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 5000.00 € të Festivalit “Green Fest”.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 5000.00 € të Festivalit “Green Fest”.**

**17.2**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 5000.00 €” Festivali Tradicional i Komedisë.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin për mbështetje financiare Festivalit Tradicional, në shumën prej 5000.00 €.**

**17.3**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 7000.00 € të “Mitrovica International Jazz Festival Days”

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht për mbështetje financiare të “Mitrovica International Jazz Festival Days” në shumën prej 7000.00 €.**

**17.4**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 5000.00 € të Festivalit të Pianos.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht vendimin mbështetje financiare të Festivalit të Pianos, në shumën prej 5000.00 €.**

**17.5**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin për mbështetje financiare në shumën prej 3000.00 € të Festivalit të Këngës së Fëmijëve “Cicërimat buzë Ibrit”.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht për mbështetje financiare të Festivalit të Këngës së Fëmijëve “Cicërimat buzë Ibrit” në shumën prej 3000.00 €.**

**17.6**

Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim Propozim vendimin Për mbështetje financiare në shumën prej 4000.00 € të Mitrovica Art Colony.

**Rezultati i votimit (të pranishëm 27) 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të miratuar unanimisht Vendimin për mbështetje financiare të Mitrovica Art Colony në shumën prej 4000.00 €.**

**Pika e 18**

Kryesuesi i Kuvendit: sa i përket Raportit financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën janar–qershor 2026, e hap për diskutimin.

Shkëlqim Ibrahimi: Faleminderit, Unë kam vetëm disa pyetje, Nëse keni mundësi, ju lutem të më përcillni te faqja 4, te planifikimi dhe realizimi i të hyrave tatimore. Sa është përqindja e saktë? Gjithashtu, ju lutem të më tregoni se si është arritur vlera totale prej 105.45%. Te planifikimi dhe realizimi i të hyrave tatimore, mund të ketë tejkalim të planifikimit, por trendi siç është paraqitur këtu duket i pamundur. Prandaj, do të doja të dija saktësisht se si është përllogaritur kjo përqindje. Gjithashtu, sa është përqindja e shpenzimeve kapitale dhe a është vetëm 13%, siç paraqitet në faqen 6? Te pasqyra e pranimeve dhe pagesave, pse nuk po shpenzohet buxheti kapital, keni ndonjë shënim apo sqarim lidhur me këtë? Te tabela 3.2, në faqen 16, si është e mundur të konstatohet se janë realizuar 52% të shpenzimeve kapitale kur nuk janë paraqitur të gjitha investimet kapitale apo i gjithë buxheti kapital? Gjithashtu, çfarë ka ndodhur me kontratat aktive, sepse ne kemi një tabelë të cunguar jashtë raportit, konkretisht, çfarë ka ndodhur me rrugët në Koprivë, të cilat janë planifikuar në vlerë prej 213,000 €, me rrugën në Bajr në vlerë prej 130,000 € dhe me kontratat për rrugët e tjera? Pse nuk janë pasqyruar në raport rrugët që janë përfunduar, p.sh. rruga në Melenicë, e shtruar më 24 maj, të cilën e ka prezantuar edhe Kryetari në rrjetet sociale, nuk është e pasqyruar në këtë raport. Gjithashtu, çfarë ka ndodhur me çështjen e gjeneratorit të paraparë në QKMF, duke pasur parasysh se ka ankesa për probleme me furnizimin me energji elektrike? Çështja kryesore që dua të ngrit në lidhje me raportin financiar është urdhri përmbarimor 325/23 ndaj Astraplan SHPK-së dhe Zyrës Përmbarimore Isaku SHPK, nuk e di nëse jeni në dijeni, drejtor, por unë posedoj dokumentacion që tregon se ka kallëzim penal ndaj operatorit ekonomik edhe ndaj përmbaruesit. Poashtu ka komunikim zyrtar ndërmjet përfaqësuesit ligjor të komunës dhe institucioneve përkatëse, ku kërkohet që ky urdhër përmbarimor të hiqet nga lista e ekzekutimeve. Urdhëri përmbarimor 325/23 ndaj Astraplan SHPK-së dhe Zyrës Përmbarimore është çështje për të cilën unë posedoj dokumentacion, përfshirë kallëzimin penal dhe komunikimin zyrtar që dëshmon se është kërkuar të hiqet nga lista e përmbarimeve. Nëse ky urdhër nuk është hequr dhe është ekzekutuar nga Thesari, a ka mundësi të dihet nëse është njoftuar Thesari për këtë gabim? Sepse bëhet fjalë për një çështje që, sipas dokumentacionit që posedoj, lidhet edhe me një kallëzim penal. Më konkretisht, ka edhe vendim dhe kallëzim penal, si dhe komunikim zyrtar lidhur me këtë çështje. Po, por a e dini se Ministria e Financave më saktësisht Departamenti i Thesarit ka vepruar menjëherë herën e kaluar kur ka ardhur ky komunikim zyrtar? Gjithashtu, bëhet fjalë për një vlerë prej 273 €, e cila, edhe pse nuk është shumë e madhe në vlerë absolute, është ekzekutuar dhe është reflektuar në listën e ekzekutimeve përmbarimore, konkretisht për operatorin ekonomik Astraplan dhe Zyrën Përmbarimore SHPK. Shkurtimisht, unë nuk e di saktësisht se cilat kanë qenë projektet. Mua më intereson kjo çështje: ekziston komunikim zyrtar, ekziston kallëzim penal konkret dhe ka pasur reagim nga Departamenti i Thesarit në kohën tonë. Tani më intereson të di se çfarë ka ndodhur dhe pse është ekzekutuar kjo shumë. Drejtor, do të kisha dashur të merrja një sqarim konkret edhe lidhur me mënyrën se si janë reflektuar këto vlera në total. Për shembull, nëse në muajin e parë kemi pasur 13%, si është e mundur që më pas të paraqitet 105.45%? A nënkupton kjo se plani është tejkaluar apo ka ndonjë gabim në përllogaritje për shkak të mungesës së rubrikave? Jo, unë e di se çfarë është bërë, ajo që më intereson është që ne të na sqarohet saktësisht se çfarë ka ndodhur.

Erseka Barani: Dua ta falënderoj Drejtorinë e Financave për hartimin e këtij raporti gjashtëmujor. Dua të ndalem te krahasimi i inkasimit të të hyrave vetanake me planifikimin dhe me vitin paraprak. Mendoj se në disa pozicione dhe në disa drejtori ka një dallim të dukshëm në inkasimin e të hyrave,

për çka dua të falënderoj edhe drejtorët komunalë, meqenëse kjo është mjaft e rëndësishme sa i përket Komunës së Mitrovicës dhe inkasimit të të hyrave. Unë dua të ndalem te tabela 2.4, përkatësisht te kategoria „Mallra dhe Shërbime“. Dua të bëj një krahasim me raportin e vitit 2025 për të njëjtën periudhë kohore, pasi në disa kode kam pasur paqartësi. Konkretisht, te kodi 14310, „Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit“, në vitin 2025, për të njëjtën periudhë kohore, janë shpenzuar nga paratë publike 83,806 €, ndërsa këtë vit, për periudhën janar–qershor, janë shpenzuar vetëm 13,137 €. Pastaj, te kodi 14060, „Mirëmbajtja rutinore“, për të njëjtën periudhë, janar–qershor 2025, janë shpenzuar 267,799 €, ndërsa për të njëjtën periudhë të këtij viti janë shpenzuar 46,857 €. Pra, kemi një dallim shumë të madh. Vazhdojmë te nafta për ngrohje qendrore. Për vitin 2025, për të njëjtën periudhë kohore, janë shpenzuar 76,102 €, ndërsa këtë vit vetëm 21,287 €. Po ashtu, te kodi 13640, „Furnizimet e pastrimit“, për të njëjtën periudhë kohore, në vitin 2025 janë shpenzuar 30,313 €, ndërsa këtë vit vetëm 18,860 €. Ajo që më ka bërë përshtypje ka qenë se gjatë katër viteve të kaluara, për shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës, pavarësisht se Komuna e Mitrovicës e ka një avokat, janë angazhuar edhe kompani private për përfaqësimin e komunës në procese gjyqësore. Fatkeqësisht, janë shpenzuar para publike dhe asnjëherë nuk kemi pasur një raport të qartë se çfarë ka ndodhur me ato përfaqësime apo nëse komuna ka fituar ndonjërën prej atyre lëndëve. Vetëm për gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar, për këtë kategori janë shpenzuar 8,496 €, ndërsa këtë vit kjo shumë nuk është shpenzuar. Kjo do të thotë se komuna po e shfrytëzon avokatin që ka për përfaqësimin e saj në çështjet gjyqësore. Vazhdojmë te kodi 1345, „Shërbime kontraktuese të tjera“. Për të njëjtën periudhë të vitit 2025 janë shpenzuar 300,290 €, ndërsa për këtë vit vetëm 170,273 €. Pastaj kemi shpenzimet e anëtarësimit, ku në vitin 2025 janë shpenzuar 17,650 €, ndërsa në vitin 2026 janë shpenzuar 9,711 €. I kam bërë këto krahasime sepse kam vlerësuar se në këtë raport ka qenë shumë i rëndësishëm kujdesi ndaj shpenzimit të parasë publike. Kjo do të thotë se këtë herë ekzekutivi është munduar ta kursejë paranë publike, është munduar të jetë shumë i përgjegjshëm me paranë publike, të tregojë kujdes dhe të jetë transparent me shpenzimet e parasë publike. Një tjetër tabelë që e kam vlerësuar se duhet patjetër të theksohet është ajo e obligimeve të papaguara. Për vitin 2025, për të njëjtën periudhë kohore, obligimet e papaguara kanë qenë 568,992 €, ndërsa për vitin 2026 janë vetëm 256,901 €, kjo do të thotë se komuna është e kujdesshme edhe me obligimet që i merr përsipër. Edhe diçka tjetër që është shumë me rëndësi dhe shumë positive, pavarësisht se gjatë katër viteve të kaluara, kushdo që ka qenë pjesë e Komitetit për Politikë dhe Financa e di shumë mirë se, së bashku edhe me kolegen Xhuli, kemi kërkuar që këtij raporti t’i bashkëngjitet edhe tabela me urdhrat përmbarimorë. Gjithmonë është dashur të kërkohet ajo tabelë dhe nuk është bashkëngjitur vetvetiu. Në raportin paraprak të vitit 2025, për periudhën janar–qershor, kjo tabelë nuk ka qenë e përfshirë. Prandaj, e përgëzoj Drejtorinë e Financave dhe njëkohësisht e inkurajoj që në çdo raport të ardhshëm të bashkëngjitet kjo tabelë, sepse është shumë e rëndësishme. Është pozitive se në këtë tabelë, krahasuar me vitin e kaluar ku Thesari ka bërë ekzekutimin e pagesave në kategorinë e investimeve kapitale, në vitin e kaluar, për të njëjtën periudhë kohore, janë ekzekutuar 2,220,948 €. Kjo do të thotë se të gjitha investimet kapitale për periudhën janar–qershor janë ekzekutuar. Ndërsa këtë herë, në bazë të kësaj tabele, dukshëm kjo kategori është kursyer. Faleminderit shumë, Kryetar, sepse në këtë kategori, përmes përmbarimeve nga Thesari, janë ekzekutuar vetëm 93,000 €. Kategoria e investimeve kapitale është tepër e rëndësishme për qytetarët e Komunës së Mitrovicës dhe kjo dukshëm po shihet se sa të rëndësishëm kanë qenë qytetarët e Komunës së Mitrovicës gjatë mandatit tuaj, meqenëse pikërisht nga kjo kategori, ku ata preken drejtpërdrejt, janë marrë mjete përmes ekzekutimeve nga Thesari. Qëllimi i këtij diskutimi ka qenë të bëj një krahasim dhe në fund dua të falënderoj shumë edhe ekzekutivin edhe drejtorët, të cilët me të vërtetë kanë bërë një punë të shkëlqyer gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti. I përgëzoj dhe kërkoj që me të njëjtën përgjegjësi të vazhdojnë deri në fund të mandatit.

Xhyljeta Imeri: Ju falënderoj për përgatitjen e raportit financiar për periudhën janar–qershor 2026. Sipas këtij raporti, inkasimi i të hyrave vetanake është rreth 50% më i lartë se në vitin e kaluar. Ky është një tregues pozitiv dhe për këtë ju përgëzoj. Por, në anën tjetër, realizimi i investimeve kapitale është vetëm 30%, dhe kjo është jashtëzakonisht shqetësuese. Investimet kapitale përfshijnë rrugë të paasfaltuara, trotuare të papërfunduara, mungesë të ndriçimit publik, shkolla, çerdhe dhe projekte të tjera që qytetarët me të drejtë i presin. Qytetarët nuk e vlerësojnë punën tonë vetëm nga të hyrat e inkasuara, por edhe nga projektet që realizohen në terren. Prandaj, një realizim prej vetëm 13% në gjysmën e parë të këtij viti ngre pikëpyetje serioze lidhur me dinamikën e punimeve dhe menaxhimin e investimeve kapitale. Do të ishte me interes të dimë cilat janë arsyet konkrete të kësaj performance kaq të ulët dhe çfarë masash do të ndërmerren që deri në fund të vitit të përshpejtohet realizimi i projekteve të planifikuara.

Liridona Muharremi: Unë kam tri çështje që dua t'i diskutoj dhe t'i parashtroj si pyetje. Sa i përket çerdhes „Tek Desi“, për këtë vit janë planifikuar mjete në vlerë prej 280,000 €, ndërsa projekti është i kontraktuar, megjithatë, nuk po vërehet realizimi i punimeve sipas planit dinamik. Kërkoj sqarim se cilat janë arsyet e vonesave, në çfarë faze ndodhen aktualisht punimet dhe çfarë masash janë ndërmarrë ndaj operatorit ekonomik për respektimin e afateve kontraktuale. Po ashtu, çfarë ka ndodhur me projektet për ndërtimin e çerdheve në Vaganicë dhe në Kçiq, ajanë iniciuar procedurat e prokurimit dhe a janë këto projekte afër nënshkrimit të kontratave? Nëse procedurat kanë filluar, kërkoj të dimë se në cilën fazë ndodhen dhe pse këto projekte nuk janë pasqyruar në raportin financiar. Edhe një çështje tjetër me rëndësi janë rrugët e planifikuara në Fshatin Zhabar, komunitet të cilit i përkas edhe unë personalisht, për këto rrugë janë planifikuar gjithsej 270,490 €, mirëpo në raportin financiar nuk është paraqitur asnjë informacion lidhur me realizimin e tyre. Kërkoj një sqarim të plotë se cilat rrugë janë përfshirë në këtë shumë, në cilën fazë ndodhen procedurat, nëse janë nënshkruar kontratat, nëse kanë filluar punimet dhe cilat janë arsyet pse këto mjete nuk janë reflektuar në raportin financiar.

Shkëlqim Ibrahimi: Pata vetëm një pyetje për znj.Barani, sa i përket çështjes së operatorit ekonomik Astraplan. Besoj se ajo ka pasur një përvojë me këtë çështje dhe mund të na tregojë më shumë, duke e lidhur edhe me temat e urdhrave përmbarimorë. Çështja është se sa ka qenë operator i përgjithshëm dhe i ka kryer punimet dhe pse ka ardhur deri në këtë pikë. Besoj se në atë kohë ajo ka qenë drejtoreshë dhe u kërkua një raport nga avokati. Unë do të preferoja që të sillnim edhe raportin e zyrës ligjore ose të avokatit të komunës, si për mandatin tonë, ashtu edhe për mandatin e kaluar. Në kuadër të kësaj, ka qenë edhe kërkesa e z. Kushtrim Zeneli që të sillet raporti për pronat dhe borxhet. Pra, t'i shterim këto tema, t'i diskutojmë dhe të shohim kush ka privatizuar, kush ka dhënë, kush ka këmbyer prona, ku është dashur dhe ku nuk është dashur të bëhen këto veprime. Të shohim edhe sot, kur ju keni ardhur në pushtet, çfarë kanë bërë zyrtarët e Vetëvendosjes: a kanë vazhduar të punojnë, a kanë avancuar në punë dhe çfarë është bërë gjatë kësaj periudhe. Do të ishte me shumë interes që këto çështje t'i trajtojmë bashkërisht, duke e marrë edhe raportin e kaluar dhe duke i krahasuar. Sepse, në fund të fundit, i gjithë ky raport është kryesisht një krahasim dhe realisht nuk ka ndonjë tabelë të plotë që tregon se sa është realizuar plani i të hyrave. Edhe formati i raportit është ndryshuar. Kjo është pikërisht arsyeja pse e parashtrova pyetjen se si është arritur deri te shifra 105.5% dhe si është përllogaritur kjo vlerë, e cila duket e pazakontë. Prandaj, nëse duam të bëjmë krahasime, duhet t'i marrim fazë për fazë. T'i marrim raportet e avokatëve të komunës prej vitit 2017 e tutje dhe t'i shqyrtojmë rastet përkatëse, të shohim edhe se ku janë avokatët dhe cilat raste janë trajtuar. Andaj kur ju thërrasin shokët mos u tërhiqëni, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështjet e pronave, duhet të kemi kujdes dhe t'i shqyrtojmë rastet kur janë bërë këmbime pronash, për shembull në Ëaçicë, ku

prona është dhënë në qytet apo në qendër të qytetit. Në rregull, por kur bëhen akuza, duhet të ketë përgjegjësi edhe për atë që ka ndodhur në të kaluarën.

Erseka Barani: Unë nuk kam bërë akuza; kam bërë një krahasim të raporteve dhe të dokumenteve.

Shkëlqim Ibrahimi: A tash po tërhiqet. Çështja është kjo: në mandatin e kaluar, një asambliste ka bërë kërkesë dhe është ekzekutuar nga Thesari pagesa e mjeteve, për shembull për paga apo shujta, për të cilat ka pasur padi. Kur janë përfunduar paditë, janë marrë mjetet përmes përmbaruesit. Prandaj, nuk mund t'i lëmë të gjitha këto si akuza ndaj ekzekutivit aktual. Duhet të shohim se çfarë ka bërë Thesari dhe çfarë ka qenë në kompetencën e tij, sepse jo çdo veprim ka qenë në dorën e ekzekutivit. Nesër mund të vijnë edhe paditë për përvojën e punës dhe duhet të shohim se çfarë do t'i kërkohet kryetarit. A është kryetari fajtor pse një kërkesë apo një vendim i ka ardhur nga një zyrë tjetër apo nga Thesari? Mund të dalë se paditë për përvojën e punës i kanë bërë vetë zyrtarët e komunës. Prandaj, duhet të bëhen akuza reale dhe të bazuara në përgjegjësi konkrete, jo krahasime për çështje që nuk janë në dorën e ekzekutivit.

Erseka Barani: Unë vetëm desha të sqaroj se realisht kam bërë një krahasim të raportit të vitit 2025 me raportin e vitit 2026. E krahasova punën, inkasimin e të hyrave dhe shpenzimin e parasë publike. Njëkohësisht, bëra thirrje dhe njoftova se, sa i përket një operatori ekonomik që ka qenë i angazhuar nga komuna, ai nuk ka qenë i angazhuar në mandatin tonë, por gjatë mandatit të PDK-së, ekskluzivisht për përfaqësimin e komunës në seancat gjyqësore. Asgjë tjetër. Sa i përket Astraplanit, unë nuk e di dhe nuk kam informacion të mjaftueshëm, për më tepër nuk jam pjesë e ekzekutivit. Prandaj, të lutem, pyetjen drejtoje te organet kompetente dhe jo te unë. Unë nuk të përmenda ty dhe nuk e drejtova këtë çështje ndaj teje. Unë nuk isha duke u marrë me ty, por me një çështje konkrete dhe me një krahasim shumë të thjeshtë, të bazuar në dokumentet që i kam përpara, të cilat nuk i kam vetëm unë, por i kanë të gjithë anëtarët e kësaj asambleje.

Gëzim Stavileci: Çështja e parë është në lidhje me të hyrat vetanake dhe inkasimin. A ka mundësi, drejtor, që sipas planit të na sillni tabelën dhe të mos sillni më tabela fiktive në krahasim me vitin 2025? Ne e dimë këtu në Kuvend që kemi votuar një plan për inkasimin e të hyrave. Nëse duam t'i raportojmë drejt dhe në mënyrë transparente qytetarit, raportimin duhet ta bëjmë sipas planit të të hyrave. Kryetar, ju e dini këtë pjesë, pasi keni qenë pjesë e shumë ekzekutiveve, nëpër ministri, në komunë dhe në asamble. Realisht, kjo tabelë nuk qëndron. Nuk qëndron dhe drejtori e di që nuk qëndron. Të lutem, drejtor, kërkoje nga stafi, nga ZKF-ja, që për pesë minuta mund ta nxjerrë tabelën. Besoj se e ka dhe mund ta sjellë inkasimin real të të hyrave të Komunës së Mitrovicës, të krahasuar me planin dhe jo me vitin e kaluar. Sepse zakonisht çdo vit rritet plani i të hyrave. Çështja tjetër, drejtor, është ngritja e një çështjeje shumë të rëndësishme lidhur me një faturë. Shpresoj që ajo të jetë e protokolluar dhe të jetë përcjellë edhe me raportin e menaxherit të kontratës dhe me kallëzim penal. Mua më intereson të di nëse ai email ka ardhur në Drejtorinë e Financave, ti je drejtor i ri dhe stafi duhet të të ketë njoftuar nëse ka pasur ndalesë apo nëse është kërkuar largimi i këtij urdhri nga urdhrat përmbarimorë. Urdhrat përmbarimorë i ekzekuton Thesari. Kush e ka urdhëruar Thesarin për ta ekzekutuar atë urdhër përmbarimor? Kjo është shumë e qartë nëse nuk është dikush nga Komuna e Mitrovicës, atëherë është dikush në Ministrinë e Financave me përgjegjësi sa i përket kësaj çështjeje. Sa i përket investimeve kapitale, Kryetar, në seancë ku e kemi diskutuar raportin financiar për tremujorin, ju nuk keni qenë prezent dhe këtë çështje e kam diskutuar me nënkryetarin. Sinqerisht, realizimi është i ulët, keni kontrata aktive dhe keni edhe memorandumin e bashkëpunimit me Shalën, keni mundësi t'i shfrytëzoni edhe projektet në Kollovërt, Bair, Tavnik e të tjera, pa i marrë të gjitha me radhë. Sinqerisht, realizimi në gjashtëmujorin e parë është shumë i ulët. Nëse e marrim krahasimisht me komunat e tjera, zakonisht realizimi në gjashtëmujorin e parë shkon rreth 30–40%. E dimë se ka vonesa në Zyrën e Prokurimit dhe se derisa të lidhen kontratat, ka vonesa edhe në

realizimin e planifikimeve. Por po dua që të jemi korrektë. Prandaj, të lutem, merre në konsideratë pjesën e projekteve dhe kontratave që i ke, kontratat e tjera që janë lidhur dhe pjesën tjetër që e ke të buxhetuar. E ke edhe librin e buxhetit, ku kryesisht shërbimet publike e kanë pjesën më të madhe të buxhetit. Të lutem, punoni në këtë drejtim, sepse tash është koha kur gjithë kjo makineri dhe kapacitet duhet të vihet në funksion në qytetin e Mitrovicës. Kryetar, e ke gjetur buxhetin e votuar, kryejini këto projekte. Edhe ne e kemi gjetur buxhetin e votuar. I kemi kryer projektet e pushtetit të kaluar dhe e kemi votuar buxhetin sipas programit tonë. I kemi kryer edhe projektet tona. Prandaj, kryeni projektet, sepse janë projekte të nevojshme për qytetarin, ato kanë ardhur edhe nga diskutimet publike, ashtu siç i keni marrë edhe ju përmes diskutimeve publike. Buxheti i krijuar për vitin 2026 ka ardhur kryesisht nga diskutimet publike dhe nga propozimet, përfshirë edhe ato të opozitës. Kështu që ju rekomandoj të fokusoheni te pjesa e investimeve kapitale.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Nuk po dua ta kontestoj vullnetin që e ke dhe inkurajimin për të bërë punë, edhe ne e kemi të njëjtin vullnet. Sa i përket nivelit të përqindjes së investimeve kapitale, unë mendoj se terreni i plotë zakonisht arrihet në gjashtëmujorin e dytë. Problemin kryesor, mendoj, e kemi te skena buxhetore, në proporcion me nevojat e shumta që janë në qytet. Por, deri në fund të vitit, unë mendoj se niveli i realizimit të investimeve, posaçërisht pas kontratave të fundit që kemi realizuar do të jetë i kënaqshëm. Se cili do të jetë niveli i saktë nuk mund ta them, por besoj se do të realizohet pjesa më e madhe e buxhetit. Arsyeja pse e mora fjalën është se ke bërë një pretendim i cili, për mua, paraqet shqetësim. Në rast se ti i thua ekzekutivit se i ka tabelat e paqena dhe fiktive, atëherë duhet të na tregosh dhe të na demonstronsh se si është tabela fiktive. Sepse një tabelë fiktive nënkupton një dokument që nuk ekziston. Të paraqesësh në komunikim zyrtar një dokument që nuk ekziston është një pretendim i rëndë. Bëhet fjalë për material që është komunikim zyrtar i një ekzekutivi para asamblesë dhe të thuash se ky material është fiktiv është një pretendim serioz. Unë nuk po them se kjo është e saktë apo jo. Do të bëj verifikimin përkatës. Unë jam i prirur t'i besoj administratës. Herë pas here kërkoj materiale ose informata shtesë, por pretendimi se një dokument është fiktiv është pretendim i rëndë.

Gëzim Stavileci : E thashë „fiktiv" në kuptimin e mënyrës së paraqitjes së raportit, realisht të inkasimit dhe krahasimit. Dëgjo vetëm deri në fund. Nëse e marrim një raport mirëfilli financiar, nuk bëhet krahasimi i një viti me tjetrin, për shkak se ekziston një planifikim i inkasimit i cili votohet në Kuvendin e Mitrovicës. Realisht, për këtë vit ne do ta votojmë planin e inkasimit për vitin 2027 dhe kjo na paraqet para përgjegjësisë. Nëse bëhet një raport dhe merret si bazë krahasimi me vitin paraprak, në thonjëza, është një raportim i padrejtë dhe jo i saktë, për shkak se është bërë krahasimi me vitin paraprak dhe nuk është marrë raporti i saktë i realizimit në raport me planin. Kryetar, a bën t'i kërkosh drejtorit raportin e saktë? Pra Raportin e saktë se si bëhet raporti. Merri raportet financiare të komunave të tjera dhe shihni se si bëhet raportimi. Raporti bëhet në bazë të planifikimit të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Z. Stavileci, me thënë të drejtën, tash edhe si anëtar i Kuvendit, u bëra kureshtar të di diçka. Nëse Drejtoria e Financave ka sjellë një raport që nuk korrespondon me gjendjen faktike, veçanërisht sa i përket realizimit të të hyrave, atëherë kjo do të ishte shqetësuese dhe do të nënkuptonte një tentim për ta mashtruar Kuvendin. Ndoshta problemi është te unë, që nuk po di ta kuptoj drejt Gëzimin. Megjithatë, dua të sqaroj se, nga përvoja ime si anëtar i Asamblesë, nënkryetar dhe kryesues, këto tabela nuk janë të panjohura, janë tabela standarde që Drejtoria e Financave i ka përdorur zakonisht. Tash, pyetja është: a jemi të kënaqur me realizimin e të hyrave për këtë gjashtëmujor? Kjo është çështje diskutimi. Ekzekutivi thotë se ka realizuar mbi 60% të të hyrave. Nëse gjatë këtij viti janë planifikuar 3,700,000 € të hyra dhe deri në qershor janë realizuar afër 60%, atëherë, për mendimin tim, kjo paraqet një trend të mirë realizimi. Gjithashtu, duhet ta krahasojmë këtë rezultat me vitet paraprake. Nëse e krahasojmë me vitin 2025, sipas tabelës së sjellë nga Drejtoria

e Financave, këtë vit kemi rreth 120,000 € më shumë të hyra. Është e vërtetë që planifikimi për këtë vit ka qenë më i madh, por besoj se ambicia e një pushteti duhet të rritet dhe të ecë përpara. Nëse e analizojmë trendin e të hyrave në dy gjashtëmujorë, shohim se realizimi në gjashtëmujorin e parë është afër 60% të planifikimit vjetor, që në parim është rezultat pozitiv. Mirëpo, ajo që më bën kureshtar është të vërtetoj nëse kjo listë dhe këto të dhëna janë të sakta. Nëse janë të sakta, atëherë mirë. Por nëse nuk janë, atëherë kemi një problem serioz për Drejtorinë e Financave. Unë po flas vetëm mbi bazën e statistikave dhe dokumenteve që na janë paraqitur dhe besoj se po i lexoj drejt të dhënat.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Në mënyrë shumë të shkurtër, dëshiroj të jap një sugjerim, nëse më lejohet. Do të ishte e arsyeshme që t'u jepet hapësirë ekzekutivit dhe drejtorëve të drejtorive për të dhënë përgjigje ndaj çështjeve të ngritura, duke qenë se disa prej asamblistëve kanë marrë fjalën disa herë, ndërkohë që ende nuk janë dhënë përgjigjet përkatëse nga drejtorët. Po ashtu, temat e ngritura nuk janë domosdoshmërisht në kompetencë vetëm të një drejtorie. Për këtë arsye, propozoj që të fillohet me drejtorin Muja, për pjesën që lidhet me investimet kapitale, veçanërisht duke marrë parasysh shqetësimet e ngritura lidhur me gjendjen në terren, përfshirë edhe Zhabarin. Z. Muja, ju lutem të jepni sqarimet përkatëse lidhur me nivelin e realizimit të investimeve kapitale, ndërsa më pas, sipas radhës, edhe drejtorët e tjerë të japin shpjegimet e nevojshme, deri te Drejtoria e Financave, e cila duhet të ofrojë të dhëna dhe sqarime sa më të detajuara dhe faktike. Më pas, Kryesues i Kuvendit, mund të vendos për vazhdimin e diskutimit.

Shkëlqim Ibrahimi: Të gjitha këto pyetje lidhur me investimet kapitale janë ngritur për shkak të formatit të raportit financiar për investimet kapitale. Është paraqitur vetëm një raport në të cilin janë evidentuar punimet që kanë filluar, por nuk është paraqitur raporti në formatin e mëparshëm, ku përfshihej planifikimi dhe mund të shihej progresi i realizimit të punimeve. Kjo është çështja që kam ngritur. Sa i përket përdorimit të fjalës "fiktive" në diskutimin me Gëzimin, pajtohem se është një shprehje jo e përshtatshme dhe e panevojshme. Për këtë arsye edhe e kam ngritur pyetjen. Titulli i tabelës është: "Krahasimi i inkasimit të të hyrave vetanake me planifikimin". A është ky titulli i tabelës?

Kryesuesi i Kuvendit: Po përpara e ke materialin.

Shkëlqimi Ibrahimi: Atëherë, nëse bëhet krahasimi i të hyrave vetanake të inkasuara me planifikimin, ku është paraqitur kolona e planifikimit?

Kryesuesi i Kuvendit: Është paraqitur më herët.

Shkëlqim Ibrahimi: Ku është? Do të dëshiroja ta gjenim atë kolonë dhe ta shihnim së bashku.

Kryesuesi i Kuvendit: Në fund të fundit, ne po diskutojmë për çështje profesionale. Unë nuk jam këtu për ta mbrojtur drejtorin, por dua të mbroj një çështje për të cilën konsideroj se kam njohuri. Prandaj, le ta identifikojmë kolonën përkatëse. A është fjala për planin për vitin 2026? A është planifikim. Krahasimi i inkasimit të të hyrave me planifikimin dhe përqindjen e realizimit mund të nxirret matematikisht.

Shkëlqim Ibrahimi: Ne jemi inxhinierë, domethënë po, por kjo duhet të jetë e paraqitur në raport.

Kryesuesi i Kuvendit: Mund ta nxjerrim vetë përqindjen nëse ju intereson.

Shkëlqimi Ibrahimi: Neve na intereson që kjo të jetë e paraqitur në raportin që na është dorëzuar, jo që ta llogarisim tani veçmas të figuron 105%. Kjo është çështja.

Naser Muja: Desha të sqarohem pak rreth investimeve kapitale, që në drejtorinë tonë po figuron 15%, ose totali 13%. Do të thotë, pajtohemi me ato se nuk janë të përfshira të gjitha punimet që janë realizuar, që kanë përfunduar, por janë vetëm disa punime që janë në proces.

Sa i përket drejtorisë që unë udhëheq, të gjitha investimet kapitale janë në rrugën e duhur, do të thotë, të gjitha kanë përfunduar, disa janë lidhur kontratat, disa të tjera janë në proces. Te procesi i

ankesave të tenderëve, ne nuk mund të ndërhyjmë aty, siç ka qenë çdo herë, por me përfundimin e vitit kalendarik, drejtoria që unë e udhëheq besoj që do të jetë e realizueshme mbi 90%. Kështu, me bindje të plotë e them se të gjitha janë procedura të cilat nuk mund të zgjasin më tepër se edhe muaji që vjen dhe do lidhen kontratat, punimet që keni parë janë vazhduar në Shufëc ose në tre fshatra. Katër janë duke u vazhduar në Zhabar, te asambleistja. Pjesën e ka Liqeni, Shipoli ka filluar, Bajrin e kemi në pritje javën që vjen. Kështu që, të gjitha kontratat që janë në pritje janë kontrata trevjeçare. Ne nuk mund t'i shtojmë më tepër se sa është planifikuar në vitin paraprak. Por besojmë që do të realizohen të gjitha sipas planit dinamik që është. Nëse keni pyetje diçka konkrete, më lirshëm mundeni me pyet.

Shkëlqim Ibrahimi: Te totali i përgjithshëm, 52%. Çka nënkupton kjo 52% tek shpalosja e investimeve kapitale?

Gazmend Gjoshaj: Z. Ibrahimi këtu është fjala për këto projekte që janë në proces e sipër. 52% e totalit të tyre janë realizuar, për këtë janë listuar këto. Ne i kemi paraqitur vetëm këto që janë në realizim e sipër.

Shefki Begu: Vonesa e Ligjit të buxhetit na ka pamundësuar ta bëjmë zotimin e plotë të mjeteve dhe nuk ka qenë e mundur të urdhërohej kompania t'i përfundonte punimet. Domethënë, me kërkesën e kompanisë dhe aprovimin e menaxherit të kontratës, afati i përfundimit të punimeve të çerdhes është vazhduar deri më 18.08.2026. Domethënë, kemi kohë. Kompania ka kërkuar vazhdimin dhe ne ia kemi vazhduar.

Gazmend Gjoshaj: Sa i përket tabelës numër katër, "Krahasimi i të hyrave vetanake të planifikuara në krahasim me vitin e kaluar sipas drejtorive", ne i kemi cekur edhe vitet 2025 dhe 2026 për secilën drejtori veç e veç. Këtu nuk ka asnjë informacion fiktiv, asnjë të pavërtetë. Për çdo gjë mundem t'ju bind, se ne, më së pari, nuk kemi mundur të sjellim diçka që nuk është reale, sepse përgjegjësia është edhe penale për këto. Planifikimi, për shembull, për Drejtorinë e Administratës ka qenë për vitin 2026, 95,000 €, ndërsa është realizuar 49,693 €. Për shembull, Drejtoria e Financave i ka përmbushur 81% të planifikimit buxhetor. Ndërsa kjo që po pyet Shkëlqimi, 105%, është krahasimi mes vitit të kaluar dhe vitit të tashëm dhe tregon se është në rritje 5.45% në krahasim me vitin e kaluar.

Shkëlqim Ibrahimi: Do të thotë, e cek që i mungon një kolonë.

Gazmend Gjoshaj: Nuk e thashë unë që i mungon një kolonë, Jo, nuk është gabim. As titulli, as këtu. I ke vitin 2024, 2025 edhe 2026, edhe realizimin. Nuk është gabim. Këtu duhet të veçohet. Te Drejtoria e Financave kemi pasur të hyra vetanake 54% më tepër në krahasim me vitin e kaluar. Sa i përket urdhrit përmbarimor ekzekutimin e ka bërë Thesari. Në atë kohë nuk na kanë pyetur prej kujt t'i marrin; vetëm i kanë ekzekutuar. Për këtë arsye, Thesari është përgjegjës në qoftë se kanë bërë ndonjë shkelje ligjore.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Tabela 1.2 mban titullin: "Krahasimi i inkasimit të të hyrave vetanake me planifikimin dhe vitin paraprak sipas drejtorive". Në këtë aspekt, nuk ka ndonjë gabim. Krahasimi është bërë ndërmjet trendit të realizimit të të hyrave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 dhe vitit 2025, si dhe në raport me planifikimin. Sa i përket planifikimit, ju po theksoni se do të ishte më mirë që në tabelë të paraqiten edhe të dhëna të tjera shtesë. Në rregull, a ka hapësirë për përmirësim? Sigurisht që po. Prandaj, në këtë pikë mund të pajtohemi të gjithë se raporti mund të jetë edhe më i detajuar dhe më i qartë. Kjo vlen edhe në përgjithësi. Kur paraqesim ose mbështesim kategori të caktuara, mund të themi se janë të mira, por gjithmonë ekziston mundësia që ato të jenë edhe më të mira. Pra, përmirësimi është një proces i vazhdueshëm dhe nuk ka një pikë përfundimtare. Në këtë kuptim, pajtohem që raporti mund të përmirësohet edhe më tej.

Liridona Muharremi: Po, drejtor, faleminderit për përgjigjen e përgjithshme, ama pyetja ime ka qenë specifike: cilat rrugë janë të planifikuara në këtë buxhet? Për të mos marrë më shumë kohë, se po ju duhet të shkoni te foltorja, mund t'i pranoj përgjigjet edhe me email, kurdo që është e arsyeshme.

Gëzim Stavileci: Kryetar, vetëm një sqarim lidhur me tabelën e inkasimit. Kam një pyetje: pse raporti tremujor i shpenzimeve dhe inkasimit, i cili na është dorëzuar para katër seancave, ka qenë i paraqitur edhe me planifikim, ndërsa në raportin aktual kjo nuk është e përfshirë në të njëjtën formë? Drejtor, a ka mundësi që ta sillni raportin e plotë dhe të saktë, duke përfshirë edhe planifikimin dhe përqindjen e rritjes së të hyrave? Ju, si ekonomist, e dini rëndësinë e këtyre të dhënave dhe mund t'i kërkoni stafit që të paraqesë edhe përqindjen përkatëse, në mënyrë që edhe ne të jemi të informuar qartë se sa janë rritur të hyrat. Në tremujorin e parë është raportuar një rritje prej 13%, ndërsa tani na intereson të dimë se sa është përqindja e rritjes në gjashtëmujorin e parë. Gjithashtu, kryetar, dua të rikthehem edhe te një çështje që të kam mbetur borxh, pasi nuk kam qenë i pranishëm në seancën e kaluar. Ju atëherë kishit deklaruar: "Do ekonomista të dobët i ka lënë Bedri Hamza". Kryetar, me të drejtë mund të them se Bedri Hamza ka lënë pas vetes një numër të konsiderueshëm ekonomistësh të përgatitur. Ju e njihni mirë kontributin e tij dhe e dini se sa e keni respektuar atë. Pa dashur ta zgjeroj diskutimin për kontributin e Bedri Hamzës në fushën financiare, mendoj se ai është i njohur dhe i vlerësuar. Në veçanti, kontributi i tij në fushën e financave publike është i evidentuar dhe ka lënë gjurmë të rëndësishme.

Shkëlqim Ibrahimi: Unë vetëm desha të kërkoj një falje. Tash e verifiëa dhe mora një informatë te çështja që iu drejtova znj. Barani, që nuk ka të bëjë operatori me çështjen e AMF-së në Kosovë. Mirëpo, qenka te shkolla e Gushavcit. Domethënë, në atë rast operatori u shpall i papërgjegjshëm, pasi nuk i ka kryer punimet, dhe iu është ekzekutuar pagesa. Kështu që vetëm i kërkoj falje znj. Barani që ia kam drejtuar pyetjen padrejtësisht.

Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim Raportin financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën janar–qershor 2026. Në sallë janë të pranishëm 22 anëtarë.

Rezultati i votimit:18 për-0 kundër – 0 abstenim

Kryesuesi i Kuvendit konstaton se aprovohet Raporti financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën janar–qershor 2026.

**Pika e 18**

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket raportit gjashtëmujor të punës së Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane, në Komitetin për Politikë dhe Financa kemi qenë shumë praktikë në trajtimin e kësaj çështjeje. E hapim diskutimin.

Fisnik Suma: Në raport përmendet se është realizuar programi i praktikës me pagesë për 100 të rinj. A mundesh, drejtor, të lutem, të na tregosh cilat kanë qenë kriteret e përzgjedhjes, sa aplikime janë pranuar dhe si është bërë vlerësimi? Gjithashtu, a është publikuar lista e përfituesve për të siguruar garancinë e transparencës mes këtyre kandidatëve?

Gani Rrustemi: Unë e desha raportin gjashtëmujor, sepse ka disa të dhëna të mira këtu që është mirë t'i dëgjojmë, për të parë, si drejtori, çfarë kemi paraparë dhe çfarë kemi realizuar. Nëse kalojmë vetëm te ato pika, mund t'ju tregoj, por thashë, nëse keni mundësi të më duroni edhe rreth 10 minuta, të shohim këtë drejtori të re, të cilën ju e keni formuar para dy-tri vjetësh dhe ne e kemi vazhduar punën. Më e rëndësishme është ajo që po punojmë dhe ajo që do të punojmë në të ardhmen. Nëse ndalemi vetëm te ato 100 [përfitues], të cilët janë kryesisht nxënës dhe studentë, kjo ka qenë një projekt në konsultim me kryetarin dhe me të gjithë. Kanë aplikuar 560 persona. Tash, të mos flasim vetëm me shifra në këtë mënyrë. Komisioni u formua dhe nuk ka qenë vetëm partiak, por ka përfshirë të gjithë ata që kanë punuar në këtë drejtim. Ata i kanë përzgjedhur 100 nxënësit dhe studentët, të cilët për tre muaj marrin nga 300 €, që do të thotë se marrin gjithsej 900 € për tre muaj. Këto mjete

janë siguruar në participim me ministrinë. Kush ka përfituar, është në listë. A ka pasur ndonjë shkelje? Nuk ma merr mendja. Tash, unë emrat nuk i di. Ka qenë edhe një [përfaqësues] boshnjak, nëse e kam kuptuar mirë, i cili ka pasur qasje në të gjitha dokumentet. Raporti nuk ka shkuar keq, por shpresoj që gjithçka është në rregull. Mandej, edhe një gazetar tjetër, nuk po më kujtohet emri, ka vlerësuar se dokumentacioni ka qenë në rregull, performanca ka qenë e mirë dhe edhe përzgjedhja është bërë mirë. A ka ndonjë gabim? Nuk di.

Shkëlqim Ibrahimi: Po, veç desha një sqarim, për të hyrë pak në këtë çështje. Po, më erdhi mirë që the për transparencën. Domethënë, komisioni ka qenë gjithë partiak. Më fal, kush ka qenë i PDK-së aty?

Gani Rrustemi: Si PDK? Ka qenë gruaja e shefit të personelit znj. Musa?

Kryesuesi i Kuvendit A ka dikush diçka tjetër? Atëherë e konsideroj si çështje të mbyllur diskutimin rreth këtij raporti.

**Pika e 19**

Kryesuesi i Kuvendit: Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim atëherë e hedh në votim Plotësim dhe ndryshimi i vendimit 02060/01-0035074-5/2026, për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të organizatës buxhetore. Me rekomandimet të cilat i ka dhënë Ministria.

**Rezultati i votimit: (të pranishëm 25) 25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

**25 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.**

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se u miratua unanimisht Plotësim dhe ndryshimi i vendimit 02-060/01-0035074-5/ 2026, Për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të organizatës buxhetore.

**Pika e 20**

**Pyetje dhe përgjigje**

Valon Brahimi: Për Drejtorinë përkatëse (DSHPI)

1. Lidhur me çështjen e Rrethit të Madh: aty ndodhen disa lokale dhe trotuari është mjaft i gjerë, mirëpo lokalet që janë buzë rrugës po përballen me vështirësi gjatë ngarkim-shkarkimit të mallrave. Si shqetësim më është përcjellë nga bizneset, a ka mundësi që kunjat të zhvendosen pak më brenda, në mënyrë që të krijohet hapësirë për ndalesa të përkohshme të automjeteve gjatë furnizimit të bizneseve? Gjithashtu, a ka mundësi që kjo çështje të shqyrtohet në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, në mënyrë që në një orar të caktuar të lejohet ndalimi i automjeteve për tre deri në pesë minuta, vetëm për furnizimin e bizneseve? Aktualisht, në momentin që ndalet ndonjë automjet për këtë qëllim, Policia menjëherë e gjobit drejtuesin, ndërsa bizneset thirren në faktin se kjo ka qenë kërkesë e Drejtorisë. A ka mundësi që kjo çështje të rregullohet me mirëkuptim dhe në bashkëpunim me bizneset, në mënyrë që t'u mundësohet furnizimi pa penguar qarkullimin?

2. Kur parashihet të fillojnë punimet në rrugën e Malit? Ju na e keni dhënë fjalën këtu se do të ndërhyhet në këtë rrugë. Kur është bërë bartja e të hyrave, ne e kemi votuar me idenë që në kuadër të atyre mjeteve të përfshihet edhe kjo rrugë. E di që ka qenë fjala për riparimin e rrugëve dhe jo për ndërtimin e plotë të saj, por kjo rrugë ka një nevojë të madhe për ndërhyrje. Prandaj, nuk po e ngre këtë çështje si akuzë, por thjesht po pyes: kur mund të realizohet kjo ndërhyrje dhe kur mund ta kemi një përgjigje konkrete lidhur me fillimin e punimeve?

Për Drejtorinë përkatëse (DA)

Kam parë në faqen e prokurimit se janë iniciuar procedurat për ndërtimin e çerdheve në Vaganicë dhe në Kqiç. Pyetja ime është: ku është caktuar lokacioni për çerdhen në Kqiç? pasi për Vaganicën është përcaktuar lokacioni Kur pritet të filloj dhe kur të përfundojë?

Për Drejtorinë përkatëse (DBZHR)

A ka ndonjë projekt që është duke u planifikuar nga Drejtoria e Bujqësisë? Gjithashtu, a ka filluar ndonjë projekt për subvencionimin e bujqësisë dhe në cilën fazë është aktualisht? Si parashihet të zhvillohet kjo procedurë? Po e shoh që procedura e prokurimit ende nuk ka filluar, ndërsa vitin e kaluar kjo është realizuar përmes procedurës së prokurimit. Prandaj, pyetja ime është: nëse procedura nuk ka filluar ende, cili është shkaku dhe kur pritet të fillojë?

Dhe çështja e tretë, kryetar, e ndiej obligim ta sqaroj, sepse këtu u dha një mesazh. Meqë kam qenë pjesë e procesit, kjo është pak jashtë pyetjes, por e ndiej si obligim moral, pasi kam qenë pjesë e procesit bashkë me Inspeksionin, lidhur me rastin e lokaleve që kanë qenë në shfrytëzim. Ti iu referove asaj si prostitucion. Ne nuk e dimë nëse ka pasur prostitucion apo jo. Mirëpo, kur kemi shkuar në atë lokal si Drejtori e Inspeksionit, kemi asistuar ndërmarrjen publike në fjalë. Aty ka qenë një lokal për të cilin është supozuar se zhvillohej veprimtari muzikore gjatë natës. Ne nuk kemi pasur informacion të konfirmuar për këtë, por situatën e kemi gjetur ashtu. Në kohën kur ka ardhur menaxhmenti, i cili atëherë drejtohej nga kryeshefi Esat Jusufi, me asistimin e Inspeksionit dhe të Policisë së Kosovës, veprimtaria e atij lokali është ndërprerë. Pra, në atë pikë ka përfunduar çështja. A ka pasur prostitucion apo jo, unë nuk mund të them, sepse nuk kam informacion të tillë. Ajo që mund të them është se kjo veprimtari ka ekzistuar para ardhjes së pushtetit të Bedri Hamzës dhe është ndërprerë në atë kohë. Për këtë arsye, e ndjeva si obligim moral ta bëj këtë sqarim, meqë këtu u përcoll një mesazh te qytetarët. Është mirë që nga ky moment e tutje, të jetë e qartë se çfarë ka ndodhur realisht në atë rast.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Unë e ngrita si çështje dhe tërhoqa një paralele se sa është e rëndësishme të ngrihen tema për çështje konkrete që janë në preokupim të qytetarëve dhe që kanë të bëjnë me menaxhimin më të mirë të ndërmarrjeve komunale. Do të thotë, disa borde të përkohshme, të cilat kanë mandat maksimal gjashtëmujor, nuk janë problemi kryesor sa i përket mundësisë ose mënyrës se si menaxhohet një ndërmarrje komunale. Unë kam pritur në takim disa anëtarë të bordit dhe ata ma kanë pasqyruar situatën si të tillë. As të kësaj periudhe, as të asaj periudhe. As nuk e di kur e ka filluar atë veprimtari, as kur e ka ndalur atë veprimtari. Unë vetëm e tërhoqa këtë çështje, sepse për mua ka qenë shumë tragjikomike mënyra se si u prezantua aty. Mes të tjerash, në mesin e obligimeve financiare ishin edhe fatura prej 28.000 €. Thashë: Çfarë ka bërë ai, domethënë, çfarë veprimtarie është ushtruar? Thanë se është ushtruar prostitucion dhe, disi, e kaluan me lehtësi atë çështje. Thashë se unë vetëm e shkëputa një fragment për të treguar se sa është e rëndësishme të ngrihen temat përmbajtjesore. Jo kush çka është dhe cilës parti i përket. Aty ka njerëz që, në rrethana dhe në një kohë të caktuar, kanë pasur edhe mandat politik. Dikush është larguar prej politikës. Ka njerëz nga të gjitha partitë politike. Kur i kam parë ata emra, janë prej shumicës. Nuk e di nëse ka ndonjë prej PDK-së, për hir të korrektësisë. S’e di, thashë, nuk jam i sigurt. Do të thotë, ka edhe të tillë që unë as nuk i njoh. Unë vetëm desha t’jua jap këtë shpjegim: nuk bëra një akuzë konkrete, as nuk përmenda ndonjë interval kohor, as emër, as ndonjë qeverisje. Thashë: Hajde ta përmirësojmë gjendjen dhe ta parandalojmë mundësinë që të mos diskutojmë për këto çështje, që të mos vijë një kryetar i komunës, nesër një tjetër, jo unë, dhe të përballet me një lloj banaliteti apo kriminaliteti. Sepse, në rast se një bord i përkohshëm vjen dhe të raporton: „Kjo është gjendja, këto janë problemet dhe, mes të tjerash, është ushtruar edhe kjo veprimtari“, unë vetëm e shtrova si paralele se ka tema të ndjeshme që janë edhe përtej aspektit financiar, dobisë ekonomike dhe çështjeve të tjera, të cilat duhet të ngrihen si tema. Pra, kështu besoj se jemi të qartë në lidhje me gjithë këtë situatë.

Shkëlqim Ibrahimi: Pajtohem pikë për pikë që të mos vijmë te ajo gjendje, sepse për këtë ekzistojnë filtrat e përcaktuar me ligjet në fuqi. Për këtë, Ligji për Ndërmarrjet Publike përcakton saktë se duhet të ketë një kualifikim të caktuar, të ketë një të kaluar kriminale të pastër dhe të dëshmuar, si dhe të ketë përvojë menaxheriale. Jo „të pastër“ në kuptimin e përgjithshëm, por e ceka

saktë: të jetë e pastër sa i përket të kaluarës kriminale. Tash, nëse ka borde, domethënë, bordi i përcakton këto kritere. Nëse dikush nuk i plotëson këto filtra, atëherë nuk ka kaluar nëpër to. Plus, për të krijuar procedura të këqija, jemi të bindur që as ti nuk ke qejf që të ndodhë një gjë e tillë. Kjo nuk ka ndodhur në historikun e ndërmarrjes. Për herë të parë kam parë që në Stacionin e Autobusëve të shkojë dikush si UD i jashtëm. Kurrë në jetë nuk kam parë diçka të tillë. Jo, por pajtohemi. A po pajtohemi që kemi për t'i sjellë raportet? Kështu që, kryetar, edhe për këtë çështje, ato dokumente dhe ato komente, kur t'i kam sjellë, është dashur pak të filtrohen.

Xhyljeta Imeri: Kërkoj raport nga Komisionet e Aksionarëve për tri ndërmarrjet publike, lidhur me bazën ligjore mbi të cilën janë emëruar bordet e përkohshme të këtyre ndërmarrjeve**.** Gjithashtu, kërkoj që raporti të përmbajë arsyetimin dhe bazën ligjore për emërimin e këtyre bordeve.

Flamur Vojvoda: Për Drejtorinë përkatëse (DSHPI)

Duke qenë se ka ankesa të shumta dhe të vazhdueshme për shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve në disa rrugë të qytetit, a ka mundësi të bëhet një vlerësim i rrugëve ku qytetarët janë të rrezikuar nga shpejtësia e automjeteve dhe, nëse është e mundur, të vendosen pengesa për ngadalësimin e trafikut? Dy nga rrugët që i kam evidentuar janë rruga „Bashkimi Kombëtar“, e cila lidhet me udhëkryqin te ambulanca dhe vazhdon në anën e majtë drejt liqenit, si dhe rruga „Agim Ramadani“. Përveç kësaj, ka edhe shqetësime lidhur me prishjen e rendit dhe qetësisë në orët e vona në disa prej rrugëve. Mendoj se kjo çështje i takon Këshillit Komunal për Siguri, në bashkëpunim me Stacionin Policor të qytetit, për të shqyrtuar mundësinë e intensifikimit dhe shtimit të patrullave. Mendoj se këto masa janë të domosdoshme, pasi po rrezikohen qytetarët, sidomos fëmijët dhe të moshuarit, duke pasur parasysh se këto rrugë lidhen edhe me shëtitoren e qytetit dhe zonën e liqenit. Këto janë ankesa të vazhdueshme të qytetarëve dhe nuk janë shqetësime të ditëve të fundit. Pengesat kanë qenë të vendosura edhe më herët, por më pas janë larguar. Prandaj, a ka mundësi që, në bazë të këtyre ankesave, të bëhet një vlerësim dhe të ndërmerren masat e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur? Nëse është e nevojshme, mund t'i evidentojmë ankesat e qytetarëve dhe ta paraqesim edhe një kërkesë me shkrim.

Visar Syla: Për Drejtorinë përkatëse (DSHPI)

Kam një pyetje për drejtorin e Infrastrukturës lidhur me rrugën „Tefik Zasella“ në Shupëc.

A është kjo rrugë në agjendën e Drejtorisë? Nëse po, kur parashihet të trajtohet dhe të fillojnë punimet? Nëse nuk është në agjendë, a mund të përfshihet në planifikimet e Drejtorisë?

Gjithashtu, nëse bëhet një vlerësim i gjendjes së rrugës, a ka nevojë vetëm për asfaltim, apo ka nevojë edhe për kanalizim fekal, kanalizim atmosferik dhe ndriçim publik?

Për Drejtorinë përkatëse (DPU)

A ka mundësi të na jepni informacione lidhur me lejet e ndërtimit për periudhën 2021–2025?

Konkretisht, a ka pasur raste të tejkalimit të kushteve ose parametrave të përcaktuar me lejet ndërtimore dhe sa ka qenë koeficienti maksimal i lejuar para hyrjes në fuqi të Hartës Zonale?

Armend Begu: Për Drejtorinë përkatëse (DSHPI)

Në lagjen Bajr, në rrugën e UÇK-së, përballë Belvederit, ndodhet një rrugicë në një lagje të re, e cila nuk figuron me emër në Google Maps. Besoj se drejtori z. Muja është në dijeni për këtë rrugë. Banorët e asaj zone kanë paraqitur kërkesë, pasi gjatë reshjeve dhe në kushte të lagështa rruga bëhet shumë me baltë. Prandaj, kërkoj që të shqyrtohet mundësia për ndërhyrje dhe rregullimin e kësaj rruge, në mënyrë që banorëve t'u lehtësohet qarkullimi.

Për Drejtorinë përkatëse (DI)

Kërkoj që Drejtoria e Inspeksionit të angazhohet për lirimin e trotuareve, për shkak të fluksit të madh të qytetarëve dhe automjeteve gjatë këtyre ditëve. Në veçanti, te rruga „Agim Ramadani“, në degëzimin me rrugën „Evlia Çelebia“, po parkohen disa automjete, duke penguar qarkullimin dhe

shfrytëzimin normal të rrugës dhe trotuarit. Prandaj, në bashkëpunim me Policinë, kërkoj të shqyrtohet mundësia që të parandalohet parkimi i automjeteve në atë pjesë, në mënyrë që rruga të jetë më e lirë dhe të shmangen pengesat në trafik dhe rrezikimi i këmbësorëve.

Egzon Sadiku: Për Drejtoritë përkatëse (DSHPI) dhe (DBZHR)

Kam një kërkesë të një bujku nga Zhabari, i cili e ka punuar tokën prapa varrezave të Zhabarit. Aty ka ndodhur një problem, ku ka shpërthyer një kanalizim, pra a ka mundësi të ndërhyhet në atë pjesë për sanimin e problemit dhe, nëse po, kur parashihet të bëhet ndërhyrja?

Drejtoreshë, nëse në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë ekziston një komision vlerësues, a ka mundësi të bëhet vlerësimi i dëmit të shkaktuar në tokën e bujkut? Gjithashtu, si parashihet të zhvillohet procedura e vlerësimit nga ky komision, nëse një komision i tillë ekziston? Nuk kam informata të sakta nëse në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë ekziston një komision i tillë vlerësues.

Gëzim Stavilveci: Për Drejtorinë përkatëse (DSHPI)

A ka mundësi të vendosen antiparkat në rrugën „Agim Ramadani“, për shkak se qytetarët nuk po mund ta shfrytëzojnë trotuarin nga parkimi i automjeteve dhe fluksi i madh?

Nuk është vetëm për shkak të mërgatës, por vazhdimisht qytetarët i parkojnë veturat në atë pjesë. Aty, në një pjesë të rrugës, tashmë janë vendosur antiparka. Me zgjerimin e rrugës është krijuar mundësia që trotuari të shfrytëzohet nga këmbësorët, pasi më parë nuk ka pasur trotuar. Prandaj, të lutem të shqyrtohet mundësia e vendosjes së antiparkave në atë pjesë, sepse parkimi i automjeteve në trotuar paraqet rrezik të konsiderueshëm, veçanërisht për fëmijët dhe banorët e asaj zone.

Elfate Ademi Bahtiri: Kërkesë për DA

Kërkesa ime ka të bëjë me shkollën, përkatësisht me oborrin e shkollës “Harum Beka” nw Goshavc, që të bëhet rregullimi i tij, si dhe me sallën e sporteve prapa shkollës, e cila ka mbetur përgjysmë. Kërkoj që të ndërmerren masat e nevojshme për përfundimin e punimeve të kësaj salle.

Sazan Ramaxhiku: Kërkesë për DSHPI

E kam një kërkesë nga qytetarët, e cila ka të bëjë me pjesën e rrugës së UÇK-së, nga Meridian-i në Bair, përkatësisht prej Xhamisë së Bairit deri te Fabrika e Duhanit. Në këtë pjesë të rrugës është tejkaluar në masë të madhe shpejtësia e lëvizjes së automjeteve. Për këtë arsye, i drejtohem drejtorisë përkatëse me kërkesën që të shqyrtohet mundësia e vendosjes së pengesave për ngadalësimin e shpejtësisë, duke pasur parasysh se nga shtëpitë ka dalje të drejtpërdrejtë në rrugën kryesore. Kjo paraqet rrezik të madh për banorët dhe pjesëmarrësit në komunikacion. Është një kërkesë e kahershme që na vjen vazhdimisht nga banorët e asaj pjese.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë, obligohet Ekzekutivi që për të gjitha pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit, përgjigjet me shkrim t’ia përcjellë Sekretarisë, e cila më pas do t’ua përcjellë ato anëtarëve të Kuvendit.

*Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet e mbledhjes së 10-të të rregullt të Kuvendit të Komunës në ora 12:20 min.*

| | | |
|---|---|---|
| **Mitrovicë** | **Procesmbajtës:** | **Kryesuesi i Kuvendit** |
| **29.07.2026** | ________________ | ________________ |
| | **Afërdita MAXHUNI** | **Safet KAMBERI** |

8

# Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

## Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 11-09-2026 |
| **REFERENCË:** | 02-110/04-0054618/26 |
| **PËR/ZA/TO:** | **z. Safet KAMBERI - Kryesues i Kuvendit të Komunës** |
| **CC:** | **- Anëtarëve të Kuvendit të Komunës**<br>**- Komitetit për Politik dhe Financa**<br>**- znj. Sofije Rushiti Peci, Zyra për Komunikim me Publikun**<br>**- znj. Afërdita Maxhuni, Zyrtare Përgjegjëse për Koordinimin e Procesit të Konsultimit Publik** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **z. Faton PECI, Kryetar i Komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Ma.sc. Lulzim HAJRA – Kryesues i Komisionit për Hartim të Draftit Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Raport nga Konsultimi Publik për Draft - Rregulloren për Plotësim Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve** |

### Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, Komisioni ka shpall Diskutimin Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, për datën 08.09.2026, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora 10:00 h.

### Ecuria e procesit

Komisioni në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, ka publikuar Njoftimin për Konsultim Publik të Draft – Rregullores për Plotësim Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbajtjes së takimit, dhe atë, në

linkun e Komunës së Mitrovicës së Jugut, platformën për Konsultime Publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në rrjetet sociale të Komunës.

Njoftimi për Konsultim Publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, duke u interesuar që të sigurohet Njoftim i Plotë dhe i duhur për palët e interesuara. Me Njoftimin për Konsultim Publik palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së Takimit/Diskutimit Publik. Njoftimit i është bashkangjitur Draft – Rregullorja për Plotësim Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, që ka qenë objekt i konsultimit publik, shpjegime shtesë, si dhe informatat për personat përgjegjës për pranimin e komenteve.

| Metodat e Konsultimit | Kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve |
|---|---|---|
| 1. Konsultimet me shkrim dhe në mënyrë elektronike | 15 ditë | 1 |
| 2. Publikimi në ueb faqet dhe rrjete sociale të Komunës | 15 ditë para mbajtjes së takimit/ diskutimit publik | 13 |

Në Takim/Diskutim Publik për Draft – Rregulloren për Plotësim Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, kanë marrë pjesë: Komisioni Punues i Draft – Rregullores, Njësia për Komunikim me Publikun, Pjesëmarrës nga Shoqëria Civile, Qytetar, Student, Praktikant dhe disa nga zyrtarët e Komunës.

Vlen të theksohet se Komisioni ka pranuar një e-Mail, gjatë periudhës së Konsultimit Publik brenda afatit kohor të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, i cili e-mail është trajtuar nga komisioni, por që shprehja e përkrahjes me anë të e-malit për iniciativën e Komunës për Organizimin e Konkursit për kopshtin, ballkonin dhe sipërfaqet më të mirë të rregulluara, kjo çështje nuk është paraparë as në Rregulloren bazë e as në këtë Plotësim Ndryshim, e po ashtu nuk është propozuar nga Njësit kompetente gjatë Konsultimit të Brendshëm, megjithatë sipas informacioneve që kemi Komuna ka shpall një konkurs të tillë. Duke u bazuar në këtë gjendje faktike kjo çështje tani në këtë fazë nuk mund të shqyrtohet me qëllim të inkorporomit, por në të ardhmen mbesim me shpresë që këto mund të trajtohet nga ana e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**SHTOJCË:**

*Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik;*

*E-maili i qytetarit.*

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

# RREGULLORE NR. __ /2026 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.08/2023 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE DHE GRANTEVE

**Shtator, Mitrovicë**

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. ____________________, dt. ______________**
**Mitrovicë**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 28 / 04 Qershor 2008"), nenin 53 të Ligjit Nr. 03/L - 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: VITI III / Nr. 27 / 03 Qershor 2008), dhe Ligjet për Plotësim Ndryshimin e tij, nenin 36, të Rregullit Financiarë 01/2013 – MF – Shpenzimi i Parave Publike, dhe nenin 13, paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut në mbledhjen e mbajtur më ___.___.2026, miraton këtë:

## RREGULLORE NR. __ /2026 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.08/2023 PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE DHE GRANTEVE

### Neni 1

Kjo rregullore ka për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Nr. 02-060/01-0039654-3/23, dt. 31.05.2023.

### Neni 2

Neni 2, paragrafi 1.4, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

1.4. **Grant** – konsiderohet ndihma e dhënë nga Komuna, në formën e transferimit të mjeteve financiare për realizimin e projektit tek personi fizik apo juridik, e cila kushtëzohet me qëllim të plotësimit në të ardhmen të kushteve të përcaktuara në Kontratë dhe si kusht që këto mjete t'i përdorin për veprimtaritë që është përzgjedhur.

### Neni 3

Neni 4, paragrafi 2, fshihet në tersi.

### Neni 4

Neni 13, paragrafi 1.1, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

1.1. nuk është paraqitur ankesa sipas nenit 12, paragrafi 1.

**Neni 5**

1. Neni 18, paragrafi 1, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

1. Kryetari i Komunës me kërkesë të Udhëheqësit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, emëron Komisionin i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik që janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe financiare e të cilët janë nga radhët e komuniteteve pakicë apo persona të riatdhesuar, të cilët aplikojnë për subvencionim në kuadër të kësaj zyre.

2. Neni 18, paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

2. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ndanë ndihmë financiare – subvencione dhe transfere nga buxheti i saj, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për këto raste:
2.1. Personat nga radhët e komuniteteve pakicë me gjendje të rëndë ekonomike dhe financiare, me qëllim të blerjes së gjërave elementare ushqimore dhe higjienike;
2.2. Personat e riatdhesuar të cilët nuk janë të përfshirë në skemat e ndihmës nga Ministria, si dhe personat të cilëve u ka përfunduar periudha e përfitimit nga skemat e ndihmës së Ministrisë dhe të cilët ndodhën në gjendje të rëndë ekonomike dhe financiare.

3. Neni 18, paragrafi 3, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

3. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim bënë ndarjen e subvencioneve dhe transferove duke përfshirë por pa u kufizuar në dokumentacionin si në vijim:
3.1. Kërkesa e palës;
3.2. Dokumenti valid identifikues i Republikës së Kosovës;
3.3. Dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe familjare;
3.4. Dokumentin që dëshmon se është person i riatdhesuar;
3.5. Konfirmimi bankar me numër të xhirollogarisë në emër të përfituesit apo familjarit të tij;
3.6. Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare.

4. Neni 18, pas paragrafit 3, shtohet edhe një paragraf i ri duke u renditur me numër 4, dhe atë, si në vijim:

4. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, do të refuzohen nga Udhëheqësi i Zyrës Komunale për Komunitet dhe Kthim, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

**Neni 6**

Neni 19, pas paragrafit 2.9, shtohet edhe një paragraf i ri duke u renditur me numër 2.10, dhe atë, si në vijim:

2.10. Nxënësit e zonave të thella malore, transporti me rastin e shuarjes së veprimtarisë së shkollave.

**Neni 7**

Pas Nenit 23, shtohet edhe një nen i ri duke u renditur me numër 23A, dhe atë, si në vijim:

**Neni 23A**
**Kriteret, kushtet dhe dokumentet për përfitim të subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit e zonave të thella malore me rastin e shuarjes së veprimtarisë së Shkollave Fillore (ShF) dhe Shkollave të Mesme të Ulëta (ShMU) të arsimit të obliguar**

1. Kriteret, kushtet dhe dokumentet që duhet të kompletohen për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit e zonave të thella malore me rastin e shuarjes së veprimtarisë së shkollave, përfshijnë por pa u kufizuar:

1.1. Kërkesa e palës;
1.2.Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
1.3.Certifikata e lindjes së fëmijës;
1.4.Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;
1.5.Dëshmia e gjendjes civile që konfirmon vendbanimin;
1.6.Vërtetimi i shkollës së re në të cilën e vijon mësimin;
1.7.Raporti i shkollës së re për vijueshmërinë;
1.8.Konfirmimi i bankës me numrin e xhirollogarisë bankare në emër të përfituesit apo familjarit të tij;

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

**Neni 8**

Neni 25, paragrafi 3.6, fshihet në tersi.

**Neni 9**

Neni 26, paragrafi 3.5, fshihet në tersi.

**Neni 10**

Neni 27, pas paragrafit 7, shtohet edhe një paragraf i ri duke u renditur me numër 8, dhe atë, si në vijim:

8. Kufizimet e parapara në paragrafin 2, të Nenit 3, nuk do të zbatohen në këtë Nen.

**Neni 11**

1. Neni 28, paragrafi 3.6, fshihet në tersi.

2. Neni 28, pas paragrafit 4, shtohet edhe një paragraf i ri duke u renditur me numër 5, dhe atë, si në vijim:

5. Personat fizik dhe juridik mund të përfitojnë subvencione, transfere dhe grante sipas këtij Neni në vlerë maksimale deri në 1,000.00 € (një mijë euro).

**Neni 12**

1. Neni 31, paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

2. Komuna mund të ndajë subvencione, transfere dhe grante në formë të mjeteve financiare për bujqësi dhe zhvillim rural me kërkesë të palës apo me Thirrje Publike duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
2.1. Përkrahje për organizimin e panaireve;
2.2. Përkrahje e projekteve me bashkëfinancim;
2.3. Përkrahje e projekteve për zhvillim dhe turizëm rural;
2.4. Përkrahje të projekteve të mekanizimit bujqësor;
2.5. Përkrahje të projekteve për ngritje të serrave;
2.6. Përkrahje të projekteve për ngritje të pemishteve;
2.7. Përkrahje të projekteve në fushën e lavërtarisë dhe perimtarisë;
2.8. Përkrahje të projekteve në fushën e blegtorisë dhe bletarisë;
2.9 Përkrahje të projekteve në fushën e bimëve mjekësore;
2.10. Rastet e fatkeqësive që prekin fermerët;
2.11. Pagesa direkte për sipërfaqet e mbjellura me drithëra;
2.12. Pagesa direkte për lopë qumështore;
2.13. Pagesa direkte për dele dhe dhi qumështore;
2.14. Pagesa direkte për bletë;
2.15. Pagesa direkte për qumësht/litër.

2. Neni 31, paragrafi 4, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

4. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve në formë të mjeteve financiare për bujqësi dhe zhvillim rural duke përfshirë por pa u kufizuar, si: përkrahje të projekteve të mekanizimit bujqësor, projekteve për ngritje të serrave, projekteve për ngritje të pemishteve, projekteve në fushën e lavërtarisë dhe perimtarisë, projekteve në fushën e blegtorisë dhe bletarisë, projekteve në fushën e bimëve mjekësorë, pagesa direkte, dhe fusha tjera të ngjashme, drejtoria obligohet që pas lejimit nga Kryetari i Komunës për shpalljen e Thirrjes Publike, të zhvilloj procedurat e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve mbi bazën e thirrjes publike të komunës.

3. Neni 31, paragrafi 5, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

5. Në Thirrjen Publike duhet të përcaktohen qartë fushat e përkrahjes, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim. Nëse vlera e përkrahjes së subvencionit, transferit dhe grantit nga Komuna e kalon shumën maksimale të përkrahjes të specifikuar në Thirrje Publike, diferenca e mbetur mbulohet nga vetë fermeri përfitues. Fermerët përfitues pas nënshkrimit të Marrëveshjes/Kontratës janë të obliguar që investimin ta realizojnë paraprakisht me mjetet e tyre vetanake financiare, pas përfundimit të plotë të procedurës së blerjes, me qëllim të ekzekutimit të mjeteve financiare nga ana e Komunës, fermerët duhet të dorëzojnë dokumentacionin që dëshmon realizimin investimit, me përjashtim të pagesave direkte.

**Neni 13**

Neni 32, paragrafi 1, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

1. Kushtet, kriteret e përgjithshme dhe dokumentet për të qenë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve duke u bazuar në kriteret e Thirrjes Publike, përfshijnë por pa u kufizuar dokumentet, si në vijim:
1.1. Formulari i aplikimit;
1.2. Numri identifikues i fermerit (NIF);
1.3. Certifikatën e biznesit (nëse funksionon si biznes dhe nëse kërkohet);
1.4. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
1.5. Certifikata e pronës;
1.6. Projektin dhe planin financiar (nëse kërkohet);
1.7. Konfirmimin nga banka me numrin e xhirollogarisë së aplikuesit;
1.8. Vërtetimi tatimor nga ATK (nëse kërkohet);
1.9. Deklaratën se nuk është përfitues i granitit të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë brenda viti fiskal, përjashtimisht pagesat direkte.

**Neni 14**

Pas Nenit 32, shtohet edhe një nen i ri duke u renditur me numër 32A, dhe atë, si në vijim:

**Neni 32A**

**Kriteret Specifike dhe sistemi i pikëzimit në vlerësimin e aplikacioneve**

1. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve në formë të mjeteve financiare për bujqësi dhe zhvillim rural, me përjashtim të pagesave direkte, në kushte të barabarta të vlerësimit, Komuna aplikon kritere specifike të vlerësimit me pikë sipas tabelës në vijim (Tabela Nr.1).
2. Vlerësimi me pikë për kriterin specifik "Madhësia e fermës" do të bazohet vetëm në nënkriterin që përputhet plotësisht me fushën e përkrahjes të thirrjes publike, nënkriteret e tjera nuk do të llogariten.

**Tabela 1:** Kriteret Specifike dhe Sistemi i Vlerësimit me pike të Aplikacioneve

| | Kriteret specifike Vlerësimi | | Përshkrimi | Pikët |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Madhësia dhe Struktura e Fermës | 1.1 | ≥ 1 ha tokë bujqësore me drithëra/perime | 55 |
| | | | < 1 ha tokë bujqësore me drithëra/perime | 50 |
| | | 1.2 | ≥ 5 lopë qumështore/viça ose 30 dele ose 20 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit) | 55 |
| | | | < 5 lopë qumështore/viça ose 30 dele ose 20 dhi (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit) | 50 |
| | | 1.3 | ≥ 30 koshere ( shoqëri bletësh, në ekonominë familjare në emër të aplikuesit) | 55 |
| | | | < 30 koshere ( shoqëri bletësh, në ekonominë familjare në emër të aplikuesit) | 50 |
| | | 1.4 | ≥ 100 pula ose rosa (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit) | 55 |
| | | | < 100 pula ose rosa (në ekonominë familjare në emër të aplikuesit) | 50 |
| | | 1.5 | ≥ 0.50 ha pemishte | 55 |
| | | | < 50 ha pemishte | 50 |
| | | 1.6 | ≥ 0.05 ha serrë | 55 |
| | | | < 0.05 ha serrë | 50 |
| 2. | Vendi i investimit | | Realizimi i investimit në zonat malore | 5 |
| 3. | Gjinia e fermerit | | a) Femra si person fizik (pronare e fermës ku zhvillohet aktiviteti, e dëshmuar me NIF);<br>b) Femra si person juridik (pronare e biznesit). | 5 |
| 4. | Historiku i përfitimit | | Aplikuesi që nuk ka përfituar grant nga Komuna e Mitrovicës së Jugut ose nga donatorët e tjerë gjatë dy vitet e fundit (përjashtohen pagesat direkte). | 10 |
| 5. | Mosha e aplikuesit | | Aplikuesi i ri (në momentin e aplikimit është 40 vjeç ose më i ri) | 5 |
| 6. | Përgatitje profesionale shkollore | | Aplikuesi me diplomë të shkollës së mesme të bujqësisë ose të Fakultetit të Bujqësisë | 5 |
| 7. | Pronësia e tokës | | Posedimi i listës poseduese të tokës bujqësore në emër të aplikuesit | 5 |
| | | | Posedon tokën bujqësore në shfrytëzim përmes kontratës së noterizuar mbi dhjetë (10) vite | 5 |
| 8. | Përvoja dhe trajnimet | | Posedimi i diplomës ose certifikatës së trajnimit në fushën e bujqësisë | 3 |
| 9. | Aplikuesit /Fermerët | | Personat me nevoja të veçanta dhe me status të veçantë | 2 |
| | **Gjithsej** | | | **100** |

**Neni 15**

Neni 33, paragrafi 1.4, fshihet në tersi.

**Neni 16**

1. Neni 34, paragrafi 1.4, fshihet në tersi.

2. Neni 34, paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

2. Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për subvencionim për sipërfaqe të mbjellura me drithëra bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim si dhe shuma e mbështetjes financiare e cila mund të jetë deri në vlerën 150.00 €/ha (njëqind e pesëdhjetë euro për hektar).

**Neni 17**

1. Neni 35, paragrafi 1.8, fshihet në tersi.

2. Neni 35, paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

2. Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për qumësht/litër bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim, si dhe shuma e mbështetjes financiare e cila mund të jetë deri në vlerën 0.10 €/litër (dhjetë cent për litër).

**Neni 18**

1. Neni 36, paragrafi 1.5, fshihet në tersi.

2. Neni 36, paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

2. Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për krerë lopë, dele, dhi qumështore bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim, dhe shuma e mbështetjes financiare e cila mund të jetë deri në vlerën 50.00 €/krerë, gjedhe (pesëdhjetë euro për krerë - lopë qumështore), si dhe deri në vlerën 20.00 €/krerë për kafshë të imta (njëzet euro për krerë - dele dhe dhi qumështore).

**Neni 19**

1. Neni 37, paragrafi 1.6, fshihet në tersi.

2. Neni 37, paragrafi 2, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

2. Ndarja e subvencioneve dhe transfereve për pagesa direkte për shoqëri bletësh bëhet në bazë të Thirrjes Publike në të cilën përcaktohen kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për aplikim si dhe shuma e mbështetjes financiare e cila mund të jetë deri në vlerën 20.00 €/shoqëri bletësh (njëzet euro për shoqëri bletësh).

**Neni 20**

1. Neni 38, paragrafi 3, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

3. Subvencionet dhe transferet nga Drejtoria për Shëndetësi ofrohen për këto raste:
3.1. Sëmundjet e sapo diagnostikuara me kancer (sëmundje malinje), si dhe trajtimi i tyre deri 1-2 vitet e para të trajtimit;
3.2. Fëmijët me ngecje fizike dhe probleme psikike;
3.3. Rastet e rënda akute shëndetësore dhe lëndimet e rënda nga fatkeqësitë.

2. Neni 38, paragrafi 4.3, fshihet dhe riformulohet, si në vijim:

4.3. Numri i anëtarëve të familjes;

**Neni 21**

Neni 39, paragrafi 1.5, fshihet në tersi.

**Neni 22**

Neni 40, pas paragrafit 4, shtohet edhe një paragraf i ri duke u renditur me numër 5, dhe atë, si në vijim:

5. Drejtoria për Mirëqenie Sociale në vartësi të mundësive financiare që ka në dispozicion, mund të kërkoj nga Kuvendi i Komunës përmes Kryetarit të Komunës ndarjen e mjeteve financiare si ndihmë e njëhershme për rastet/familjet sociale të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Neni 23**

Kjo Rregullore shpallet 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, dhe hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Kryesuesi i Kuvendit**

______________________

**z. Safet KAMBERI**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Lista e pjesëmarrësve në Diskutim Publik për Hartimin e Draft - Rregullores për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, i mbajtur më datë 08.09.2026, në ora 10:00 h**

| Nr. | Emri/Mbiemri | Pozita /Org. | Tel | Email | Signature |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Rrahman Rexhepi | Fermer | 049-652-482 | | |
| 2. | Ismail Rexhepi | Fermer | 049-269-356 | | |
| 3. | Elvira Xhemali | Zyrtare | 049120828 | | |
| 4. | Mirsada Fejzullahi | Zyrtare | 049-709062 | | M. Fejzullahi |
| 5. | Xhevahire Bosnjaku | Zyrtare | 044-331-096 | | |
| 6. | Sofije Rashiti Peci | Zyrtare | 044227 880 | | |
| 7. | Albana Fejza | Zyrtare e lartë ligjore | 049/242-771 | albana.fejza@rks-gov.net | |
| 8. | Albina K. Rama | Drejtoresha në Drejtorinë e Shëndetësisë | 044/214-153 | Albina.Kastrati.Rama@rks-gov | |
| 9. | Remzije Tupella | Drejtoresh e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 044-482-018 | remzije.tupella@rks-gov | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 10. | Bori [illegible] | [illegible] | 044977766 | | |
| 11. | Nexhat Rexhiqi | Zyrtare | 044147669 | | |
| 12. | Dlar Bektashi | Praktikant | 046 228 998 | | |
| 13. | Elif Ibrahimi | Praktikant | 049393898 | elifibrahimi29@gmail.com | |
| 14. | | | | | |
| 15. | | | | | |
| 16. | | | | | |
| 17. | | | | | |
| 18. | | | | | |
| 19. | | | | | |

## Lulzim Hajra

**From:** arta_ibishi@hotmail.com
**Sent:** Saturday, September 5, 2026 4:09 PM
**To:** Lulzim Hajra; arjeta.beqiri@rks-gov.net
**Subject:** Përkrahim organizimin e konkursit komunal për ndarjen e çmimeve për kopshtet, ballkonet dhe sipërfaqet më të mirë të rregulluara

Caution! This message was sent from outside your organization. Allow sender | Block sender

I nderuari z. Hajra,

Grupi i Ambientalistëve të Mitrovicës shprehin përkrahjen e tyre për iniciativën e Komunës së Mitrovicës së Jugut për organizimin e konkursit për kopshtin, ballkonin dhe sipërfaqet më të mirë të rregulluara.

E konsiderojmë këtë një iniciativë shumë të mirë për promovimin e gjelbërimit urban, mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e hapësirave publike dhe private, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në kujdesin ndaj mjedisit.

Urojmë që ky konkurs të nxisë sa më shumë qytetarë, biznese dhe komunitete që të kontribuojnë në krijimin e një Mitrovice më të gjelbër, më të pastër dhe më të bukur.

Me respekt,
Ambientalistët e Mitrovicës
Mitrovicë, 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Komuna e Mitrovicës
Nr. 01-060/04 - 0053791/26 dt. 08.09.2026
Mitrovicë

# P R O C E S V E R B A L

(I Diskutimit Publik, të mbajtur më datë 08.09.2026 nga Komisioni për hartimin e Draft – Rregullores për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve,)

**Në Diskutim Publik morën pjesë**: Kryesuesi i Komisionit, dhe Anëtarët e Komisionit, Zyra për Informim e Komunës, , Qytetar, Praktikant dhe disa nga zyrtarët e Komunës.

**Diskutimi Publik filloi në ora:** 10:00 h
**Përfundoi në ora:** 11:00 h.

Në diskutim publik Kryesuesi së bashku me anëtarët e Komisionit prezantuan Draft – Rregulloren për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, duke specifikuar çështjet me të cilat është plotësuar Rregullorja bazë si dhe çështjet të cilat parashihen të ndryshohen me këtë Rregullore.
Pas hapjes së diskutimit, nga pjesëmarrësit më tepër kishte interesim për interpretime dhe sqarime të neneve që plotësojnë dhe ndryshojnë Rregulloren bazë, se sa parashtrimi i çështjeve të reja që mund të përfshihen në këtë Rregullore, apo largimi i çështjeve/neneve ekzistuese qoftë të Rregullores bazë apo edhe të kësaj Draft – Rregullore.

Pasi që nuk pati pjesëmarrës të tjerë në takim dhe komente të tjera, Komisioni e mbylli takimin, dhe konsideron se e ka përfunduar obligimin ligjor për mbajtjen e këtij diskutimi, i njëjti vendosi që të mbahet dhe një takim punues ku do të analizohen të gjitha çështjet e parashtruara gjatë Konsultimit Publik për të përfunduar Draftin Final të Rregullores për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve.

Ky takim u vendos që të mbahet më datë 08.09.2026, në orën 14:00 h, me ç'rast dhe do të finalizohet ky Draft.

Takimi përfundoi në ora 11:00 h.

**Pjesëmarrësit e takimit:**

| | |
|---|---|
| Kryesuesi i Komisionit | Procesmbajtëse |
| Lulzim Hajra | Albana Fejza |

**T'i dërgohet:**

**1x1** Kryetarit të Komunës
**1x1** Anëtarëve të Komisionit

## Lulzim Hajra

**From:** Lulzim Hajra
**Sent:** Tuesday, August 25, 2026 3:16 PM
**To:** Arta Azemi
**Cc:** Faton Peci; Enis Osmani
**Subject:** FW: Kërkesa për Shpallje të Diskutimit Publik
**Attachments:** Kerkesa per Diskutim Publik - Draft Rregullore per Ndryshim - Plotesimin e Rregullores per Ndarje te Subvencioneve dhe Granteve.pdf; Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 08-2023 per Subvencione.docx

-----Original Message-----
From: Lulzim Hajra
Sent: Tuesday, August 25, 2026 3:09 PM
To: Sofije Rushiti <Sofije.Rushiti@rks-gov.net>; Aferdita Maxhuni <Aferdita.Maxhuni@rks-gov.net>
Cc: Jeton Bajrami <jeton.bajrami@rks-gov.net>; Mentor Ujkani <Mentor.Ujkani@rks-gov.net>; Arber Hajra <Arber.Hajra@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>; Albana Fejza <Albana.Fejza@rks-gov.net>; Bedri Murati <Bedri.Murati@rks-gov.net>
Subject: Kërkesa për Shpallje të Diskutimit Publik

Përshëndetje të nderuara shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Bashkangjitur gjeni Kërkesën për shpalle të Diskutimit Publik, dhe Draft Rregulloren për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, që të jemi në përputhje me datat e parapara të diskutimit, publikimi duhet të bëhet sot.

Duke shpresuar në mirëkuptim nga ana e juaj, ne ju përshëndesim.

Me respekt
Lulzim Hajra

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 25. 08. 26 |
| **REFERENCË:** | 01-030/01-0050721/26 |
| **PËR/ZA/TO:** | **znj. Blerina Kastrati Idrizi - Udhëheqëse e Njësisë së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit** |
| **Cc:** | **z. Faton PECI, Kryetar i Komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Ma.sc. Lulzim HAJRA – Kryesues i Komisionit për Hartim të Draftit Rregullores për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Shpallje e Diskutimit Publik** |

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe Vendimarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke u bazuar në nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020; Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; neni 22 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë si dhe Vendimin Nr. 01-020/04-0045076/26, dt. 04.08.2026, Komisioni Punues në emër të Komunës së Mitrovicës së Jugut, shpall:

## DISKUTIM PUBLIK

### Për Draft – Rregulloren për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultim Publik, i cili do të mbahet ditën e **martë**, me datë **08.09.2026**, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora **10:00 h**.

Duke pasur parasysh rëndësinë e Hartimit të Draft – Rregullores për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e nevojshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij Njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet dhe sugjerimet mund t'i japin përmes e-Mail adresave elektronike tek Komisioni për Hartimin e Draftit të Rregullores për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve: Lulzim.Hajra@rks-gov.net, Jeton.Bajrami@rks-gov.net.

**Bashkangjitur gjeni Draft-Rregulloren për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve.**

## Lulzim Hajra

**From:** Lulzim Hajra
**Sent:** Wednesday, August 26, 2026 9:09 AM
**To:** Bekim Sadiku; Zenel Citaku; Bedri Muja; Bukurije Ujkani
**Cc:** Besa Veseli; Bedri Murati; Mentor Ujkani; Jeton Bajrami; Arber Hajra; Albana Fejza
**Subject:** Përshëndetje
**Attachments:** Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 08-2023 per Subvencione.docx

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju njoftojmë së, Komisionit për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, ka përfunduar Draftin, ku pas konsultimit të brendshëm janë përfshirë edhe kërkesat si dhe rekomandimet e njësive.

Referuar Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, në këtë fazë duhet kërkuar sugjerimet edhe komentet nga: Zyra Ligjore, Njësia për Integrime Evropiane, Njësia për Barazi Gjinore si dhe Njësia për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar, andaj bashkangjitur gjeni Draftin në fjalë për shqyrtim.

Duke shpresuar në mirëkuptimin nga ana e juaj, në emër të Komisionit paraprakisht ju falënderojmë për kontributin e juaj në këtë proces.

Me respekt
Lulzim Hajra

**Lulzim Hajra**

---

| | |
|---|---|
| **From:** | Zenel Citaku |
| **Sent:** | Wednesday, August 26, 2026 2:54 PM |
| **To:** | Lulzim Hajra |
| **Cc:** | Besa Veseli; Bedri Murati; Mentor Ujkani; Jeton Bajrami; Arber Hajra; Albana Fejza; Bedri Muja |
| **Subject:** | RE: Përshëndetje |

I nderuar,

Në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, japim këtë vlerësim lidhur me ndikimin e saj në Buxhetin e Komunës.

Nga aspekti financiar, vlerësojmë se miratimi i kësaj Rregulloreje krijon bazë për angazhime të reja dhe/ose zgjerim të fushave të përkrahjes financiare nga Buxheti i Komunës, mirëpo ndikimi i saktë financiar nuk mund të përcaktohet në këtë fazë, pasi Rregullorja nuk përcakton një shumë totale vjetore të mjeteve që duhet të ndahen për zbatimin e saj.

Ndikimi financiar do të varet nga numri i përfituesve, numri i aplikuesve që do t'i plotësojnë kriteret, numri i nxënësve përfitues të transportit, numri i fermerëve dhe sipërfaqet apo njësitë për të cilat do të realizohen pagesat direkte, si dhe nga shumat që do të përcaktohen në Thirrjet Publike.

Në veçanti, Draft-Rregullorja parasheh mundësi të reja për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve, ndër të tjera, për transportin e nxënësve të zonave të thella malore, pagesat direkte për sipërfaqet e mbjella me drithëra, pagesat për lopë, dele dhe dhi qumështore, bletë dhe qumësht/litër.
Rregullorja përcakton edhe disa kufij maksimalë për përkrahjen financiare, si deri në 150.00 €/ha për sipërfaqet e mbjella me drithëra, deri në 0.10 €/litër për qumësht, deri në 50.00 €/krerë për lopë qumështore dhe 20.00 €/krerë për dele dhe dhi qumështore, si dhe deri në 20.00 €/shoqëri bletësh.

Po ashtu, parashihet mundësia që Drejtoria për Mirëqenie Sociale, në varësi të mundësive financiare, të kërkojë ndarjen e mjeteve nga Kuvendi i Komunës për ndihmë të njëhershme për familjet sociale.

Nga perspektiva e menaxhimit financiar, këto dispozita duhet të zbatohen brenda kufijve të ndarjeve buxhetore të miratuara dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike. Çdo thirrje publike dhe çdo vendim për ndarjen e mjeteve duhet të paraprihet nga sigurimi i mjeteve të mjaftueshme në kategorinë përkatëse buxhetore dhe nga konfirmimi i disponueshmërisë së fondeve.

Prandaj, nuk mund të konsiderohet se Rregullorja në vetvete përcakton një kosto të caktuar financiare për Komunën, por ajo krijon detyrime dhe mundësi të reja për ndarjen e mjeteve publike, ndikimi financiar i të cilave do të materializohet në momentin e planifikimit dhe realizimit të skemave konkrete të subvencionimit dhe transferove.

Në përfundim, nga aspekti financiar, Rregullorja mund të përballohet nga Buxheti i Komunës vetëm në kuadër të mjeteve të planifikuara dhe të miratuara për subvencione dhe transfere. Në rast se gjatë zbatimit paraqiten kërkesa që tejkalojnë mjetet e planifikuara, çdo kërkesë për mjete shtesë duhet të trajtohet në pajtim me procedurat ligjore për rishikimin, rialokimin apo ndryshimin e buxhetit.

Ky vlerësim financiar jepet në bazë të përmbajtjes së Draft-Rregullores dhe pa paragjykuar numrin dhe vlerën e përfituesve që do të rezultojnë nga Thirrjet Publike.

Me respekt,

Zenel ÇITAKU

Shef për buxhet dhe financa/ZKF
Komuna e Mitrovicës
Office: +383 (0) 38 200 42 031
Email: zenel.citaku@rks-gov.net

-----Original Message-----
From: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, August 26, 2026 9:09 AM
To: Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>; Bukurije Ujkani <Bukurije.Ujkani@rks-gov.net>
Cc: Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>; Bedri Murati <Bedri.Murati@rks-gov.net>; Mentor Ujkani <Mentor.Ujkani@rks-gov.net>; Jeton Bajrami <jeton.bajrami@rks-gov.net>; Arber Hajra <Arber.Hajra@rks-gov.net>; Albana Fejza <Albana.Fejza@rks-gov.net>
Subject: Përshëndetje

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju njoftojmë së, Komisionit për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, ka përfunduar Draftin, ku pas konsultimit të brendshëm janë përfshirë edhe kërkesat si dhe rekomandimet e njësive.

Referuar Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, në këtë fazë duhet kërkuar sugjerimet edhe komentet nga: Zyra Ligjore, Njësia për Integrime Evropiane, Njësia për Barazi Gjinore si dhe Njësia për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar, andaj bashkangjitur gjeni Draftin në fjalë për shqyrtim.

Duke shpresuar në mirëkuptimin nga ana e juaj, në emër të Komisionit paraprakisht ju falënderojmë për kontributin e juaj në këtë proces.

Me respekt
Lulzim Hajra

**Lulzim Hajra**

| | |
|---|---|
| **From:** | Sadije Jashari |
| **Sent:** | Tuesday, September 1, 2026 11:58 AM |
| **To:** | Lulzim Hajra; Bekim Sadiku; Zenel Citaku; Bedri Muja; Bukurije Ujkani; Besa Veseli; Bedri Murati; Mentor Ujkani; Jeton Bajrami; Arber Hajra; Albana Fejza |
| **Subject:** | RE: Përshëndetje |

Të nderuar,

Uroj të jeni mirë me shëndet dhe se punët po ju ecin mbarë!

Të njejtën kohë, ju përgëzoj për punën dhe përkushtimin tuaj në hatrimin e draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve.

Sa i përketë Zyrës për Integrime Evropiane, ju informoj që Zyra në nivel lokal, disponon vetëm me dokumentin Obligimet e Komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, por jo me tërësinë e legjislacionit evropian ( acquis Communautaire). Megjithatë, ngase dokumenti Obligimet nga Agjenda Evropiane, është dokument zyrtar i vlefshëm për të gjitha komunat dhe duke u bazuar në këtë dokument, më poshtë do gjeni disa nga rekomandimet që dalin nga kjo Agjendë :

Blloku III -STANDARDET EVROPIANE
Tek masa BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL; Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria Objektivi-1.2.Konsolidimi i mëtejmë i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural Masa 2: Mbështetja nga komuna për fermerët në sektorin e drithrave, hortikulturës, blegtorisë, etj të ceket sektori dhe numri e fermerëve të përkrahur.

Duke u bazuar në draft rregulloren e hartuar nga Komisioni për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, ku sektorit të Bujqësisë i është dhënë rëndësi e veçantë, andaj nga Zyra për integrime Evropiane, ju informojmë se dokumenti i hartuar, është në harmonizim me dokumentin e Obligimet e Komunaave nga Agjenda Evropiane.

Ndërsa, tek e njëjta Rregullore, sa i përket Zyres Komunale për Komunitete dhe Kthim, Sipas dokumentit Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane; Blloku III -STANDARDET EVROPIANE Tek masa MENAXHIMI I KUFIJVE DHE MIGRIMIT ; Neni 85 – MSA-së, Vizat, Menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni
Objektiva: 6.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur 1.Numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunë, 2.Numri i shtëpive të (ri) ndërtuara për të rikthyerit, 3.Numri i shtëpive të (ri) ndërtuara për të rikthyerit, 4.Numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar,

Duke u bazuar në draft rregulloren e hartuar nga Komisioni për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, gjithashtu i është dhënë rëndësi e veçantë përkrahjes nga ana e komunës Zyres për Komunitete dhe Kthim si dhe Personave të Riatëdhesuar.
Lidhur me përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përfitimin nga subvencionet dhe përkrahja, Zyra për IE, nuk ka përgjegjësinë të japë mendim, janë instancat tjera përgjegjëse për këto çështje.

Me respekt,

Sadije Jashari
Zyrtare e lartë për Integrime Evropiane/ Senior European Integration Officer Komuna e Mitrovicës së Jugut/ Municipality of South Mitrovica
phone(centrix): 42 023; loc: 134
e-mail: sadije.jashari@rks-gov.net

-----Original Message-----
From: Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>
Sent: Monday, August 31, 2026 1:17 PM
To: Sadije Jashari <Sadije.Jashari@rks-gov.net>
Subject: FW: Përshëndetje

-----Original Message-----
From: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, August 26, 2026 9:09 AM
To: Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>; Bukurije Ujkani <Bukurije.Ujkani@rks-gov.net>
Cc: Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>; Bedri Murati <Bedri.Murati@rks-gov.net>; Mentor Ujkani <Mentor.Ujkani@rks-gov.net>; Jeton Bajrami <jeton.bajrami@rks-gov.net>; Arber Hajra <Arber.Hajra@rks-gov.net>; Albana Fejza <Albana.Fejza@rks-gov.net>
Subject: Përshëndetje

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju njoftojmë së, Komisionit për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, ka përfunduar Draftin, ku pas konsultimit të brendshëm janë përfshirë edhe kërkesat si dhe rekomandimet e njësive.

Referuar Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, në këtë fazë duhet kërkuar sugjerimet edhe komentet nga: Zyra Ligjore, Njësia për Integrime Evropiane, Njësia për Barazi Gjinore si dhe Njësia për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar, andaj bashkangjitur gjeni Draftin në fjalë për shqyrtim.

Duke shpresuar në mirëkuptimin nga ana e juaj, në emër të Komisionit paraprakisht ju falënderojmë për kontributin e juaj në këtë proces.

Me respekt
Lulzim Hajra

## Lulzim Hajra

**From:** Bedri Muja
**Sent:** Thursday, August 27, 2026 2:37 PM
**To:** Lulzim Hajra
**Cc:** Bukurije Ujkani
**Subject:** Përshëndetje
**Attachments:** Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 08-2023 per Subvencione.docx

Përshendetje,

Fillimisht Zyra Ligjore ju përgëzon për punën dhe angazhimin në hartimin e Draftit të dërguar nga ana e juaj për shqyrtim.
Në shqyrtim të Draftit të Rregullores NR. __/2026 Për Plotësim Ndryshimin e Rregullores nr.08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Zyra Ligjore konsideron se është e nevojshme që të plotësohet dispozita e nenit 13 në të cilën fshihet dhe riformulohet dispozita e nenit 31, paragrafi 1 ashtu që të përfshihen të listuara dokumentacioni i kërkuar (shih nenin 13, paragrafi 1).
Po ashtu neni 20, me të cilën fshihet dhe riformulohet dispozita e nenit 38, paragrafi 3.1., 3.2. dhe 3.3 konsiderojm si të pa nevojshme të formulohen ndaras, meqense kemi të bëjmë më situatën e ndryshimit të dispozitës në pjesën më të madhe, atëherë propozoj që të kalohet në ndryshim dhe riformulim të paragrafit 3 të nenit 38, ku përfshihen edhe nën-paragrafët respektiv.

Falemnderit për mirëkuptim.

-----Original Message-----
From: Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>
Sent: Wednesday, August 26, 2026 9:09 AM
To: Bekim Sadiku <Bekim.Sadiku@rks-gov.net>; Zenel Citaku <Zenel.Citaku@rks-gov.net>; Bedri Muja <Bedri.Muja@rks-gov.net>; Bukurije Ujkani <Bukurije.Ujkani@rks-gov.net>
Cc: Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>; Bedri Murati <Bedri.Murati@rks-gov.net>; Mentor Ujkani <Mentor.Ujkani@rks-gov.net>; Jeton Bajrami <jeton.bajrami@rks-gov.net>; Arber Hajra <Arber.Hajra@rks-gov.net>; Albana Fejza <Albana.Fejza@rks-gov.net>
Subject: Përshëndetje

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju njoftojmë së, Komisionit për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, ka përfunduar Draftin, ku pas konsultimit të brendshëm janë përfshirë edhe kërkesat si dhe rekomandimet e njësive.

Referuar Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, në këtë fazë duhet kërkuar sugjerimet edhe komentet nga: Zyra Ligjore, Njësia për Integrime Evropiane, Njësia për Barazi Gjinore si dhe Njësia për Buxhet dhe Financa/Zyrtari Kryesor Financiar, andaj bashkangjitur gjeni Draftin në fjalë për shqyrtim.

Duke shpresuar në mirëkuptimin nga ana e juaj, në emër të Komisionit paraprakisht ju falënderojmë për kontributin e juaj në këtë proces.

Me respekt
Lulzim Hajra

**Lulzim Hajra**

---

| | |
|---|---|
| **From:** | Lulzim Hajra |
| **Sent:** | Wednesday, August 12, 2026 11:45 AM |
| **To:** | Drejtoret.Mitrovica; Snezana Nestorovic |
| **Cc:** | Arta Azemi; Jeton Bajrami; Mentor Ujkani; Arber Hajra; Besa Veseli; Albana Fejza; Bedri Murati |
| **Subject:** | Konsultimi i brendshëm |
| **Attachments:** | Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 08-2023 per Subvencione.pdf; Rregullorja-Nr.-08-2023-per-kushtet-kriteret-procedurat-per-ndarjen-e-subvencioneve-dhe-granteve.pdf |

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju njoftojë që Komisioni për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, i formuar me Vendimin e datës 04.08.2026, ka përgatitur Draftin e Rregullores dhe të njëjtën po ju përcjellim për konsultim të brendshëm.

Ju lutem që secila njësi që ka propozime eventuale për ndryshim/plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, të njëjtat t'i dërgon më së largu deri me datën **14.08.2026,** pastaj të njëjtat do të shqyrtohen nga ana e Komisionit për përfshirje në Draft.

Me respekt

Lulzim Hajra

## Lulzim Hajra

**From:** Jeton Bajrami
**Sent:** Wednesday, August 19, 2026 9:41 AM
**To:** Lulzim Hajra
**Cc:** Remzije Tupella
**Subject:** DBZHR

Shpresoj që jeni mirë me shëndet dhe po kaloni mirë me punë.

- **Pagesa direkte për sipërfaqet e kultivuara me drithëra** – Mbështetja financiare në vlerë deri në **150.00 €/ha** (njëqind e pesëdhjetë euro për hektar).
- **Pagesa direkte për gjedhe (lopë qumështore)** – Mbështetja financiare në vlerë deri në **50.00 €/krerë** (pesëdhjetë euro për krerë).
- **Pagesa direkte për imëta (dele dhe dhi qumështore)** – Mbështetja financiare në vlerë deri në **20.00 €/krerë** (njëzet euro për krerë).
- **Pagesa direkte për bletari** – Mbështetja financiare për shoqëri të bletëve në vlerë deri në **20.00 €/shoqëri bletësh** (njëzet euro për shoqëri).
- **Pagesa direkte për qumështin e dorëzuar** – Mbështetja financiare për qumështin e dorëzuar në pikat e grumbullimit (sipas kategorisë së cilësisë) në vlerë deri në **0.10 €/litër** (dhjetë centë për litër).

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

**Jeton Bajrami**
Shef për Zhvillim Rural
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Komuna e Mitrovicës së Jugut
E-mail: jeton.bajrami@rks-gov.net

**Lulzim Hajra**

---

**From:** Shefki Begu
**Sent:** Wednesday, August 12, 2026 2:58 PM
**To:** Lulzim Hajra
**Cc:** Arta Azemi; Jeton Bajrami; Enis Osmani
**Subject:** RE: Konsultimi i brendshëm

---

Të nderuar,

Drejtoria e Arsimit planifikon që, me mbylljen e shkollave në zonat e thella malore, për shkak të vështirësive të organizimit të transportit, të bëjë subvencionimin e transportit për fëmijët e këtyre zonave të thella malore përmes kësaj rregulloreje.

Prandaj, kërkojmë që të shtohet si pikë e rregullores së Drejtorisë së Arsimit ky subvencionim.

**From:** Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>
**Sent:** Wednesday, August 12, 2026 11:45 AM
**To:** Drejtoret.Mitrovica <Drejtoret.Mitrovica@rks-gov.net>; Snezana Nestorovic <Snezana.Nestorovic@rks-gov.net>
**Cc:** Arta Azemi <Arta.Azemi@rks-gov.net>; Jeton Bajrami <jeton.bajrami@rks-gov.net>; Mentor Ujkani <Mentor.Ujkani@rks-gov.net>; Arber Hajra <Arber.Hajra@rks-gov.net>; Besa Veseli <Besa.Veseli@rks-gov.net>; Albana Fejza <Albana.Fejza@rks-gov.net>; Bedri Murati <Bedri.Murati@rks-gov.net>
**Subject:** Konsultimi i brendshëm

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju njoftojë që Komisioni për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, i formuar me Vendimin e datës 04.08.2026, ka përgatitur Draftin e Rregullores dhe të njëjtën po ju përcjellim për konsultim të brendshëm.

Ju lutem që secila njësi që ka propozime eventuale për ndryshim/plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, të njëjtat t'i dërgon më së largu deri me datën **14.08.2026,** pastaj të njëjtat do të shqyrtohen nga ana e Komisionit për përfshirje në Draft.

Me respekt

Lulzim Hajra

**Lulzim Hajra**

| | |
|---|---|
| **From:** | Refik Azemi |
| **Sent:** | Thursday, August 20, 2026 8:22 AM |
| **To:** | Lulzim Hajra |
| **Cc:** | Shefki Begu; Kreshnik Zejnullahu; Fisnik Çitaku; Valon Hetemi |
| **Subject:** | RE: Përshëndetje |

I nderuari Lulzim,

Shpresojmë të jeni mirë.

Në vijim i gjeni disa nga propozimet tona për disa ndryshime të vogla, të theksuara me ngjyrë të verdhë, si në vijim:

**Neni --**

Neni 19, pas paragrafi 2.9, shtohet një paragraf i ri duke u renditur me numër 2.10 dhe atë si në vijim:

2.10. Nxënësit e zonave të thella malore, transporti me rastin e **shuarjes së veprimtarisë së shkollave.**

**Neni –**

Pas Nenit 23, shtohet edhe një Nen i ri duke u renditur me numër 23A, dhe atë si në vijim:

**Neni 23A**

**Kriteret, kushtet dhe dokumentet për përfitim të subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit e zonave të thella malore me rastin e shuarjes së veprimtarisë së Shkollave Fillore (ShF) dhe Shkollave të Mesme të Ulëta (ShMU) të arsimit të obliguar**

1. Kriteret, kushtet dhe dokumentet që duhet të kompletohen për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit e zonave të thella malore me rastin **e shuarjes së veprimtarisë** së shkollave, përfshijnë por pa u kufizuar:

1.1.Kërkesa e palës;
1.2.Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
1.3.Certifikata e lindjes së fëmijës;
1.4.Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;
**1.5.Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon vendbanimin;**
1.6.Vërtetimi i shkollës së re në të cilën e vijon mësimin;
**1.7.Raporti i shkollës së re për vijueshmërinë;**
1.8.Konfirmimi i bankës me numrin e xhirollogarisë bankare në emër të përfituesit apo familjarit të tij;

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

**From:** Shefki Begu <Shefki.Begu@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, August 18, 2026 1:42 PM
**To:** Refik Azemi <Refik.Azemi@rks-gov.net>; Kreshnik Zejnullahu <Kreshnik.Zejnullahu@rks-gov.net>
**Subject:** FW: Përshëndetje

**From:** Lulzim Hajra <Lulzim.Hajra@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, August 18, 2026 9:43 AM
**To:** Shefki Begu <Shefki.Begu@rks-gov.net>
**Subject:** Përshëndetje

Përshëndetje Drejtor, shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Pas kërkesës së parashtruar nga ana e juaj, për përfshirje në ndryshim/plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, edhe subvencionimin e transportit për nxënësit e zonave të thella malore. Kemi përgatit këtë draft të cilin ju lutem ta shqyrtoni me stafin e juaj dhe të propozoni ndryshimet eventuale duke shtuar apo larguar nga kushtet, kriteret dhe dokumentacioni apo edhe në formulime në mënyrë që mos të hasim në pengesa apo paqartësi gjatë implementimit.

Në draft do të përfshihen dy ndryshime dhe atë si në vijim:

**Neni --**

Neni 19, pas paragrafi 2.9, shtohet edhe një paragraf i ri duke u renditur me numër 2.10 dhe atë si në vijim:

2.10. Nxënësit e zonave të thella malore, transporti me rastin e mbylljes së shkollave.

**Neni –**

Pas Nenit 23, shtohet edhe një Nen i ri duke u renditur me numër 23A, dhe atë si në vijim:

**Neni 23A**

**Kriteret, kushtet dhe dokumentet për përfitim të subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit e zonave të thella malore me rastin e mbylljes së shkollave**

1. Kriteret, kushtet dhe dokumentet që duhet të kompletohen për të qenë përfitues i subvencioneve dhe transfereve për pagesën e transportit për nxënësit e zonave të thella malore me rastin e mbylljes së shkollave, përfshijnë por pa u kufizuar:

1.1.Kërkesa e palës;
1.2.Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
1.3.Certifikata e lindjes së fëmijës;
1.4.Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;
1.5.Dëshmia që shkolla në të cilën ka vijuar mësimin është mbyllur;
1.6.Vërtetimi i shkollës së re në të cilën e vijon mësimin.
1.7.Konfirmimi i bankës me numrin e xhirollogarisë bankare në emër të përfituesit apo familjarit të tij;
1.8.Dokumenti që dëshmon se fëmija vijon mësimin minimum -- km (-- kilometër) larg nga vendi i banimit; (nëse konstatoni se duhet të përfshihet edhe ky paragraf duhet të specifikohen km)

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të Rekomandimit të Komisionit.

Ju lutem që ta trajtoni me prioritet dhe t'i dërgoni rekomandimet gjatë ditës e më së largu nesër sepse komisioni është duke bërë përpjekje që ta finalizoj draftin dhe ta miratoj këtë javë me qëllim të inicimit të procedurave të diskutimit publik.

Duke shpresuar në mirëkuptimin nga ana e juaj, ne ju përshëndesim

Me respekt

Lulzim Hajra

**Lulzim Hajra**

| | |
|---|---|
| **From:** | Albana Fejza |
| **Sent:** | Friday, August 14, 2026 1:34 PM |
| **To:** | Lulzim Hajra; Drejtoret.Mitrovica; Snezana Nestorovic |
| **Cc:** | Arta Azemi; Jeton Bajrami; Mentor Ujkani; Arber Hajra; Besa Veseli; Bedri Murati |
| **Subject:** | Re: Konsultimi i brendshëm |
| **Attachments:** | Draft - Rregullorja per ndryshimin e rregullores per Subvencione 2026.doc |

Te nderuar/a

Uroj te jeni mire dhe punet po ju shkojne mbare,

Ne emer te Drejtorise për Shëndetesi, ju njoftoje qe bashkarisht me drejtoren si dhe anetaret e komisionit per ndarjen e subvencionve kemi diskuatuar lidhur me ndryshim/plotesimin e kesaj Rregulloreje tek pjesa qe perfshine Drejtorine per Shendetesi.

Andaj, te bashkangjitur gjeni rekomandimet e dala nga diskutimi i brendshem i Drejtorise per Shendetesi.

Me respekt
Albana!

---

**From:** Lulzim Hajra
**Sent:** Wednesday, August 12, 2026 11:45 AM
**To:** Drejtoret.Mitrovica; Snezana Nestorovic
**Cc:** Arta Azemi; Jeton Bajrami; Mentor Ujkani; Arber Hajra; Besa Veseli; Albana Fejza; Bedri Murati
**Subject:** Konsultimi i brendshëm

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju njoftojë që Komisioni për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, i formuar me Vendimin e datës 04.08.2026, ka përgatitur Draftin e Rregullores dhe të njëjtën po ju përcjellim për konsultim të brendshëm.

Ju lutem që secila njësi që ka propozime eventuale për ndryshim/plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, të njëjtat t'i dërgon më së largu deri me datën **14.08.2026,** pastaj të njëjtat do të shqyrtohen nga ana e Komisionit për përfshirje në Draft.

Me respekt

Lulzim Hajra

Neni 38 paragrafi 3.1 fshihet në tersi dhe riformulohet si në vijim

3.1 Sëmundjet e sapo diagnostifikuara me kancer (sëmundje malinje) si dhe trajtimi i tyre deri 1-2 vitet e para të trajtimit;

Neni 38 paragrafi 3.2 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim;

3.2 Fëmijët me ngecje fizike dhe probleme psikike;

Neni 38 paragrafi 3.3 fshihet në tersi dhe riformulohet si në vijim;

3.3 Rastet e rënda akute shëndetësore dhe lëndimet e rënda nga fatkeqësitë.

Neni 38 paragrafi 4.3 fshihet në tersi dhe riformulohet si në vijim

4.3 Numri i anëtarëve të familjes

Neni 39 paragrafi 1.5 fshihet në tersi

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Komisioni për Hartimin e Draft Rregullores për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve.

Takimi i fundit para procedimit për Kuvendin e Komunës, diskutimi i çështjeve të parashtruara gjatë Konsultimit Publik dhe të Takimit/Diskutimit Publik. Miratimi i Draftit përfundimtar dhe procedimi për miratim në Kuvendin e Komunës.

Data: 08. 09.2026.

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Njësia Organizative | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | ARDËR HAJRA | DKRS | |
| 2 | JETON BAJRAMI | DBZHR | |
| 3 | Mentor Vehuni | DBF | |
| 4 | Albana Pejza | DSH | |
| 5 | LULZIM HAJRA | DMS | |
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

## Lulzim Hajra

**From:** Lulzim Hajra
**Sent:** Thursday, August 20, 2026 3:29 PM
**To:** Bedri Murati; Albana Fejza; Besa Veseli; Arber Hajra; Mentor Ujkani; Jeton Bajrami
**Subject:** Ftesë për takim
**Attachments:** Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 08-2023 per Subvencione.docx

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju ftoj të merrni pjesë në takimin e radhës të Komisionit për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, i cili do të mbahet nesër me dt. 21.08.2026, në ora 10:00, në Sallën e Mediave.

Bashkangjitur gjeni Draftin e Rregullores i cili do të procedohet për diskutim publik pas shqyrtimit nga ana e Komisionit. Në Draft janë përfshirë rekomandimet e anëtarëve të Komisionit si dhe kërkesat e paraqitura nga ana e njësive gjatë diskutimit të brendshëm.

Me respekt
Lulzim Hajra

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Komisioni për Hartimin e Draft Rregullores për Ndryshim Plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve.

Takimi i tretë, diskutimi i Draft Rregullores i cili do të procedohet për diskutim publik pas shqyrtimit nga ana e Komisionit. Në Draft janë përfshirë rekomandimet e anëtarëve të Komisionit si dhe kërkesat e paraqitura nga ana e njësive gjatë diskutimit të brendshëm.

Data: 21.08.2026.

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Njësia Organizative | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | LULZIM HAJRA | DMS | |
| 2 | ARBËR HAJRA | DKRS | |
| 3 | Albana Fejza | OSH | |
| 4 | JETON BAJRAMI | DBZHR | |
| 5 | [illegible] | DEZHTIE | |
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Lulzim Hajra**

---

**From:** Lulzim Hajra
**Sent:** Tuesday, August 11, 2026 11:37 AM
**To:** Bedri Murati; Albana Fejza; Besa Veseli; Arber Hajra; Mentor Ujkani; Jeton Bajrami
**Subject:** Ftesë për takimin e dytë
**Attachments:** Plotësim ndryshimi i Rregullores Nr. 08-2023 per Subvencione.docx

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Ju ftoj të merrni pjesë në takimin e dytë të Komisionit për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, i cili do të mbahet nesër me dt. 12.08.2026, në ora 10:00, në Sallën e Mediave.

Bashkangjitur gjeni Draftin e përgatitur sipas rekomandimeve te Komisionit, të cilin do ta shqyrtojmë para procedimit për konsultim të brendshëm.

Me respekt
Lulzim Hajra

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Komisioni për Hartimin e Draft Rregullores për Ndryshim Plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve.

Takimi i dytë, diskutimi i Draftit të përgatitur sipas rekomandimeve të Anëtarëve të Komisionit.
Data: 12.08.2026.

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Njësia Organizative | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | LULZIM HAJRA | DMS | |
| 2 | Mendor Ujkani | DBF | |
| 3 | ARBËR HAJRA | DKRS | |
| 4 | Albana Fejza | DSH | |
| 5 | Bedri [illegible] | DEZHTIE | |
| 6 | JETON BAJRAMI | DBZHR | |
| 7 | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Lulzim Hajra**

---

**From:** Lulzim Hajra
**Sent:** Wednesday, August 5, 2026 2:13 PM
**To:** Bedri Murati; Albana Fejza; Besa Veseli; Arber Hajra; Mentor Ujkani; Jeton Bajrami
**Subject:** Ftesë për takim
**Attachments:** Rregullorja-Nr.-08-2023-per-kushtet-kriteret-procedurat-per-ndarjen-e-subvencioneve-dhe-granteve.pdf

Përshëndetje të nderuar/a shpresoj që jeni mirë dhe punët po ju ecin mbarë.

Me Vendimin Nr. 01-020/04-0045076/26, dt. 04.08.2026, jeni caktuar si anëtar të Komisionit për hartimin e Draft Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve.

Takimin e parë do ta mbajmë te premten me dt. 07.08.2026, në ora 10:00, në Sallën e Mediave. Ju lutem që paraprakisht ta konsultoni Rregulloren e lartcekur në mënyrë që të fillojmë punën qysh në takimin e parë. Secili anëtarë i Komisionit duhet t'i propozon ndryshimet eventuale për njësinë e vetë, ndërsa sa i përket pjesëve tjera pra, dispozitave të përgjithshme, dispozitat përfundimtare si dhe për njësit që janë të përfshira në Rregullore por nuk kanë përfaqësues në Komision i trajtojmë bashkërisht gjatë takimeve dhe pastaj i marrim komentet gjatë konsultimit të brendshëm.

Me respekt
Lulzim Hajra

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Komisioni për Hartimin e Draft Rregullores për Ndryshim Plotësimin e Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve.

Takimi i parë
Data: 07.08.2026.

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Njësia Organizative | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1 | LULZIM HAJRA | DMS | |
| 2 | MENTOR UJKAN | DBF | |
| 3 | ARBËR HAJRA | DKRS | |
| 4 | BESA VESELI | DAP | |
| 5 | Albana Fejza | DSH | |
| 6 | Bedri Murati | DEZHMIE | |
| 7 | JETON BAJRAMI | DBZHR | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**Kryetari i Komunës**
**Nr.** 01-020/04-0045076/26 **dt.** 04.08.2026
**Mitrovicë**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, dhe Kërkesat elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 30.07.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

# V E N D I M

**(Për Formimin e Komisionit për hartimin e Draft - Rregullores për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve)**

1. **FORMOHET** Komisioni për hartimin e Draft - Rregullores për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:

   **1.1** Lulzim Hajra – Kryesues (DMS);
   **1.2** Bedri Murati – Anëtar (DEZHTIE);
   **1.3** Albana Fejža – Anëtare (DSH);
   **1.4** Besa Veseli – Anëtare (DAP);
   **1.5** Arbër Hajra – Anëtar (DKRS);
   **1.6** Mentor Ujkani – Anëtar (DBF);
   **1.7** Jeton Bajrami – Anëtar (DBZHR).

2. Komisioni është përgjegjës që të bëj hartimin e Draft - Rregullores për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe Granteve, duke bërë harmonizimin e saj me dispozitat ligjore pozitive në fuqi.

3. Komisioni në fjalë obligohet që pas hartimit të Draft - Rregullores së lartcekur të njëjtën ta procedojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përmes Kryetarit të Komunës.

4. Komisioni punues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, Statutin e Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjet për Ndryshim/Plotësimin e tij, Rregullin Financiar Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Komisioni i formuar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka mandat deri në përfundimin e detyrave të përcaktuara me këtë vendim.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E MITROVICËS * REPUBLIKA KOSOVO * OPŠTINA MITROVICA * MITROVICE-MITROVICA

Kryetari i Komunës

Bedri Hamza

Faton PECI

**Shtojcë:**

Kërkesat Elektronike nga Zyra e Kryetarit, dt. 30.07.2026.

**T'i dërgohet:**

1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit

LIKA E KOSOVËS NA E MITROVICËS MITROVICA ITROVICA KOSOVO

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | **15.09.2026** |
| **REFERENCË:** | **NR. 02--400/03-0051745-2/26** |
| **PËR/ZA/TO:** | **Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës** |
| **CC:** | **Anëtarët e Kuvendit të Komunës** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Nazmi Jashari – Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Projekt Buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029** |

## Hyrje

Duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 61, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenet 25 dhe 26 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 19 dhe nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Safet Kamberi, në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim, ka shpallur konsultimin publik për Projekt Buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029, i cili është mbajtur më 09.09.2026 në sallën e Kuvendit të Komunës.

**Ecuria e procesit**

Sekretaria e Kuvendit, në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, ka publikuar njoftimin për konsultim publik për Projekt Buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029, në ueb-faqen zyrtare të Komunës https://mitroviceejugut.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/09/LIBRI-I-BUXHETIT-KOMUNAL-2027-2029-ME-SHKRESE.pdf dhe në rrjetet sociale të Komunës, tetë ditë para mbajtjes së takimit.

Njoftimi për konsultim publik është shpallur brenda afatit të paraparë ligjor, me qëllim të sigurimit të informimit të plotë dhe të duhur të palëve të interesuara. Përmes njoftimit, qytetarët dhe palët e tjera të interesuara janë informuar për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimit publik.

Njoftimit i është bashkëngjitur dokumenti i Projekt Buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029, i cili ka qenë objekt i konsultimit publik, si dhe informatat për personin përgjegjës për pranimin e komenteve dhe sugjerimeve.

**Metodat e konsultimit**

| Metoda e konsultimit | Kohëzgjatja | Numri i pjesëmarrësve/kontribuuesve |
|---|---|---|
| Konsultime me shkrim / në mënyrë elektronike | 14 ditë | 20 |
| Publikimi në ueb-faqen zyrtare të Komunës | 8 ditë para mbajtjes së takimit | |

**Pjesëmarrja në takim**

Në takim morën pjesë gjithsej 20 pjesëmarrës, prej tyre 11 gra dhe 9 burra.

Në konsultimin publik për Projekt Buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 morën pjesë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Safet Kamberi, përfaqësues të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Sekretaria e Kuvendit, drejtorë të drejtorive komunale, Zyra për Informim, si dhe qytetarë të Komunës së Mitrovicës së Jugut, të evidentuar në listën e pjesëmarrjes, e cila i bashkëngjitet këtij raporti.

Takimi është mbajtur më 9 shtator 2026 në sallën e Kuvendit Komunal. Qëllimi i diskutimit ishte prezantimi i prioriteteve buxhetore komunale dhe mbledhja e propozimeve nga qytetarët, përfaqësuesit e lagjeve, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit.

**Diskutimet, pyetjet dhe përgjigjet**

Pjesëmarrësi Pyetja/Komenti,

Myrvete Hasani: Organizata Handikos Mitrovicë ofron shërbime dhe mbështetje për personat me aftësi të kufizuara (PAK), të cilët kanë nevojë për shërbime profesionale dhe mbështetje të vazhdueshme nga stafi i specializuar, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mirëqenies së tyre. Ofrimi i këtyre shërbimeve përbën një nevojë primare për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë drejtim, konsiderojmë se është e nevojshme që nga secila drejtori përkatëse të planifikohet dhe të ndahet një buxhet i veçantë për shërbimet ndaj personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, është e rëndësishme që të sigurohet një buxhet i mjaftueshëm dhe i qëndrueshëm për funksionimin dhe ofrimin e këtyre shërbimeve, në mënyrë që të mbulohen nevojat e organizatave dhe përfituesve të tyre, përfshirë organizatat që ofrojnë shërbime për personat me Sindromën Down dhe Handikos-in. Ndarja e një buxheti të përshtatshëm do të mundësonte vazhdimësinë e shërbimeve profesionale dhe do të kontribuonte drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përfshirjen më të mirë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Ardiana Berisha: Si Handikos Mitrovicë, kemi kërkesë dhe interesim të veçantë që nga Drejtoria e Shëndetësisë të informohemi se cilat shërbime të rehabilitimit planifikon të ofrojë për personat me aftësi të kufizuara. Deri më tani, Komuna e Mitrovicës nuk ka ofruar shërbime të rehabilitimit për personat me aftësi të kufizuara, prandaj konsiderojmë të rëndësishme të kemi informacion të qartë se çfarë shërbimesh do të ofrohen në të ardhmen, cilat do të jenë kapacitetet e tyre dhe si do të sigurohet qasja e personave me aftësi të kufizuara në këto shërbime.

Znj. Albina Kastrati Rama - Drejtoreshë e Shëndetësisë, sqaroi se aktualisht janë në fazën e konsultimeve dhe të përgatitjes për hapjen e konkursit për hartimin e Udhëzimit Administrativ, përmes të cilit do të përcaktohen mundësitë dhe mënyrat e ofrimit të këtyre shërbimeve. Në kuadër të planifikimit, parashihet angazhimi i profesionistëve të profileve të ndryshme, përfshirë psikologë, sociologë dhe profesionistë të tjerë të kujdesit parësor shëndetësor. Synimi është që këto shërbime të fillojnë të zbatohen brenda vitit 2026. Megjithatë, drejtoresha sqaroi se këto shërbime fillimisht nuk kanë qenë të planifikuara në buxhetin e vitit 2026, andaj aktualisht po punohet në planifikimin dhe sigurimin e mjeteve buxhetore të nevojshme për realizimin e tyre gjatë këtij viti. Sa i përket personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht fëmijëve të moshës 0–6 vjeç, u sqarua se shërbimet do të ofrohen në kuadër të Qendrave Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Shërbimet do të jenë të kombinuara, duke përfshirë ofrimin e tyre në QKMF dhe në shtëpi, në varësi të nevojave dhe kërkesave të familjeve. Sipas nevojës, shërbimet do të mund të ofrohen në shtëpi, në çerdhe, në QKMF apo në vendin ku ndodhet personi që ka nevojë për shërbim. Qëllimi është që shërbimet të jenë sa më të qasshme dhe të përshtatura me nevojat e fëmijëve dhe familjeve të tyre. Sa i përket subvencioneve, drejtoresha sqaroi se Komuna aktualisht ka të parapara subvencione, ndonëse fondi në dispozicion nuk është i madh. Në kuadër të këtyre subvencioneve janë të përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, me një fokus të veçantë te fëmijët me aftësi të kufizuara.

Agnesa Shkupolli: (me shkrim) Mbështetje financiare për vazhdimin e shërbimeve profesionale. Kërkohet nga Komuna që, përmes mbështetjes financiare, të mundësojë vazhdimin e shërbimeve profesionale të ofruara nga OJQ Handikos për personat me aftësi të kufizuara. Vazhdimësia e këtyre shërbimeve është e rëndësishme për përmbushjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Punësimi në QKMF dhe zbatimi i legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara. Kërkohet që gjatë hapjes së konkurseve për punësim në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), të respektohen dispozitat ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik. Në procesin e rekrutimit dhe gjatë aplikimit për vendet e punës duhet të bëhet evidentimi dhe trajtimi i kandidatëve me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i kuotave dhe i të drejtave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Isak Hajra: Kërkohet që gjatë planifikimit dhe ndarjes së buxhetit të merret parasysh përfshirja e të gjitha zonave, fshatrave dhe lagjeve të komunës, në mënyrë që përfitimet nga projektet dhe investimet të shpërndahen në mënyrë sa më të barabartë. Brenda mundësive buxhetore, synimi duhet të jetë që secila zonë të përfshihet së paku në një projekt apo aktivitet, duke shmangur përqendrimin e investimeve vetëm në një zonë të caktuar. Një shpërndarje më e drejtë dhe gjithëpërfshirëse e buxhetit do të mundësonte që shërbimet dhe projektet komunale të jenë më të qasshme për të gjithë qytetarët.

Po ashtu, kërkojmë që çështja e kompensimit të kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve të rregullohet në mënyrë të qartë dhe në përputhje me Rregulloren përkatëse të Kuvendit Komunal. Konsiderojmë se kompensimi duhet të përcaktohet në mënyrë të rregullt dhe të jetë ekuivalent me shumën e kompensimit të përcaktuar për anëtarët e komiteteve obligative, duke siguruar trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjitha strukturat përkatëse. Në këtë drejtim, kërkojmë që të gjendet forma e përshtatshme ligjore dhe administrative për rregullimin e kësaj çështjeje. Njëkohësisht, shprehim falënderimin tonë për Kuvendin Komunal dhe Drejtorinë e Financave për mbështetjen dhe përkrahjen e dhënë për kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve. Falënderojmë gjithashtu Kryesuesin e Kuvendit Komunal për iniciativën dhe angazhimin e tij në këtë drejtim.

Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi: Sqaroi se me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, janë ndërprerë pagesat për disa prej këtyre angazhimeve. Në këtë drejtim, është përgatitur një draft-rregullore, në hartimin e së cilës kanë qenë të përfshira edhe organizatat përkatëse dhe Ministria. Bëhet fjalë për një rregullore dhe jo për një udhëzim administrativ, e cila synon të krijojë bazën për rregullimin dhe kompensimin e këtyre angazhimeve, duke obliguar institucionet përkatëse, përfshirë komunat dhe ministrinë, që ta trajtojnë këtë çështje. Kryesuesi theksoi se që nga marrja e detyrës, kjo çështje është trajtuar si një nga prioritetet. Me propozimin e Kryesuesit dhe në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Kuvendi Komunal ka nxjerrë një vendim për kompensimin e kryetarëve të fshatrave, si dhe të anëtarëve të komiteteve dhe komisioneve të themeluara nga Kuvendi Komunal. Sipas tij, Ligji për Pagat ka ndikuar edhe në funksionimin e trupave të Kuvendit Komunal, duke shkaktuar një pasivizim të punës së tyre. Për këtë arsye, vendimi i miratuar nga Kuvendi Komunal po shërben në njëfarë forme edhe si fazë testuese. Aktualisht, vendimi është i plotfuqishëm dhe është proceduar për pagesë, me qëllim që të vlerësohet nëse kjo formë e kompensimit mund të zbatohet në praktikë. Nëse kjo mënyrë e pagesës funksionon dhe rezulton e zbatueshme, atëherë në janar të vitit të ardhshëm do të jetë e nevojshme që Kuvendi Komunal të marrë përsëri një vendim për kompensimin e kryetarëve të fshatrave, komisioneve dhe trupave të tjerë të themeluar nga Kuvendi Komunal. Kryesuesi sqaroi gjithashtu se në planifikimin fillestar të buxhetit për vitin e ardhshëm, nga Zyra e Kuvendit Komunal ishin planifikuar 10,000 € për këtë qëllim, shumë e cila nuk do të ishte e mjaftueshme për të realizuar pagesat e parapara. Me iniciativën e Kryesuesit dhe pas diskutimeve me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Financave, është arritur dakordimi që kjo shumë të rritet në 60,000 €. Qëllimi është që, së paku, të rritet kompensimi për kryetarët e fshatrave, duke marrë parasysh edhe kërkesat e paraqitura nga përfaqësuesit e tyre. Kjo konsiderohet si një hap konkret drejt rregullimit dhe përmirësimit të kompensimit për angazhimin e tyre në komunitet.

Enver Bahtiri, kërkohet që të bëhet rregullimi i rrugëve në fshatin Lisicë, si dhe ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve të shoqëruara me ndriçim publik, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe kushteve të qarkullimit për banorët. Gjithashtu, kërkohet rregullimi i shtratit të lumit Sitnicë dhe përmirësimi i rrugës në pjesën pranë shtëpisë së punëtorit të Komunës z. Naim Hajdarit, i cili është në dializë dhe i paralizuar, ndërsa për shkak të rrugës së dëmtuar shpesh herë nuk po mundet të arrijë Autoambulanca për ta marrë dhe dërguar në dializë, prandaj të intervenohet në këtë rrugë sa ma shpejtë.

Safet Kurti (me shkrim), në emër të banorëve të fshatit Vllahi, ju drejtohemi me kërkesën për rregullimin dhe përmirësimin e një pjese veçanërisht të rëndësishme të rrugës lokale, në segmentin ku ndodhen xhamia dhe shkolla e fshatit. Kjo pjesë e rrugës përbën një nga pikat kryesore të fshatit dhe frekuentohet çdo ditë nga një numër i madh i banorëve, nxënësve dhe qytetarëve të tjerë. Për këtë arsye, konsiderojmë se rregullimi dhe përmirësimi i këtij segmenti është i nevojshëm për të garantuar qarkullim më të sigurt dhe kushte më të mira për banorët dhe nxënësit. Andaj, kërkojmë që kjo pjesë e rrugës të përfshihet në planifikimet komunale dhe të trajtohet me prioritet, në mënyrë që të përmirësohet infrastruktura dhe siguria për të gjithë përdoruesit e saj.

Xhenis Beqiri: Sa mjete buxhetore do të ndahen për vitin 2027 në kategorinë e subvendioneve për thirrje publike për shërbime sociale në kuadër të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale për organizatat e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale?

Drejtori i Financave z. Gazmend Gjoshaj, shuma totale e planifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale në kuadër të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale për vitin 2027 është 278,984 €.

Kjo shumë është e dedikuar për mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve sociale në kuadër të kësaj drejtorie.

Xhenis Beqiri: Sa asistent/e do të angazhohen për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore për vitin 2027, a është ndarë buxheti për këtë shërbim? Në mungesë të Drejtorit të Arsimit a mund te marr një përgjigje nga drejtori i DBF-së?

Gazmend Gjoshaj: Kjo varet nga shuma e buxhetit që do të ndahet për hapjen e konkursit dhe se cilat pozita do të hapen.

Nexhat Rushiti: Kërkohet të shqyrtohet çështja e kompensimit të punëtorëve të mirëqenies sociale, duke marrë parasysh natyrën specifike të punës së tyre, përgjegjësitë që kanë dhe faktin se në shumë raste janë në dispozicion të punës edhe jashtë orarit të rregullt.
Duke pasur parasysh se puna e tyre kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe gatishmëri për të reaguar ndaj rasteve dhe nevojave të ndryshme sociale, kërkojmë të shqyrtohet mundësia e gjetjes së një forme të përshtatshme dhe të ligjshme të kompensimit për këtë angazhim shtesë. Në këtë drejtim, do të ishte e rëndësishme që të gjendet një zgjidhje që merr parasysh natyrën e punës dhe përgjegjësitë e këtyre punëtorëve, duke siguruar kompensim të drejtë për angazhimin e tyre jashtë orarit të rregullt të punës.

Ramadan Beshiri: Ata çdo herë i sjellin kërkesat e tyre dhe vazhdimisht ua nënshkruaj kërkesën për pagesa jashtë orarit, kjo çështje vendoset nga udhëheqësi ynë pra nga Kryetari i Komunës dhe jemi duke bërë përpjekje që ta gjejmë një zgjidhje për të gjithë që mos të kemi probleme të tilla. Por në planifikim nuk është parapa me u nda mjete për punë jashtë orarit, përndryshe pagesat jashtë orarit janë të arsyeshme sepse me të vërtetë ata janë në orar të punës sikurse një mjek që punon 24 orë dhe ju ofron shërbime qytetareve njëjtë edhe këta janë në gatishmëri 24 orë në rast se ndodh diçka ata i thërrasin.

*Pjesëmarrës të tjerë në diskutim nuk ka pasur.*

**Shtojcë**

*Lista e pjesëmarrësve në konsultimin publik.*

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-4000/03-0051745-2/26 dt. 09.09.2026**
**Mitrovicë**

**Lista e pjesëmarrjes për konsultim publik për Projekt Buxhetin e Komunës së Mitrovicës së jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 buxhetore 2027-2029**

| Nr. | Emri e Mbiemri | Datë | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1. | ISAK HAJRA | 09.09.2026 | |
| 2. | SAFET KURTI | 09.09.2026 | |
| 3. | Emin Bahtiri | 09.09.2026 | |
| 4. | Myevera HASANI | 09.09.2026 | |
| 5. | Agnesa Shkupolli | 09.09.2026 | |
| 6. | Ardiana Bejtsha | 09.09.2026 | |
| 7. | Xhenis Begiri | 09.09.2026 | |
| 8. | Mentor Ylm | 09.09.2026 | |
| 9. | Ermir Begiri | 09.09.2026 | |
| 10. | Zenel Çitaku | 09.09.2026 | |
| 11. | Unejsa Dashevci | 09.09.2026 | |
| 12. | Fatjona Ibrahimi | 09.09.2026 | |
| 13. | Sofije Rushiti Peci | 09.09.2026 | |
| 14. | [illegible] | 09.09.2026 | |
| 15. | Gresa Vora | 09.09.2026 | |
| 16. | Albulena Tmava | 09.09.2026 | |
| 17. | Merlyde Peci Shala | 09.09.2026 | |
| 18. | VALON BAHRI | 09.09.2026 | |
| 19. | Afërdita Mal[illegible] | 09.09.2026 | |
| 20. | [illegible] | 09.09.2026 | |
| 21. | | 09.09.2026 | |
| 22. | | 09.09.2026 | |
| 23. | | 09.09.2026 | |
| 24. | | 09.09.2026 | |
| 25. | | 09.09.2026 | |
| 26. | | 09.09.2026 | |
| 27. | | 09.09.2026 | |
| 28. | | 09.09.2026 | |
| 29. | | 09.09.2026 | |
| 30. | | 09.09.2026 | |
| 31. | | 09.09.2026 | |
| 32. | | 09.09.2026 | |
| 33. | | 09.09.2026 | |
| 34. | | 09.09.2026 | |

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**
**Nr. 02-400/03-0051745-2/26 dt. 01.09.2026**
**Mitrovicë**

## NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 3, i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës; nenin 61 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; neneve 17 paragrafi 1, 19 dhe 22 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 Për Administratë të hapur në Komuna; në nenin 25 dhe 26 të Statutit të Komunës; bazuar në Planin e veprimit për transparencë në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2023-2027, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Safet Kamberi në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim ORGANIZON:

## KONSULTIM PUBLIK
## PËR
## PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2027 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2028-2029

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në Konsultimin Publik për Projekt buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029.

**Konsultimi publik do të mbahet të mërkurën më dt. 09.09.2026 në Sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës duke filluar nga ora 10.$^{00}$.**

Njëkohësisht të gjithë qytetarët dhe të interesuarit tjerë në afatin prej 15 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi të gjitha propozimet, komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i bëjnë përmes ueb faqes së Komunës https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/, ose te Udhëheqësi i Sekretarisë së Kuvendit z. Nazmi Jashari në e-mailin: nazmi.jashari@rks-gov.net, ose drejtpërdrejtë në Zyrën pritëse dhe Zyrën Nr. 60 të Sekretarisë së Kuvendit të Komunës, ku edhe mund të merret Projekt buxheti për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029.

Projekt buxhetin e Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 po ashtu mund ta gjeni të publikuar në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut duke klikuar linkun: https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/category/shpalljet/njoftimet/.

**Mitrovicë**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Safet KAMBERI**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA
01 Nr.Prot./Br.Prot. 02-400/03-005/1959/26
Datë/Datum 31.08.26

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | |
| **REFERENC-Ë:** | |
| **PËR/ZA/TO:** | **z. Safet KAMBERI**– Kryesuese i Kuvendit |
*Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance*

***Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister***

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 14.08.2026 |
| PËR/ZA/TO: | Kryetarët e Komunave, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar |
| NGA/OD/FROM: | Hekuran Murati, Ministër i Financave |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Qarkorja Buxhetore 2027/02 për Komuna |

Të nderuar,

Në vijim gjeni Qarkoren Buxhetore 2027/02 për Komuna, e cila ofron kufijtë buxhetor për secilën komunë për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029. Ministria e Financave mbetet në dispozicion të juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të buxheteve komunale për vitin 2027.

Me respekt!

Hekuran Murati
Ministër i Financave

**Qarkorja Buxhetore 2027/02**

## 1. Qëllimi

Ministri për Financa është i autorizuar dhe përgjegjës që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë Qarkore Buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri nxjerr Qarkoren e Dytë Buxhetore 2027/02, ku ofrohen udhëzimet për hartimin e buxhetit për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 si dhe jepen kufijtë buxhetor final.

## 2. Kriteret e përgjithshme dhe specifike për përgatitjen e buxhetit

Komunat duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së projektbuxhetit t'i japin prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve komunale;
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale, duke përfshirë obligimet e shpronësimit lidhur me ato projekte;
- Të kujdesen që të hyjnë në obligime për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza e tyre buxhetore;

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029 dhe
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet çështjeve si në vijim:
    - Komunat të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale;
    - Komunat janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP, si dhe duhet të eliminojnë keqklasifikimet e shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga Komunat analisti buxhetor do të identifikojë keqklasifikime, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largoj nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keqklasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
    - Projektet e propozuara duhet të jenë projekte në përputhje me Manualin e PIP, Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale si dhe Udhëzimin Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale. Projektet të cilat nuk zbatojnë kërkesat kryesore të manualit dhe udhëzimeve administrative, nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit;
    - Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, komunat të dorëzojnë në MF arsyeshmërinë për secilin projekt sipas manualit të PIP dhe udhëzimeve administrative, që përfshinë edhe kriterin e përputhshmërisë së projektit/aktivitetit të propozuar me strategjinë;
    - Projektet e propozuara të jenë të maturuara (projekte të gatshme për zbatim);

- Komunat të deklarojnë në MF numrin e pozitave të lira e të paplotësuara për të cilat nuk ka marrëdhënie punësimi dhe për të cilat nuk ka buxhet për plotësimin e tyre;
- Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në sistemin e PIP-it;
- Komunat pas një analize paraprake duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim;
- Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjisë informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit të Informacionit- ASHI (MPB) së një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.

Në vijim të këtij procesi vëmendje e shtuar nga MF do t'i jepet zbatimit të rekomandimeve të lartpërmendura. Nëse komunat nuk plotësojnë të dhënat sipas manualit të PIP dhe analizën për çdo projekt-propozim të ri sipas UA për Kriteret Përzgjedhëse si dhe nëse dorëzohet propozim buxheti që përmban keq klasifikim, atëherë MF do të merr masa për korrigjimin e tyre para dorëzimit të projektbuxhetit për vitin 2027 për aprovim në Qeveri.

## 3. Kufijtë buxhetor për komunat (struktura e shpenzimeve)

Komunat duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelat në vijim gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2027 dhe për dy vitet në vijim.

Gjatë planifikimit të buxhetit për vitet 2027-2029 secila komunë duhet të respektoj strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të lëshuara me këtë qarkore.

Struktura është përgatitur duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2027/01, KAB komunal për vitin 2027-2029 si dhe diskutimet në forume me autoritetet komunale mbi zhvillimin e procesit buxhetor.

Është bërë harmonizimi dhe rritja e stafit në sektorin e arsimit për hapjen e çerdheve të reja dhe në sektorin e shëndetësi për hapjen e institucioneve të reja shëndetësore dhe politikave të reja për intervenimin në fëmijërinë e hershme.
Ju sugjerojmë që stafin e pa punësuar ta dedikoni për hapjen dhe funksionalizimin e çerdheve të reja dhe funksionalizimin e çerdheve ekzistuese.

Për kalkulimin e pagave për vitin 2027 është marrë për bazë Ligji për pagat në sektorin publik i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, përllogaritja e shpenzimeve bazuar në vitin 2026 për punëtorët aktual duke kalkuluar për 12 muaj, ndërsa për numrin e papunësuar është kalkuluar paga mesatare për punësimin deri në 40% të pozitave të paplotësuara.

Duhet te respektoni strukturën dhe financimin për grantet specifike, teatrot, shërbimet rezidenciale dhe financimet tjera të specifikuara me Qarkoren Buxhetore 2027/01.

Gjithashtu, në kolonën 'Rezerva' (shih tabelën e bashkangjitur), komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontigjente. Mjetet për ndarjen e buxhetit për detyrimet kontigjente, komunat duhet t'i marrin brenda kufirit të ndarë buxhetor për komunat me këtë qarkore, duke përjashtuar nga kategoria e shpenzimeve paga dhe shtesa.

Më poshtë në Tabelat e bashkangjitura është paraqitur struktura e shpenzimeve për vitin 2027-2029.

## 4. Dorëzimi i propozim-buxhetit komunal

Pas aprovimit të propozim-buxhetit për vitin 2027-2029 nga Kuvendet Komunale, komunat duhet të dorëzojnë atë në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave deri me datë **30 shtator 2026**. Propozim buxheti i aprovuar duhet të përmbajë dokumentet si në vijim:

- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal.
- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal 2027-2029,
- Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB dhe PIP):
  - Tabela 4.1, plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve 2027-2029 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
  - Tabela 4.1.B, plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve përmes huamarrjes,
  - Tabela 4.2, financimi i projekteve kapitale për vitin 2027-2029 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
  - Tabela 4.2.B, financimi i projekteve kapitale përmes huamarrjes,
  - Tabela 4.3, plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal 2027-2029 (shtypur nga SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
  - Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor,
  - Tabelat e Buxhetimit sipas performancës.

Tabela 2: Struktura e shpenzimeve për vitin 2028

| Nr. | Komunat | Stafi për vitin 2028 | Total paga dhe shtesa | Mallra dhe shërbime | Shpenzime komunale | Subvencione dhe transfere | Shpenzime kapitale | Gjithsej 2028 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Deçan | 898 | 8,657,166 | 2,000,000 | 300,000 | 350,000 | 2,829,218 | 14,136,385 |
| 2 | Dragash | 764 | 7,332,730 | 2,013,343 | 400,000 | 591,853 | 3,723,179 | 14,061,105 |
| 3 | Ferizaj | 2,495 | 24,684,027 | 14,391,227 | 1,530,000 | 2,720,000 | 15,582,251 | 58,907,504 |
| 4 | Fushë Kosovë | 1,234 | 11,561,897 | 3,660,000 | 610,000 | 2,506,981 | 12,594,801 | 30,933,679 |
| 5 | Gjakovë | 2,305 | 23,190,173 | 4,900,000 | 1,200,000 | 1,703,053 | 13,309,953 | 44,303,179 |
| 6 | Gjilan | 2,402 | 23,936,600 | 10,110,221 | 896,750 | 2,345,899 | 7,660,137 | 44,949,607 |
| 7 | Gllogoc | 1,401 | 13,929,354 | 3,017,645 | 449,507 | 902,500 | 7,469,746 | 25,768,752 |
| 8 | Hani i Elezit | 303 | 2,866,071 | 575,500 | 116,000 | 245,000 | 1,076,881 | 4,879,452 |
| 9 | Istog | 1,003 | 9,647,402 | 3,407,000 | 372,600 | 658,000 | 4,984,566 | 19,069,568 |
| 10 | Junik | 206 | 1,965,418 | 263,000 | 63,400 | 70,000 | 202,939 | 2,564,757 |
| 11 | Kaçanik | 823 | 8,137,331 | 1,617,151 | 290,000 | 730,000 | 3,789,901 | 14,564,382 |
| 12 | Kamenicë | 1,112 | 10,353,562 | 1,307,765 | 293,000 | 350,000 | 690,437 | 12,994,765 |
| 13 | Klinë | 996 | 10,233,045 | 1,720,559 | 400,000 | 820,000 | 4,172,631 | 17,346,234 |
| 14 | Leposaviq | 476 | 2,417,499 | 900,000 | 620,000 | 181,515 | 2,624,036 | 6,743,051 |
| 15 | Lipjan | 1,547 | 15,335,303 | 5,272,045 | 620,000 | 1,530,000 | 7,717,882 | 30,475,230 |
| 16 | Malishevë | 1,386 | 13,562,870 | 3,000,000 | 550,000 | 700,000 | 6,335,809 | 24,148,679 |
| 17 | Mamushë | 242 | 2,208,904 | 448,058 | 54,500 | 418,000 | 912,107 | 4,041,569 |
| 18 | Mitrovicë | 1,965 | 18,732,517 | 5,640,475 | 700,000 | 1,394,150 | 8,871,872 | 35,339,014 |
| 19 | Novobërdë | 392 | 3,522,137 | 560,000 | 150,000 | 360,000 | 112,415 | 4,704,553 |
| 20 | Obiliq | 687 | 6,863,969 | 2,400,000 | 430,000 | 1,400,000 | 6,838,919 | 17,932,888 |
| 21 | Pejë | 2,222 | 22,262,556 | 4,987,490 | 1,157,240 | 1,649,426 | 16,131,025 | 46,187,736 |
| 22 | Podujevë | 2,066 | 21,064,389 | 4,063,450 | 756,743 | 2,000,500 | 9,740,068 | 37,625,150 |
| 23 | Prishtinë | 4,926 | 52,290,670 | 39,000,000 | 4,000,000 | 8,800,000 | 61,615,005 | 165,705,674 |
| 24 | Prizren | 3,207 | 32,751,788 | 16,730,224 | 1,405,299 | 6,213,459 | 23,920,137 | 81,020,907 |
| 25 | Rahovec | 1,290 | 12,827,386 | 2,821,000 | 440,000 | 1,010,000 | 5,173,483 | 22,271,870 |
| 26 | Shtërpcë | 518 | 3,900,016 | 930,362 | 106,751 | 205,000 | 3,401,716 | 8,543,845 |
| 27 | Shtime | 775 | 7,291,286 | 1,669,904 | 320,000 | 567,429 | 2,674,431 | 12,523,050 |
| 28 | Skenderaj | 1,375 | 13,092,412 | 3,321,675 | 326,700 | 1,067,000 | 3,789,673 | 21,597,459 |
| 29 | Suharekë | 1,391 | 13,818,808 | 3,497,000 | 538,000 | 1,522,000 | 5,689,321 | 25,065,129 |
| 30 | Viti | 1,188 | 11,538,254 | 3,013,919 | 290,000 | 720,000 | 2,757,494 | 18,319,667 |
| 31 | Vushtrri | 1,638 | 16,270,254 | 7,149,260 | 695,000 | 2,420,000 | 6,681,641 | 33,216,155 |
| 32 | Zubin Potok | 338 | 2,035,004 | 434,446 | 70,134 | 115,605 | 829,069 | 3,484,259 |
| 33 | Zveçan | 301 | 2,001,554 | 387,889 | 88,800 | 45,000 | 220,804 | 2,744,048 |
| 34 | Gracanicë | 675 | 5,042,842 | 2,109,361 | 239,000 | 740,859 | 5,589,555 | 13,721,617 |
| 35 | Kllokot | 168 | 1,352,876 | 289,137 | 66,188 | 13,495 | 422,820 | 2,144,516 |
| 36 | Mitrovicë veriore | 827 | 3,747,334 | 680,000 | 170,000 | 270,000 | 2,179,458 | 7,046,792 |
| 37 | Partesh | 202 | 1,778,170 | 403,810 | 107,400 | 70,000 | 694,053 | 3,053,433 |
| 38 | Ranillug | 211 | 1,901,460 | 300,000 | 60,000 | 100,000 | 458,281 | 2,819,741 |
| **Total** | | **45,955** | **444,105,031** | **158,992,917** | **20,883,012** | **47,506,724** | **263,467,716** | **934,955,399** |

Tabela 3: Struktura e shpenzimeve për vitin 2029

| Nr. | Komunat | Stafi për vitin 2029 | Total paga dhe shtesa | Mallra dhe shërbime | Shpenzime komunale | Subvencione dhe transfere | Shpenzime kapitale | Gjithsej 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Deçan | 898 | 8,700,452 | 2,000,000 | 300,000 | 350,000 | 3,539,059 | 14,889,511 |
| 2 | Dragash | 764 | 7,369,393 | 2,013,343 | 400,000 | 591,853 | 4,773,191 | 15,147,780 |
| 3 | Ferizaj | 2,495 | 24,807,447 | 15,447,577 | 1,644,750 | 2,820,000 | 17,395,010 | 62,114,784 |
| 4 | Fushë Kosovë | 1,234 | 11,619,706 | 3,680,000 | 630,000 | 2,832,198 | 14,223,971 | 32,985,875 |
| 5 | Gjakovë | 2,305 | 23,306,124 | 5,100,000 | 1,300,000 | 1,900,000 | 15,053,156 | 46,659,279 |
| 6 | Gjilan | 2,402 | 24,056,283 | 10,845,000 | 943,250 | 2,654,230 | 8,812,995 | 47,311,758 |
| 7 | Gllogoc | 1,401 | 13,999,000 | 3,059,145 | 448,267 | 959,200 | 8,661,071 | 27,126,683 |
| 8 | Hani i Elezit | 303 | 2,880,402 | 662,000 | 138,000 | 270,000 | 1,183,445 | 5,133,847 |
| 9 | Istog | 1,003 | 9,695,639 | 3,459,640 | 387,600 | 675,000 | 5,899,293 | 20,117,172 |
| 10 | Junik | 206 | 1,975,245 | 268,000 | 66,400 | 70,000 | 308,072 | 2,687,717 |
| 11 | Kaçanik | 823 | 8,178,018 | 1,655,210 | 300,000 | 745,000 | 4,459,839 | 15,338,066 |
| 12 | Kamenicë | 1,112 | 10,405,330 | 1,542,815 | 301,000 | 470,000 | 969,669 | 13,688,814 |
| 13 | Klinë | 996 | 10,284,210 | 1,850,000 | 450,000 | 850,000 | 4,827,894 | 18,262,104 |
| 14 | Leposaviq | 476 | 2,429,587 | 950,000 | 660,000 | 181,285 | 3,221,204 | 7,442,076 |
| 15 | Lipjan | 1,547 | 15,411,980 | 5,662,045 | 625,000 | 1,680,000 | 8,734,607 | 32,113,632 |
| 16 | Malishevë | 1,386 | 13,630,684 | 3,200,000 | 550,000 | 800,000 | 7,265,035 | 25,445,719 |
| 17 | Mamushë | 242 | 2,219,949 | 527,549 | 58,000 | 323,000 | 1,143,778 | 4,272,275 |
| 18 | Mitrovicë | 1,965 | 18,826,179 | 5,716,120 | 700,000 | 1,394,150 | 10,608,405 | 37,244,854 |
| 19 | Novobërdë | 392 | 3,539,748 | 560,000 | 150,000 | 360,000 | 319,046 | 4,928,794 |
| 20 | Obiliq | 687 | 6,898,289 | 2,500,000 | 470,000 | 1,500,000 | 7,292,533 | 18,660,822 |
| 21 | Pejë | 2,222 | 22,373,868 | 4,987,490 | 1,157,240 | 1,649,426 | 18,426,553 | 48,594,578 |
| 22 | Podujevë | 2,066 | 21,169,710 | 3,951,872 | 779,210 | 2,025,525 | 11,718,107 | 39,644,424 |
| 23 | Prishtinë | 4,926 | 52,552,123 | 40,000,000 | 4,200,000 | 9,000,000 | 69,691,891 | 175,444,014 |
| 24 | Prizren | 3,207 | 32,915,547 | 17,730,224 | 1,405,299 | 6,913,459 | 26,560,869 | 85,525,398 |
| 25 | Rahovec | 1,290 | 12,891,523 | 3,135,666 | 492,500 | 1,010,000 | 5,941,640 | 23,471,329 |
| 26 | Shtërpcë | 518 | 3,919,516 | 983,043 | 125,342 | 213,400 | 3,784,550 | 9,025,851 |
| 27 | Shtime | 775 | 7,327,743 | 1,870,388 | 350,000 | 587,429 | 3,084,639 | 13,220,198 |
| 28 | Skenderaj | 1,375 | 13,157,874 | 3,718,313 | 326,700 | 1,185,000 | 4,394,212 | 22,782,099 |
| 29 | Suharekë | 1,391 | 13,887,902 | 3,652,000 | 544,000 | 1,580,000 | 6,735,414 | 26,399,315 |
| 30 | Viti | 1,188 | 11,595,945 | 3,013,919 | 290,000 | 720,000 | 3,672,174 | 19,292,038 |
| 31 | Vushtrri | 1,638 | 16,351,605 | 7,361,511 | 695,000 | 2,420,000 | 8,173,740 | 35,001,856 |
| 32 | Zubin Potok | 338 | 2,045,179 | 460,448 | 74,332 | 122,524 | 990,309 | 3,692,792 |
| 33 | Zveçan | 301 | 2,011,562 | 410,389 | 93,000 | 47,250 | 333,282 | 2,895,483 |
| 34 | Gracanicë | 675 | 5,068,056 | 2,109,361 | 239,000 | 740,859 | 6,254,499 | 14,411,776 |
| 35 | Kllokot | 168 | 1,359,641 | 279,935 | 72,277 | 14,169 | 522,203 | 2,248,224 |
| 36 | Mitrovicë veriore | 827 | 3,766,071 | 680,000 | 170,000 | 280,000 | 2,752,437 | 7,648,508 |
| 37 | Partesh | 202 | 1,787,061 | 403,810 | 107,400 | 70,000 | 848,833 | 3,217,104 |
| 38 | Ranillug | 211 | 1,910,967 | 310,000 | 62,000 | 110,000 | 568,357 | 2,961,324 |
| | **Total** | **45,955** | **446,325,556** | **165,756,813** | **21,705,567** | **50,114,957** | **303,144,979** | **987,047,873** |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| Nr. Prot: | 02-030/01-0052564/26 |
| Datë/a: | |
| Për/Za/To: | **z. Safet Kamberi, Kryesues i Kuvendit të Komunës** |
| CC : | **Anëtarëve të Kuvendit të Komunës,**<br>**Komiteti për Politikë dhe Financa,** |
| Përmes/Preko/Trogugh : | **z. Faton Peci, Kryetar i Komunës** |
| Nga/Od/From : | **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**<br>**z. Gazmend Asllani - Drejtor** |
| Subjekti/Subjekat/Subject : | **PROPOZIM – VENDIM** |

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, pika (d), nenin 14 dhe 58 pika (h), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, në nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, neni 15 dhe 77, paragrafi 1.10, të Statutit të Komunës Nr. 02/060/01-0056607/20-4, datë 24.09.2020, nenin 26 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës në zbatim të Memorandumit të Bshkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Sportit dhe Rinisë dhe Komuna e Mitrovicës së Jugut Nr.01-400/01-0023557/26, datë 28.04.2026, për Mbështetje financiare dhe Bashkëpunim Institucional për realizimin e projekteve Infrastrukturore Sportive në Komunën e Mitrovicës së Jugut, si dhe duke marrë parasyshë faktin se se pjesa e propozuar e Parceles e identifikuar për realizimin e Projektit Infrastrukturor Sportiv është në harmoni me dokumentin e planifikimit në fuqi, përkatësisht me Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) të miratuar , Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

**PROPOZIM - VENDIM**

**Për caktimin e Pronës Komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit**

1. **MIRATOHET** vendimi për **CAKTIMIN** e Pronës Komunale për ndëtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit.

2. Qëllimi i miratimit të këtij vendimi për caktimin e Parcelës është realizimi i marrëveshjes ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Ministrisë së Sportit dhe Rinisë, me të cilën do të ndërtohen fushat e tenisit dhe fushat e padelit, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Lokacioni i caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi është sipërfaqja **10000m²,** nga sipërfaqja e përgjithshme prej **39283m²**, të Parcelës Kadastrale P-71208032-00399-5 e cila gjendet në vendin e quajtur Përzhina-Lumi Ibër, Zona Kadastrale Zhabar i Epërm, pronë e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

4. Parcela Kadastrale nga pika 1, është në harmoni të plotë me dokumentin e Planifikimit në fuqi, përkatësisht me Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut të miratuar (Zonë Rekreative Turistike-ZrT-2, fushë futbolli/poligon sportiv).

5. Ndarja e Parcelës nga pika 2 e këtij vendimi të evidentohet në Regjistrin e të Drejtave Pronësore.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Pronës si dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Shtojcë:**

- Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës Nr. 15-42-0033856-26, datë 02.09.2026;
- Kopja e Planit, 02.09.2026;
- Memorandumi i Bashkëpunimit Nr. 01-400/01-0023557/26, datë 28.04.2026;
- Informatë nga Harta Zonale në lidhje me destinimin e parcelës.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës**
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica

| | |
|---|---|
| **NR.PROT** | **08-3463/06-0052228/26, DATË 01.09.2026** |
| **DATË** | **02.09.2026.2026** |
| **PËR/ZA/TO:** | **D.K.R.S. - Mitrovicë e Jugut** |
| **CC:** | |
| **NGA/OD/FROM:** | **Drejtorija Për Planifikim dhe Urbanizëm.**<br>**Ardian Kavaja-Drejtor** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH** | **Shefit të Sektorit për Planifikim.**<br>**Inxh.dip.ark. Nexhmi Hasani** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Informatë nga Plani në lidhje me destinimin e parcelës.** |

**Të nderuar,**

Pas procedimit në çështje administrative sipas kërkesës 08-463/06-0052228/26 datë 02.09.2026 të parashtruesit Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, në lidhje me destinimin e parcelës P-71208032-00399-5 sipas Planeve, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm pas shqyrtimit të bërë të shkresave të lëndës, e duke vepruar në procedurë administrative me datën 02.09.2026 sjell ketë:

Përgjigjje Informuese:

Bazuar në **Hartën Zonale Komunale** për periudhën 2025-2033, e të aprovuar me Vendimin e Kuvendit Komunal Mitrovicë Nr.02-060/01-0054399-3/25 i dt.11.09.2025, pjesa e parcelës P-71208032-00399-5 në sipërfaqe prej S=10000 m² e kërkuar nga D.K.R.S është e destinuar si **Zonë Rekreative Turistike-ZrT-2 ( Fushë futbolli/poligon sportiv)**

Nga të theksuarat si më lartë, përgjigjja u konfirmua si në dispozitiv.

T`i dorëzohet :
1x D.K.R.S
1x DPU-së
1x Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : MITROVICË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Zhabar I Epërm

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71208032-00399-5 | Parcelë / Parcela / Parcel | 39283 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:2222

Punoi/Obradio/Created: Ruzhdi Ujkani

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 02.09.2026

Koha/ Vreme/ Time: 09:43:26

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning***

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71208032-00399-5

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **15-42-0033856-26** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 02.09.2026 - 09:42 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Zhabar I Epërm / Gornje Žabare / Zhabari I Epërm |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-71208032-00399-5** | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | **39283** | 0003-84.KERKESA NR.REF.15-463/02-0016518/26 DT.30.03.2026 DGJKP Sektori i Prones."Geo-Fa" sh.p.k Lic.57 Reg.Ndrr.9/26 | 22.06.2026 | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| PËRRZHINA-LUMI IBËR | 0 | | 22.06.2026 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E MITROVICËS * REPUBLIKA KOSOVO * OPŠTINA MITROVICA

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand | Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive | | **39283** |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual /<br>Individualna Drzavina /<br>Single possessor | **Komuna e Mitrovicës Jugore** | 600535126 | MITROVICË /<br>MITROVICA /<br>MITROVICË / | | BEDRI GJINAJ | **1/1** | 0003-84 | 22.06.2026 |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Ruzhdi.Ujkani | P-71208032-00399-5 |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

01-400/01-0023557/26
4
28.04.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E SPORTIT DHE RINISË - MINISTAR SPORTA I OMLADINE - MINISTER OF SPORTS AND YOUTH
Nr. prot. 01 Shenja klas. 02
Nr.Pro/Viti 189/ 2026
Data 27.04.2026
Nënshkrimi
Prishtinë

**Republika e Kosovës**
**Rublika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

---

# MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

# I

# LIDHUR

# NDËRMJET

# MINISTRISË SË SPORTIT DHE RINISË

# DHE

# KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

## 1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT:

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (MB) është mbështetja financiare dhe bashkëpunimi institucional për realizimin e projekteve infrastrukturore dhe sportive në Komunën e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht:

- Renovimi i Qendrës Multifunksionale - Omni Sporti;
- Ndërtimi i fushave të padelit;
- Ndërtimi i fushave të tenisit;
- Ndërtimi i terreneve sportive;
- Ndërtimi i poligonit të qitjes në Mazhiq.

## 2. AUTORITETET

Qëllimi i Memorandumit do të përmbushet nga:
2.1. Ministria e Sportit dhe Rinisë;
2.2. Komuna e Mitrovicës së Jugut.

(në tekstin e mëtejmë: Palët)

### 3. OBLIGIMET E PALËVE

### 3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË SPORTIT DHE RINISË (MSR)

Ministria merr përsipër këto obligime:

3.1.1. Merre përsipër mbështetje financiare për realizimin e projekteve të dakorduar ndërmjet palëve, në përputhje me këtë Memorandum;

3.1.2. Në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës së Jugut, kujdeset për zbatimin e projekteve të parapara në këtë Memorandum;

3.1.3. Procedurat e prokurimit, do të përcaktohen dhe detajohen përmes një aneks memorandumi të veçantë per secilin projekt, i cili do te jetët si aneks i këtij Memorandumi.

### 3.2. OBLIGIMET E KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komuna merr përsipër këto obligime:

3.2.1. Siguron mbështetje financiare për realizimin e projekteve të dakorduar ndërmjet palëve;

3.2.2. Merr përsipër te siguron pronësinë, kompletimin e dokumentacionit si dhe sigurimin e lokacioneve për realizimin e projekteve;

3.2.3. Në bashkëpunim me Ministrin e Sportit dhe Rinisë (MSR), kujdeset për implementimin e projekteve të parapara në këtë Memorandum;

3.2.4. Procedurat e prokurimit, si dhe planifikimi i lokacioneve përkatëse, do të përcaktohen përmes një aneksi të veçantë per secilin projekt, i cili do të jetë pjesë e këtij Memorandumi.

## 4. ZBATIMI

Ministria e Sportit dhe Rinisë në bashkëpunim me Komunën Mitrovicës së Jugut e përcjellin zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve në mbarëvajtjen e realizimit të qëllimit.

## 5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPARESHIKUARA

5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve.
5.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të Fuqisë mbinatyrore – Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

## 6. AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimi të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda viteve 2026-2030.

## 7. AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

## 8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.

## 9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

## 10. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

**Blerim GASHANI**

Ministër i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë

**Faton PECI**

Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut

Nënshkruar më 27.04.2026
Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ZIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING
Njësia Org. DL — Nr. Prot. 3353 2/26
Nr. i faqeve 02 — Data 29.07.2026
PRISHTINË/A

HYRESE - ULAZNA - INCOMING
29.07.2026
Nr. 020-452/26

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Faton Peci, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut<br>Safet Kamberi, Kryesues i Kuvendit të Komunës Mitrovicës së Jugut | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL<br><br>Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH<br><br>Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Datë: 13.07.2026<br>Nr. VL 152/26 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Arta Krasniqi – Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve | |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit | |
| Lloji i aktit: | Vendim Nr.02-060/01-0035074-4/26 për destinim të pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit | |

I nderuar kryetar Peci,
I nderuar kryesues Kamberi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 10.07.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Vendimin Nr.02-060/01-0035074-4/26 për destinim të pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave:

## RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin Nr.02-060/01-0035074-4/26 për destinim të pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit

## ARSYETIMI

MMPH pas shqyrtimit të Vendimit të lartcekur konstatoi se:

Komuna e Mitrovicës së Jugut çdo Vendim që ka të bëjë me shfrytëzim të zonës, nën-zonës apo parcelës kadastrale për ndërtim duhet të bazoj në dokumentin e planifikimit hapësinor , në këtë rast Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Në këtë Vendim nuk është evidentuar se është mbështetur në Hartën Zonale të Komunës në fuqi (as në Preambulë e as në nenet e vendimit). Inkurajojmë Komunën që në Vendimmarrjet e tjera që kanë të bëjnë me fushën e Planifikimit Hapësinor të kenë referencë dhe harmonizim të plotë më dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 04.09.26 |
| **REFERENCË:** | 02-020/04-0052955/26 |
| **PËR/ZA/TO:** | **Z. Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës** |
| **CC:** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Gazmend Asllani - Drejtor për Kulturë, rini dhe Sport** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Propozim Vendim Për formimin e Jurisë Profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu"** |

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe 58paragrafi h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); neneve: 4 paragrafi 1.4, 13 paragrafi 1.4, dhe 14 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave; nenet 13, paragrafi 1, dhe 73 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenin 9 të Rregullores Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve; Kuvendit të Komunës i propozoj:

**Propozim - VENDIM**
**Për formimin e Jurisë Profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu"**

1. FORMOHET Juria Profesionale për ndarjen e Çmimit "Kadri Kadriu" në përbërje:
    1.1 Tafil Peci
    1.2 Skender Muja,
    1.3 Sabri Behrami,
    1.4 Anëtare
    1.5 Anëtare
2. Juria Profesionale e formuar me pikën 1 të këtij vendimi shqyrton Propozimet inicuese për dhënien e çmimit "Kadri Kadriu" për vitin 2026, në bazë të Rregullores Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe anëtarët e jurisë të emëruar me këtë vendim.
4. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

**DREJTOR PËR KULTURË RINI DHE SPORT**

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | |
| **REFERENCË:** | 02-020/04-0052992/26 |
| **PËR/ZA/TO:** | **Z. Safet Kamberi - Kryesues i Kuvendit të Komunës** |
| **CC:** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Gazmend Asllani - Drejtor për Kulturë, rini dhe Sport** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Propozim Vendim Për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani"** |

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, dhe 58 paragrafi h,të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); neneve: 4 paragrafi 1.4, 13 paragrafi 1.4, dhe 14 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 Për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave; nenet: 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, 73 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenin 10 të Rregullores Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve; Kuvendit të Komunës i propozoj:

**PROPOZIM VENDIM**
**Për formimin e Komisionit për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani"**

1. Të Formohet Komisioni për ndarjen e Çmimit "Lah Nimani" në përbërje:

   1.1 Anëtar i Kuvendit,
   1.2 Anëtar i Kuvendit,
   1.3 Anëtar i Kuvendit,
   1.4 Anëtar i Kuvendit,
   1.5 Anëtar,
   1.6 Anëtar,
   1.7 Anëtar nga shoqëria civile.
2. Komisioni i formuar me pikën 1 të këtij vendimi shqyrton Propozimet inicuese për dhënien e çmimit "Lah Nimani" për vitin 2024, në bazë të Rregullores Nr. 04/2019 Për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe falënderimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe anëtarët e komisionit të emëruar me këtë vendim.
4. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

| | | |
|---|---|---|
| | REPUBLIKA E KOSOVËS<br>REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA | |
| | KOMUNA E MITROVICËS JUGORE<br>OPSTINA.J MITROVICA/ MUNICIPALITY OF S.MITROVICA/ | |

| | |
|---|---|
| NR.PROT | 02-400/04 0052486/2C |
| Datë | 02.09.2026 |
| PËR/ TO: | z. Safet Kamberi-Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës së Jugut |
| PËRMES/ CC: | |
| NGA/ FROM: | z. Faton Peci-Kryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore |
| TEMA/ SUBJECT: | Propozim Vendim për mbështetje financiare në shumën **250.00 €** në muaj për 4 familje në Bair |

Pas vlerësimit të gjendjes në teren dhe bazuar ne Raportin e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, në rastet e Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive Tjera me Nr 02-052/01-0023569/26, dt 28.04.2026 ne zonën e rrezikut nga rrëshqitja e dheut në lagjen Bair janë gjithsej 12 familje. Në seancën e kaluar me Vendimin Nr 02-060/01-0042000-14/26, dt 29.07.2026 është miratuar subvencionimi i 8 familjeve, ku për shkak të kufizimeve buxhetore nuk janë përfshirë 12 familjet që gjenden në këtë zone, prandaj, propozojmë që në këtë seance të subvencionohen edhe 4 familje për pagesën e qerase në shumë prej 250 euro për periudhën 12 muaj.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

| | |
|---|---|
| **Nr. Prot:** | 02-463/06-0059953/26 |
| **Datë/a:** | 15.09.2026 |
| **Për/Za/To:** | **Kryesuesin e Kuvendit të Komunës**<br>**z. Safet Kamberi** |
| **CC :** | **Anëtarëve të Kuvendit të Komunës** |
| **Nga/Od/From :** | **Kryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore**<br>**z. Faton Peci** |
| **Përmes/Preko/Through** | **Drejtoria e Pronës**<br>**z. Jeton Zeneli -Drejtor** |
| **Tema /Subjekat/ Subject :** | **Propozim për nxjerrjen e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.** |

Në bazë të nenit 58 shkronja h e Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (''Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04 qershor 2008), neni 5, neni 6 paragrafi 1.2, neni 8 pika 1.2 të Ligjit Nr 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (''Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës'' nr.10/03 Prill 2019), neni 4, neni 5 paragrafi 1.3, dhe neni 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe neni 77 paragrafi 1 pika 1.10 të Statutit të Komunës së Mitrovicës Jugore Nr. 02-060/01-0056607/20-4 të datës 24.09.2020, Kuvendit të Komunës i propozohet ky:

## PROPOZIM-VENDIM

**I.** I **PROPOZOHET** Kuvendit Komunal të merrë Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë/juridikë.

**II.** Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytezim e cekur në pikën **I** të ketij propozimi-vendimi , është në pronësi të Komunës së Mitrovicës Jugore si:

1. Parcela kadastrale: P-71208072-01870-5, me siperfaqe të përgjithshme 2,151 m², vendi i quajtur "Marshala Tita/Vojna Bolnica", Zona Kadastrale Mitrovicë (pronë shoqërore).

**III.** Qellimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, të cekur në pikë **II** të këtij propozim-vendimi është realizimi i ativiteteve në fushën e zhvillimeve shëndetetësore në përpuhtjee me Planin Zhvillimor Komunal.

Sipas PZHK-së parcela e cekur më lartë është e detinuar si Zonë e Shërbimeve me destinim shëndetësi. Dhënia në shfrytëzim e kësaj parcele, nuk duhet të cenojë rendin publik, shëndetin publik, mjedisin dhe nuk duhet të bie ndesh me legjislacionin ne fuqi.

IV. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën III të ketij propozim-vendimi është afatgjatë, për periudhën kohore deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite.

V. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytezim afatgjatë, realizohet përmes njoftimit publik për shprehje të interesit, sipas Ligjit nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

VI. Për zbatimin e këtij vendimi do te kujdeset Kryetari i Komunës dhe Komisioni për Vlerësim.

VII. Ky vendim shpallet 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, dhe hyn ne fuqi 7(shtatë) ditë pas publikimit ne gjuhët zyrtare ne-ueb faqen e Komunës së Mitrovicës Jugore.

**Arsyetim**

Komuna e Mitrovicës së Jugut, me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të pronës së paluajtshme komunale dhe krijimit të kushteve për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore, propozon dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelës kadastrale nr. P-71208072-01870-5, me sipërfaqe prej 2,151 m², në vendin e quajtur "Marshala Tita/Vojna Bolnica", Zona Kadastrale Mitrovicë.

Sipas Planit Zhvillimor Komunal, parcela është e përcaktuar si Zonë e Shërbimeve me destinim shëndetësi. Për këtë arsye, dhënia në shfrytëzim e saj synon mundësimin e zhvillimit të aktiviteteve dhe shërbimeve shëndetësore në përputhje me destinimin e përcaktuar dhe legjislacionin në fuqi.

Pas miratimit të vendimit paraprak, procedura për dhënien në shfrytëzim afatgjatë do të zhvillohet përmes njoftimit publik për shprehje të interesit, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020.

Duke marrë parasysh destinimin e parcelës dhe interesin publik për zhvillimin e shërbimeve shëndetësore, konsiderohet e arsyeshme inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone.

**Shtojcë:**
Çertifikata e Pronës, dt. 09.09.2026
Kopje e Planit, dt. 09.09.2026
Ortofoto, dt. 09.09.2026
Shkresë nga sektori i Kadastrit në kuadër të D.GJ.K, dt. 09.09.2026
Shkresë nga D.P.U, dt. 09.09.2026
Email zyrtar nga Zyrtari Ligjor i Komunës, dt. 10.09.2026

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Jugore**
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica Sou

Formulari për procedim të lëndës për nënshkrim;

Përmes këtij formulari, nga personat nënshkrues **KONFIRMOHET** se Lënda e Proceduar për nënshkrim me Nr.02.463/06 -0054953/26 , dt: 15.09.2026 **Propozim për nxjerrjen e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për (parcelën me nr. kadastral P-71208072-01870-5 Z.K Mitrovicë)** është në përputhje me ligjet në fuqi dhe të gjitha aktet juridike në fuqi.

| Nr. | Personi përgjegjës | Pozita | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| 1. | Jeton Zeneli | Drejtor i Drejtorisë për Pronë | [signature] |
| 2. | Bedri Muja | U.D. Shef i Zyrës Ligjore 14.09.2026 | [signature] |

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MITROVICËS REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA MITROVICA MITROVICE-MITROVICA * KOSOVO *

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo životne sredine i prostornog planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# print_2026-09-09

Y: 7489426.966
X: 4749423.375

Y: 7489627.277
X: 4749423.375




Y: 7489426.966
X: 4749281.741

Y: 7489627.277
X: 4749281.741

1 : 980
0 5 7.5 10 m

Printuar më: 09.09.2026 15:21

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71208072-01870-5

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **15-942-03-0054148-26** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 09.09.2026 - 15:20 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Mitrovicë / Mitrovica / Mitrovicë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | MITROVICË / MITROVICA / MITROVICË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71208072-01870-5 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Urban | 2151 | REG.PARAQ.44/15 reg.ndr.154/15 | 11.06.2015 | |

